



PROGRAMI PËR REMITANCAT DHE PAGESAT – SHQIPËRI,
FINANCUAR NGA SECO

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR PAGESAT ME VLERË TË VOGËL NË SHQIPËRI (2018-2023)

Grupi për Zhvillimin e Sistemeve të Pagesave
Korrik 2017

Përmbajtja

FALËNDERIME	3
LISTA E AKRONIMEVE DHE SHKURTIMEVE	4
PËRMBLEDHJE	5
I. E ARDHMJA E PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL NË SHQIPËRI: VIZIONI YNË.....	14
II. HYRJE	15
III. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI PAGESAT ME VLERË TË VOGËL NË SHQIPËRI	18
Pjesëmarrësit kryesorë	18
Kudri rregullator dhe ligjor	20
Përfshirja financiare në Shqipëri nga perspektiva e pagesave	22
Infrastruktura financiare që mbështet pagesat me vlerë të vogël në Shqipëri.....	24
Infrastruktura e ID dhe TIK në Shqipëri	27
Qeveria si përdoruese e shërbimeve të pagesave	34
Pikat dhe kanalet përkatëse të aksesit në Shqipëri	34
IV. VIZIONI DHE STRATEGJIA PËR ZHVILLIMIN E NJË SISTEMI PAGESASH ME VLERË TË VOGËL NË SHQIPËRI	38
IV.1 Parimet udhëzuese	39
IV.2 Fushat dhe veprimet strategjike	45
V. ZBATIMI I STRATEGJISË KOMBËTARE TË PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL: ROLET, PËRGJEGJËSITË DHE MONITORIMI I PROGRESIT	63
V.1 Rolet dhe përgjegjësitë.....	63
V.2 Monitorimi i progresit.....	65
V.3 Plani i zbatimit	69
Shtojca 1. Fjalor i termave të përzgjedhur	74
Shtojca 2. Udhëzimet e Bankës Botërore për Zhvillimin e një Strategjie Gjithëpërfshirëse për Reformimin e Pagesave me Vlerë të Vogël	78
Shtojca 3: KIPT - Banka Botërore "Aspektet e pagesës të përfshirjes financiare”	80
Shtojca 4: KSPSH - Banka Botërore "Parimet e Përgjithshme për Shërbimet Ndërkombëtare të Dërgesave të Emigrantëve" dhe role të ngjashme.....	82

FALËNDERIME

Strategjia Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël në Shqipëri është rezultat i angazhimit të përbashkët të aktorëve publikë dhe privatë shqiptarë, nën drejtimin e Bankës së Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë falënderon përfaqësuesit e ministrive dhe agjencive të tjera qeveritare, bankat, ofruesit jobanka të shërbimeve të pagesave, ofruesit e shërbimeve teknike, shoqatat e industrisë dhe aktorët e tjerë kontribues, për kohën dhe mendimet e tyre, dhënë në disa takime dypalëshe dhe në mbledhjen e Komitetit Kombëtar të Sistemeve të Pagesave në Qershor 2018. Pa kontributin thelbësor të tyre, hartimi i këtij dokumenti nuk do të ishte bërë i mundur.

Banka e Shqipërisë gjen rastin të falënderojë Grupin e Bankës Botërore (*Finance & Markets Global Practice*), për asistencën e vazhdueshme dhe bashkëpunimin në hartimin dhe zbatimin e programeve të ndryshme për reformimin e shërbimeve të pagesave në Shqipëri, në përgjithësi, si dhe për mbështetjen e tyre në zhvillimin e këtij dokumenti në veçanti. Ky është një rezultat kyç i Programit për Remitancat dhe Pagesat (RPP), i financuar nga Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike, Zvicër (*SECO*).

LISTA E AKRONIMEVE DHE SHKURTIMEVE

SHSHB	Shoqata Shqiptare e Bankave	NJKT	“Njih klientin tënd”
ACH	<i>Automated clearing house</i>	MDR	Norma e zbritjes për tregtarin
AECH	Sistemi shqiptar i klerimit të pagesave me vlerë të vogël	MIC	Vend me të ardhura mesatare
AIPS	Sistemi shqiptar i pagesave ndërbankare me vlerë të madhe	MTO	<i>Money Transfer Operatores</i> (Operatori i transferimit të parave)
LEK	Monedha shqiptare	IFJB	Institucion financiar jobankë
PPP	Parandalimi i pastrimit të parave	OJQ	Organizatë joqeveritare
ATM	ATM/bankomat	SKP	Sistemi Kombëtar i Pagesave
BIS	Banka për Rregullime Ndërkombëtare	KKSP	Komiteti Kombëtar i Sistemit të Pagesave
BSH	Banka e Shqipërisë	SKPVV	Strategjia Kombëtare e Pagesave me Vlerë të Vogël
CCD	<i>Customer due diligence</i> (vlerësim tërësor i klientit)	P2B	Marrëdhënie person-biznes
LFT	Lufta kundër financimit të terrorizmit	P2P	Marrëdhënie person-person
KIPT	Komiteti për Infrastrukturat e Pagesave dhe Tregut	PITF	Parimet për infrastrukturën e tregut financiar
EAQ	Evropë dhe Azi Qendrore	POS	Terminal pikë shitjeje
BE	Bashkimi Evropian	PSD	Direktiva për shërbimet e pagesave
ITF	Infrastruktura e tregut financiar	OSP	Operator i sistemeve të pagesave
G2B	Marrëdhënie qeveri-biznes	OSHP	Ofrues i shërbimit të pagesave
G2P	Marrëdhënie qeveri-person	RTGS	Sistemi i shlyerjeve bruto në kohë reale
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto	SHKK	Shoqëri e Kursim-Kreditit
ILF	Lehtësira për likuidet brenda ditës	ISSH	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
IOSCO	Organizata ndërkombëtare e komisioneve të letrave me vlerë	GBB	Grupi i Bankës Botërore

PËRMBLEDHJE

- i. Përqasja strategjike për zhvillimin e pagesave me vlerë të vogël në Shqipëri bazohet në një vizion të qartë:** të krijojë një treg bashkëkohor dhe gjithëpërfshirës të pagesave me vlerë të vogël, të mbështetur nga infrastruktura të sigurt dhe eficiente, si dhe nga një gamë e gjerë instrumentesh dhe shërbimesh të pagesave që përmbushin nevojat e përdoruesve të tyre, të aftë financiarisht, në të gjithë vendin.
- ii. Strategjia Kombëtare e Pagesave me Vlerë të Vogël (SKPVV) ndërtohet mbi bazën e përpjekjeve të ndërmarra për një dekadë nga Banka e Shqipërisë (BSH), në bashkërendim me autoritetet e sektorit publik dhe të sektorit privat, për të modernizuar sistemin kombëtar të pagesave (SKP) në Shqipëri.** Ndër arritjet në këtë drejtim janë: zbatimi i sistemeve të sigurt dhe eficiente të klerimit dhe të shlyerjeve për pagesat ndërbankare; miratimi i një kuadri ligjor dhe rregullator të shëndoshë dhe gjithëpërfshirës, një kuadër formal bashkëpunimi ndër-institucional nën drejtimin e BSH-së; si dhe, rritja e punës kërkimore për sistemin e pagesave. Gjatë pesë viteve të fundit, pagesat në formë elektronike janë rritur në mënyrë të qëndrueshme, ndërsa janë bërë të disponueshme edhe instrumente të reja pagesash (për shembull, para elektronike).
- iii. Pavarësisht nga përparimi i deritanishëm, zhvillimi i një tregu gjithëpërfshirës të pagesave me vlerë të vogël në Shqipëri do të përbëjë një sipërmarrje të madhe kombëtare.** Ndonëse Shqipëria është një ekonomi në rritje, më pak se 40% e popullsisë në moshë madhore në vend përdorin një llogari transaksioni¹ me një bankë apo me ofrues të tjerë të rregulluar të shërbimeve të pagesave. Gjithashtu, përdorimi i këtyre llogarive është më i ulët, krahasuar me vende me rritje ekonomike të ngjashme. Për shembull, numri i përgjithshëm i transaksioneve të pagesave që nuk kryhen me para fizike, për banor në Shqipëri, në vitin 2016, ishte 4.3. Ndërkohë, mesatarisht, vendet me të ardhura mbi nivelin

¹ Llogaritë e transaksioneve përkufizohen si llogari (përfshirë dhe ato të parasë elektronike) të mbajtura në bankë apo tek ofrues të tjerë të autorizuar/të rregulluar për shërbimet e pagesave (OSHP), të cilat mund të përdoren për të dërguar e për të marrë para, si dhe për të ruajtur vlera. Llogaritë e transaksioneve mund të përdoren si mundësi për të aksesuar shërbimet e tjera financiare.

mesatar raportojnë se më shumë se 40 transaksione për banor nuk kryhen me para fizike². Mesatarisht, vendet me të ardhura më të larta se mesatarja kanë norma zotërimi të llogarisë prej 70% të popullsisë në moshë madhore³. Si rrjedhim, përdorimi i parasë fizike i ka rrënjët thellë në zakonet e pagesave të konsumatorëve dhe bizneseve shqiptare. Nga gjithë pagesat e iniciuara nga konsumatorët, 96% janë kryer me para fizike, krahasuar me 90% të pagesave të përfituara. Po kështu, bizneset në Shqipëri marrin 99.2% të të gjitha pagesave në vëllim në para fizike, ndërsa 66% e pagesave të iniciuara nga bizneset janë me para fizike. Kjo varësi e lartë nga para fizike ka ndikime të konsiderueshme në kostot e përdoruesve: kostoja agregate e parasë fizike vetëm në anën e kërkesës është rreth 1% dhe konsumatorët mbartin peshën më të lartë, ndërsa mbi bazë transaksioni, transfertat e kreditit me letër janë instrumenti më i kushtueshëm i pagesës.

- iv. Arsyet për përdorimin ende të ulët të pagesave që nuk kryhen me para fizike në Shqipëri variojnë duke filluar nga numri i ulët i personave madhorë që kanë një llogari, deri tek forma e produkteve të ndryshme të pagesave të disponueshme në vend, pikat e pamjaftueshme të aksesit në shërbim dhe të pranimit të pagesave elektronike, niveli i ulët i kulturës financiare dhe informaliteti i lartë në ekonomi dhe në tregun e punës.** Një pjesë më e madhe e personave në moshë madhore që kanë një llogari transaksionesh ka shumë të ngjarë të çojë në një përdorim më të lartë të instrumenteve të pagesave që nuk kryhen me para fizike, megjithatë jo domosdoshmërisht. Mbajtësit e një llogarie mund të vendosin të mos përdorin variantin e kryerjes së pagesave jo me para fizike, për shkak të një arsyeje madhore, si p.sh. fakti se ato nuk i përmbushin nevojat e tyre, si dhe sepse nuk mund të përdoren lehtësisht në pikën e tregimit. Një arsye tjetër, mund të jetë se ata shpesh nuk janë mjaftueshëm të ndërgjegjshëm për to dhe nuk kanë aftësi të mjaftueshme për përdorimin e efektshëm të llogarive të tyre dhe shërbimeve të parasë elektronike. Nga ana tjetër, nivelet e larta të informalitetit në ekonomi dhe në tregun e punës ndikojnë në numrin e ulët të personave madhorë që kanë dhe përdorin rregullisht një llogari,

² Të dhënat e Bankës Botërore 2015 nga Vëzhgimi Global i Sistemeve të Pagesave

³ World Bank Global Findex data, 2014.

dhe rrjedhimisht kanë një parapëlqim të fortë për paranë fizike, gjë që nuk ndihmon në qasjen ndaj pagesave elektronike.

- v. **SKPVV-ja për Shqipërinë ofron një udhëzues strategjik të nivelit të lartë për rrugën që duhet të ndiqet për krijimin e një tregu bashkëkohor dhe gjithëpërfshirës të pagesave kombëtare me vlerë të vogël, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, me parimet udhëzuese listuar më poshtë.**

- **Parimi udhëzues 1: Transparencë, paanshmëri dhe mbrojtje e përdoruesve.** Transparenca është thelbësore për rritjen e konkurrencës dhe forcimin e mbrojtjes së përdoruesve në fushën e pagesave me vlerë të vogël. Paanshmëria në tregun e brendshëm të pagesave me vlerë të vogël siguron perceptimin e pjesëmarrësve se interesat dhe nevojat e tyre individuale janë marrë parasysh dhe janë trajtuar në mënyrën e duhur. Përpjekjet për mbrojtjen e konsumatorit reduktojnë çekuilibrat e informacionit, të burimeve dhe të pushtetit, të cilat janë karakteristika të një marrëdhënieje shërbimi midis individëve/bizneseve të vogla nga njëra anë dhe bankave/ofruesve të shërbimeve nga ana tjetër. Në fund, përpjekjet për edukimin financiar rrisin aftësitë e përdoruesve potencialë dhe ekzistues të shërbimeve financiare.
- **Parimi udhëzues 2: Strukturë moderne dhe ndërvepruese e pagesave dhe rrjetet e pikave të aksesit.** Infrastruktura moderne e pagesave do të zhvillohet për të mbështetur përpunimin e të gjitha instrumenteve përkatëse të pagesave në mënyrë të shpejtë, efiçente dhe të plotë, si edhe për të mundësuar përhapjen e shërbimeve inovative të pagesave. Të gjitha infrastrukturat e pagesave të vlerësuara me rëndësi sistemike nga BSH-ja do të jenë në përputhje me Parimet për Infrastrukturat e Tregjeve Financiare (PFMIs) të CPMI-IOSCO. Infrastrukturat e tjera të pagesave do të jenë, të paktën, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. Herë pas here, BSH-ja do të vlerësojë shkallën e rrezikut sistematik të infrastrukturave dhe do të udhëzojë mbi standardet ndërkombëtare/praktikat më të mira. Infrastrukturat e pagesave dhe rrjetet e pikave të aksesit do të jenë ndërvepruese, duke rritur kështu

eficiencën dhe duke mundësuar përdorimin e vazhdueshëm të produkteve të pagesave në të gjithë vendin, me kosto të arsyeshme.

- **Parimi udhëzues 3: Kuadër i duhur ligjor dhe rregullator.** Rregullat jodiskriminuese për hyrje dhe kushtet për pjesëmarrje në treg, për të ofruar shërbimet e pagesave me vlerë të vogël do të ruhen dhe do të përmirësohen sa herë që të jetë e nevojshme. Rregullorja e pagesave do të përditësohet vazhdimisht në përputhje me zhvillimet e tregut në Shqipëri dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.
- **Parimi udhëzues 4: Konkurrencë e fortë, e plotësuar me bashkëpunim.** Tregu për ofrimin e shërbimeve të pagesave do të mbrohet ndaj sjelljes jokonkurrense dhe abuzimit me pozicionin mbizotërues, ndër të tjera, edhe nëpërmjet monitorimit nga afër. Do të kërkohet të arrihet balanca e duhur midis konkurrencës dhe bashkëpunimit brenda industrisë së pagesave me vlerë të vogël. Iniciativat e sektorit privat do të mbështeten për t'u bërë një forcë vetënxitëse në zhvillimin e SKP-së të sigurt dhe eficient.
- **Parimi udhëzues 5: Qeverisje dhe përgjegjësi për rrezikun.** Një kuadër i duhur për administrimin e rrezikut do të siguronte identifikimin e rreziqeve dhe kostot në tregun e pagesave me vlerë të vogël, si dhe trajtimin e duhur të tyre. Do të kërkohet të arrihet ruajtja e një ekuilibri midis uljes së rrezikut dhe kostove të lidhura me të, duke pasur parasysh se zhvillimet e reja të tregut, herë pas herë, ndryshojnë ekuilibrin aktual. Do të ndiqet një përjasje progresive, por e kujdesshme, në përgjigje të zhvillimeve të reja teknologjike. Marrëveshje të shëndosha dhe efektive do të theksojnë ofrimin dhe shkëmbimin e shërbimeve infrastrukturore nga institucionet publike ose ato të sektorit privat.
- **Parimi udhëzues 6: Mbikëqyrje efektive.** Nëpërmjet mbikëqyrjes, BSH-ja do të ketë qëllim të kujdeset për sigurinë e tregut të pagesave me vlerë të vogël, dhe të SKP-së më gjerë, duke nxitur efektshmërinë, përbalueshmërinë dhe natyrën gjithëpërfshirëse të tij. Në ushtrimin e përgjegjësisë së saj mbikëqyrëse, BSH-ja do të vazhdojë të zbatojë praktikatat më të mira, në përputhje me parimet dhe standardet e hartuara nga komuniteti financiar ndërkombëtar. Si pjesë e veprimeve të saj

mbikëqyrëse, BSH-ja do të sigurojë një politikë dialogimi të vazhdueshëm me të gjithë aktorët përkatës të tregut të pagesave me vlerë të vogël. Si katalizator për ndryshime, BSH-ja do të miratojë dhe/ose nxisë masa për të lehtësuar një zhvillim dhe avancim më të shpejtë të tregut të pagesave me vlerë të vogël.

vi. SKPVV-ja përcakton një kuadër të detajuar për zgjerimin e aksesit në llogaritë e transaksioneve dhe për përshpejtimin e përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike, përfshirë tetë fusha veprimi.

- 1. Angazhim më i lartë i aktorëve**, nëpërmjet: (i) Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave (KKSP) me pjesëmarrje të gjerë nën drejtimin e BSH-së; (ii) një përjasjeje të kujdesshme, të bashkërenduar dhe strategjike për të rritur aksesin dhe për të çuar më tej përfshirjen financiare; dhe, (iii) rritjes së kapaciteteve dhe ekspertizës, lidhur me çështjet e pagesave me vlerë të vogël.
- 2. Konsolidimi i një mjedisi rregullator mbështetës për pagesat me vlerë të vogël**, duke: (i) siguruar paanshmëri dhe proporcionalitet në licencimin dhe rregullimin e ofruesve të shërbimit të pagesave; (ii) mundësuar modele inovative të biznesit, të cilat lehtësojnë përdorimin për palët e treta (për shembull, shërbime agjenti) dhe burime nga jashtë; (iii) forcuar bazën ligjore mbikëqyrëse të BSH-së për shërbimet e pagesave; (iv) hartuar kuadrin për mbrojtjen e konsumatorit, përfshirë mekanizmat monitorues dhe detyrues, si dhe duke zgjidhur mosmarrëveshjet në mënyrë efektive; dhe, (v) forcuar strukturën e përputhshmërisë në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave (PPP) dhe luftën kundër financimit të terrorizmit (LFT).
- 3. Përmirësime të sistemit të pagesave dhe infrastrukturës mbështetëse**, përfshirë: (i) intensifikimin e përpjekjeve bashkëpunuese për t'u siguruar që infrastruktura kombëtare (*SWITCH*) për pagesat me kartë fillon veprimet në shkallë të plotë - me pjesën më të madhe ose me të gjithë lëshuesit dhe pranuesit e kartave, sa më shpejt që të jetë e mundur, sipas marrëveshjeve përkatëse të drejtimit; (ii) analizimin e implementimit të mundshëm të infrastrukturës për të mundësuar procesimin e “*instant payments*” në nivelin e pagesave me vlerë të vogël (iii) zbatimin e një politike për një akses të drejtë dhe të hapur në infrastrukturën e pagesave; (iv) zbutjen e efektshme të

rreziqeve financiare në infrastrukturat e pagesave; (v) shfrytëzimin e plotë të infrastrukturës aktuale të ID-ve dhe shërbimeve bashkëkohore të identifikimit për proceset e njohjes së klientit.

4. **Shërbimet e pagesave me në qendër klientin dhe të përballueshme për të, bazuar në llogari**, të cilat përkthehen në: (i) dizenjimi i produkteve konvencionale të pagesave për individët të cilët nuk zotërojnë llogari bankare, të cilat janë të përballueshme, duke ruajtur gjithsesi tiparet thelbësore të një llogarie transaksioni; (ii) krijimin e produkteve të pagesave më të volitshme në përgjithësi, duke mundësuar ndërveprim të të gjitha llogarive të transaksioneve (domethënë midis llogarive rrjedhëse bankare dhe llogarive të parasë elektronike); (iii) përdorimin e tarifimit si nxitës për përdorimin e pagesave elektronike; dhe, (iv) rishikimin/publikimin e rregullt të bazës së të dhënave të vetë BSH-së për tarifatat e shërbimeve bankare, si instrument në duart e klientëve, për të krahasuar në mënyrë efektive produktet.
5. **Zgjerim i pikave të aksesit dhe rrjeteve për pagesat**, duke: (i) zhvilluar modelin e agjentit të bankës për të rritur aksesin dhe lehtësinë e përdorimit të llogarive rrjedhëse bankare për individët, përfshirë shfrytëzimin e infrastrukturës së subjekteve me një prani tradicionalisht më të fuqishme në komunitetet rurale dhe të izoluar; (ii) siguruar ndërveprim midis kanaleve dhe rrjeteve të pagesave, të cilat përgjithësisht janë të ndaluara në mënyrë përjashtuese; (iii) analizuar mundësinë e përdorimit të incentiveve për tregtarët (për shembull, subvencione të përkohshme fiskale për bizneset e vogla dhe/ose lloje të tjera të përfitimeve fiskale) për të pranuar pagesa elektronike; dhe (iv) rritur transparencën dhe mbledhjen e të dhënave për komisionet e zbritshme nga tregtarët.
6. **Përpjekje efektive në lidhje me kulturën financiare**, që kanë për qëllim: (i) të rrisin ndërgjegjësimin e publikut për SKPVV-në dhe përfitimet prej saj; (ii) të informojnë dhe edukojnë përdoruesit aktualë dhe ata potencialë për llogaritë dhe pagesat elektronike, duke intensifikuar dhe rifokusuar përpjekjet ekzistuese; (iii) të ndërthurin mësimin praktik si pjesë të praktikës me konsumatorët në bankë/institucion financiar jobankë; (iv) të rrisin ndërgjegjësimin për përfitimet e përdorimit të portalit e-Albania; dhe (v) të matin efektivitetin e përpjekjeve dhe programeve për edukimin financiar.

7. **Ekonomitë e shkallës në SKP, duke shfrytëzuar rastet e përdorimit të pagesave me vëllim të madh.** Veprimet specifike përfshijnë: (i) kalimin e të gjitha pagesave dhe arkëtimeve të qeverisë, në mënyrë që të realizohen në formë elektronike në një shkallë sa më të gjerë të mundshme, përfshirë shfrytëzimin e përdorimit të produkteve “bazë” të llogarive dhe modeleve/kanaleve jobankare; (ii) të bazuarit tek faturat utilitare dhe pagesat tranzitore në grup për të përshpejtuar kalimin nga paraja fizike tek pagesat elektronike; dhe (iii) mundësimin e realizimit të shërbimeve të remitancave nëpërmjet llogarive sesa nëpërmjet parave fizike në Shqipëri, duke rritur konkurrencën dhe duke forcuar inovacionin në tregun shqiptar të remitancave. Veprimet e fundit do të përfitojnë nga bashkërendimi me Planin e Veprimit dhe Strategjinë Kombëtare për Diasporën dhe Migracionin (2018-2024).
8. **Mbikëqyrje efektive e tregut të pagesave me vlerë të vogël dhe e ofruesve të shërbimeve të pagesave nga BSH-ja.** Në këtë fushë BSH: (i) do të rishikojë kuadrin e saj ligjor dhe të politikave për të përfshirë në mënyrë eksplicite e të qartë shërbimet e pagesave në fushën e zbatimit të mbikëqyrjes së BSH-së; (ii) do të sigurojë që ofruesit e shërbimit të pagesave dhe operatorët e sistemit të pagesave të rishikojnë rregullisht strukturën e tyre të kostove dhe të çmimit, dhe që të shmangin çdo praktikë çmimi abuzive; (iii) në bashkëpunim me Autoritetin e Konkurrencës, nuk do të lejojë praktika jokonkurruese në tregun e pagesave me vlerë të vogël, duke përfshirë monitorimin e çdo veprimi nga aktorët e tregut që ka për qëllim mohimin, fshehjen ose kufizimin e aksesit në shërbime që përfshijnë konkurrentët; (iv) do të sigurojë që kontratat të cilat përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet, si për ofruesit e shërbimit edhe për përdoruesit, të jenë të përcaktuara dhe të zbatohen në mënyrë të qartë; dhe, (v) do të mbajë një regjistër publik të agentëve të përdorur nga banka dhe ofruesit e tjerë të shërbimit të pagesave.
- vii. **Zbatimi i suksesshëm i strategjisë do të kërkojë që aktorëve të ndryshëm t’u caktohen role dhe përgjegjësi specifike, sipas rregullave të përgjegjesisë publike**
- a. SKPVV-ja përcakton se BSH-ja ka një rol kryesor për mbështetjen e bashkëpunimit dhe bashkërendimit midis pjesëmarrësve për zbatimin e strategjisë, dhe nxitjen e një

veprimi kolektiv nga pjesëmarrësit, kurdo qoftë e nevojshme. Ky rol përmbushet nga BSH-ja në cilësinë e saj si katalizatore e reformës së sistemit të pagesave, rregullatore, mbikëqyrëse, operatore e sistemit të pagesave dhe përdoruese e shërbimeve të pagesave.

- b. Përveç kësaj, SKPVV-ja i përcakton përgjegjësi Shoqatës Shqiptare të Bankave (SHSHB), të cilat renditen nga bashkërendimi dhe përfaqësimi i interesave të anëtarëve të saj për çdo çështje lidhur me SKPVV-në, në nxitjen dhe bashkërendimin e nismave për të krijuar infrastrukturën dhe integrimin privat të pagesave me vlerë të vogël, hartimin dhe miratimin e standardeve të përgjithshme, dhe lehtësimin e ndërveprimit.
- c. KKSP-ja, si strukturë këshilluese për çështjet e sistemit të pagesave, do të përfshihet kryesisht në monitorimin e progresit, dhe do të pozicionohet sa më mirë për të përshpejtuar progresin, kur të jetë i nevojshëm, dhe për të lehtësuar komunikimin midis aktorëve të sektorit privat dhe atij publik.
- d. Agjencitë qeveritare që mbajnë përgjegjësi rregullatore në fusha që lidhen ngushtë me SKPVV-në, me gjasë, do të kenë role dhe përgjegjësi të rëndësishme.
- e. Ofruesit e shërbimit të pagesave do të kontribuojnë në zbatimin e SKPVV-së, duke u angazhuar në transparencën ndaj klientëve të tyre lidhur me zhvillimin e veprimtarisë, dhe duke administruar të gjitha rreziqet e lidhura me ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe përvetësuar udhëzimet strategjike të miratuara nga KKSP-ja.
- f. Operatorët e sistemeve të pagesave do të mbështesin objektivat e SKPVV-së duke u angazhuar në bashkëveprim dhe bashkërendim, sipas standardeve ndërkombëtare; ndjekur praktikën më të mirë; dhe ruajtur një akses të drejtë dhe të hapur ndaj infrastrukturës, ndërsa përvetësojnë udhëzimet strategjike të miratuara nga KKSP-ja.
- g. Së fundmi, shoqatat e industrisë dhe organizatat e shoqërisë civile do të angazhohen për çështje specifike, sipas objektivave dhe përgjegjësisë të tyre statutorë, dhe me kërkesë të KKSP-së, për mbështetjen e strategjive të zbatimit dhe përfshirjen e tyre në “*buy-in*”.

viii. Monitorimi i progresit në zbatimin e SKPVV-së është thelbësor për të përcaktuar efektivitetin e saj dhe shërben si informacion për rishikime dhe vlerësime në periudha të rregullta kohore. Për këtë qëllim, që në fillim, janë përcaktuar dy objektiva si matës kryesorë:

- 1. Rritja e numrit aktual të pagesave jo cash për frymë me 130%, në 10 pagesa të tilla, deri në fund të vitit 2022. Ky raport ishte 4.3 pagesa për frymë në fund të vitit 2016, vlerë e cila do të shërbejë si pikë fillestare.**

 - 2. Raporti i zotërimit të llogarive nga personat madhorë të arrijë vlerën 70% deri në vitin 2022. Ky raport ishte 38%, në fund të vitit 2014, vlerë e cila do të shërbejë si pikë fillestare.**
- ix.** Disa “variabla të ndërmjetëm” që masin progresin në lidhje me vizionin e pranuar dhe objektivat gjithëpërfshirës do të maten dhe do të monitorohen. Kjo do të ndihmojë në identifikimin e kërkesave të mundshme për marrjen e masave të menjëhershme korrigjuese.
- x.** **SKPVV-ja është diskutuar dhe rishikuar në forume të shumta, si pjesë e procesit të pranimi dhe zotërimit të kësaj strategjie nga palët e rëndësishme të interesit.**

I. E ARDHMJA E PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL NË SHQIPËRI: VIZIONI YNË

Të krijojmë një treg bashkëkohor dhe gjithëpërfshirës të pagesave me vlerë të vogël, të mbështetur nga infrastruktura të sigurta dhe eficiente, dhe nga një gamë e gjerë e instrumenteve dhe shërbimeve të pagesave që përmbushin nevojat e përdoruesve të aftë financiarisht për të kryer pagesa në të gjithë vendin.

Qëllimi ynë është që përmirësimet në tregun e pagesave me vlerë të vogël t'u japin qytetarëve shqiptarë më shumë mundësi zgjedhjeje të vendeve të ndryshme për të kryer transaksionet e tyre të përditshme, në mënyrë të lehtë dhe me kosto efektive, duke mbështetur objektivin e një përfshirjeje më të gjerë financiare.

II. HYRJE

1. **Banka e Shqipërisë (BSH), në bashkëpunim me autoritete të tjera të sektorit publik dhe atij privat, ka udhëhequr reformën në sistemin e pagesave në Shqipëri për më shumë se një dekadë.** Ndër arritjet më kryesore, deri më tani, janë zbatimi i sistemeve bashkëkohore për përpunimin e sigurt dhe eficient të pagesave në të gjithë sektorin bankar, së bashku me një kuadër ligjor dhe rregullator të shëndoshë dhe gjithëpërfshirës.
2. **Sot, pjesëmarrësit po e rrisin fokusin e tyre në fuqizimin e tregut të pagesave me vlerë të vogël në Shqipëri dhe, deri më sot, kanë zhvilluar këtë Strategji Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël (SKPVV).** SKPVV-ja shqiptare është rezultat i një përpjekjeje të përbashkët të pjesëmarrësve si nga sektori publik ashtu dhe ai privat në Shqipëri, nën drejtimin e BSH-së.
3. **Pagesat me vlerë të vogël, kryesisht, kryhen për dhe nga individët, si dhe midis individëve, bizneseve dhe subjekteve qeveritare.** Tregu i pagesave me vlerë të vogël këtu konceptohet si tërësia e infrastrukturave teknike, pjesëmarrësve, instrumenteve, marrëveshjeve për klerim dhe shlyerje, dhe marrëveshjeve të marrëdhënies të biznesit (të tilla si marrëdhëniet bankë - klient, rregullat, procedurat, kuadri ligjor në fuqi, dhe marrëveshjet qeveritare). Të gjithë se bashku sigurojnë një mjedis të përgjithshëm në të cilin shërbimet e pagesave me vlerë të vogël ofrohen/blihen/përdoren, dhe në të cilin transaksionet e pagesave të mësipërme dërgohen, autorizohen, përpunohen, klerohen dhe shlyhen. Megjithëse tregu i pagesave me vlerë të vogël dhe sistemet nëpërmjet të cilave përpunohen këto pagesa rrallë shihen si “me rëndësi sistemike”⁴, ato kontribuojnë në stabilitetin dhe efektivitetin e sistemit financiar si një i tërë, si dhe në besimin e qytetarëve në monedhën vendase.

⁴ Sistemet e pagesave me rëndësi sistemike janë thelbësore për funksionimin e duhur të sistemit financiar - një dështim mund të çojë në ndërprerje apo të transmetojë goditje, si në nivel lokal/kombëtar ashtu dhe në nivel ndërkufitar. Sistemet e pagesave me vlerë të madhe që përpunojnë operacione ndërbankare të tregut të parasë, *këmbën cash* të tregimit të titujve dhe *këmbën cash* të tregimit në monedhë të huaj kualifikohen si sisteme të pagesave me rëndësi sistemike. Gjithashtu, disa transaksione të klientëve mund të përpunohen në sistemet e pagesave me vlerë të madhe. Herë pas here, BSH-ja do të vlerësojë shkallën e rrezikut sistematik të infrastrukturave dhe do t'i orientojë drejt standardeve ndërkombëtare/ praktikave më të mira përkatëse.

4. **Zhvillimi i një tregu gjithëpërfshirës për pagesat me vlerë të vogël në Shqipëri do të përbëjë një sipërmarrje të madhe kombëtare.** Pavarësisht se është një ekonomi në rritje, më pak se 40% e popullsisë në moshë madhore në vend përdorin një llogari transaksioni⁵ me një bankë, apo me ofrues të tjerë të rregulluar të shërbimit të pagesave, dhe përdorimi i këtyre llogarive është më i vogël krahasuar me vendet me rritje ekonomike të ngjashme. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të vihet në dukje se, duke pasur një llogari transaksioni, individët dhe bizneset mund të përfitojnë jo vetëm nga produktet dhe shërbimet e pagesave bashkëkohore që ofrohen nëpërmjet këtyre llogarive, por edhe nga aksesit dhe përdorimi më i gjerë i llogarive të transaksioneve, që janë gur themeli për përfshirje financiare më të gjerë, çka mundëson aksesin në një gamë të plotë të shërbimeve financiare, të tilla si: kredi, kursime dhe sigurime.
5. **SKPVV-ja ofron një udhëzues strategjik të nivelit të lartë në rrugën drejt krijimit të një tregu kombëtar bashkëkohor dhe gjithëpërfshirës për pagesat me vlerë të vogël, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.** Gjithashtu, ajo përcakton një kuadër të detajuar për zgjerimin e aksesit në llogaritë e transaksioneve dhe për të përshpejtuar përdorimin e instrumenteve të pagesave elektronike, përfshirë tetë fusha veprimi. Ky dokument është përgatitur nga BSH-ja, në bashkëpunim me përfaqësuesit e institucioneve të përmendura më parë, dhe pasqyron angazhimin e Shqipërisë për projektimin e të ardhmes së tregut të pagesave me vlerë të vogël.
6. **Dokumenti është udhëhequr nga vrojtimit dhe rekomandimet sipas Udhëzimeve të Bankës Botërore për Zhvillimin e një Strategjie Gjithëpërfshirëse Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël.** Këto udhëzime ofrojnë një kuadër për trajtimin e pengesave dhe kufizimeve kryesore që hasen me forcimin e zhvillimit të një tregu bashkëkohor të pagesave me vlerë të vogël, që kanë për qëllimin arritjen e një ekuilibri midis konkurrencës dhe bashkëpunimit, aksesit dhe përballueshmërisë. Udhëzimet e sipërpërmendura trajtojnë çështjet thelbësore në lidhje me: i) transparencën, efektivitetin dhe mbrojtjen e konsumatorit; ii) infrastrukturën; iii) aspektin ligjor dhe

⁵ Llogaritë e transaksioneve përkufizohen si llogari (përfshirë dhe ato të parasë elektronike) të mbajtura në bankë apo tek ofrues të tjerë të autorizuar/të rregulluar për shërbimet e pagesave (OSHP-ve), të cilat mund të përdoren për të dërguar dhe për të marrë para dhe për të ruajtur vlera. Llogaritë e transaksioneve mund të përdoren si portë hyrëse në aksesimin e shërbimeve të tjera financiare.

rregullator; iv) konkurrencën; v) drejtimin dhe administrimin e rrezikut; dhe vi) mbikëqyrjen. Dobësitë dhe çekuilibrat në njërin nga këto fusha thelbësore mund të ngadalësojnë ose ndërpresin zhvillimin në një treg bashkëkohor të pagesave me vlerë të vogël.

- 7. Pas përshkrimit të gjendjes aktuale të tregut të pagesave me vlerë të vogël në Shqipëri, dokumenti përcakton parimet që do të udhëheqin zgjidhjet strategjike për t'u ndërmarrë në një periudhë afatshkurtër dhe afatmesme nga BSH-ja dhe komuniteti i pjesëmarrësve.** Dokumenti identifikon objektivat strategjike që duhen ndjekur, dhe përcakton fushat dhe veprimet që duhen zbatuar për të arritur objektivat e identifikuar. Ky dokument, gjithashtu, ilustron instrumentet e pagesave, marrëveshjet institucionale dhe infrastrukturore, infrastrukturat financiare që duhet të ngrihen, si dhe metodën strategjike që duhet përdorur. Në fund është përcaktuar një plan zbatimi me treguesit e veprimeve specifike që duhen ndërmarrë, rolet dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve të ndryshëm, si dhe përparësia përkatëse në zbatimin e planit.

- 8. Përmbajtja e këtij dokumenti është diskutuar dhe rishikuar në forume të ndryshme, si pjesë e procesit të pranimit dhe zotërimit nga palët e rëndësishme të interesit.**

III. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI PAGESAT ME VLERË TË VOGËL NË SHQIPËRI

Pjesëmarrësit kryesorë

9. Pjesëmarrësit kryesorë në tregun shqiptar të pagesave me vlerë të vogël përfshijnë Bankën e Shqipërisë (BSH), e cila është në krye si autoriteti monetar dhe mbikëqyrës, bankat tregtare dhe ofrues e operatorë të tjerë të shërbimit të pagesave, dhe komunitetin e përdoruesve të shërbimeve të pagesave. Bankat tregtare, institucionet financiare jobanka (IFJB), shoqëritë e kursim-kreditit (SHKK) dhe unionet e tyre licencohen dhe mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë. Institucionet e tjera financiare, ku përfshihen kompanitë e sigurimeve, fondet e pensionit dhe fondet e investimit, mbikëqyren nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.
10. BSH-ja luan role kryesore të natyrave të ndryshme në sistemin kombëtar shqiptar të pagesave, duke vepruar si: operatore e sistemit të pagesave; mbikëqyrëse e sistemit kombëtar të pagesave; dhe katalizatore e ndryshimeve. Si operatore e sistemeve të pagesave, BSH-ja zotëron dhe operon sistemin e pagesave ndërbankare me vlerë të madhe – AIPS - i cili përbën shtyllën e infrastrukturës së tregut financiar të vendit, si dhe sistemin e klerimit të pagesave me vlerë të vogël – AECH. Të dy sistemet përshkruhen më në detaj më poshtë.
11. BSH-ja, sipas ligjit, është rregullatori dhe mbikëqyrësi i sistemit kombëtar të pagesave në Shqipëri. Këto të drejta në mënyrë eksplicite përfshijnë sistemet e pagesave dhe të shlyerjes së titujve, si dhe instrumentet e pagesave. Me qëllim ushtrimin e përgjegjësive të saj mbikëqyrëse, BSH-ja ka krijuar Sektorin e Mbikëqyrjes brenda Departamentit të Sistemit të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës.
12. Së fundmi, BSH-ja kontribuon edhe në zhvillimin dhe reformimin e sistemit kombëtar të pagesave në cilësinë e katalizatorit të ndryshimeve. Në këtë rol, BSH-ja inicion, bashkërendon, hulumton dhe këshillon mbi skemën, operimin dhe politikën e sistemit të pagesave, këshillon qeverinë për çështje që lidhen me sistemin e pagesave, dhe kontribuon në hartimin e propozimeve ligjore në fushën e sistemeve të pagesave.

13. Komiteti Kombëtar i Sistemit të Pagesave (KKSP) në Shqipëri është krijuar kohët e fundit. KKSP-ja ka për qëllim që, nëpërmjet veprimtarisë së tij, të mbështesë dhe të kontribuojë në rritjen e sigurisë, qëndrueshmërisë dhe efektshmërisë së sistemit kombëtar të pagesave në Shqipëri. KKSP-ja nuk ka personalitet juridik dhe vendimet e tij nuk janë detyruese për anëtarët pjesëmarrës. KKSP-ja, deri më tani, është mbledhur tri herë. Mbledhja e fundit u mbajt në muajin maj 2017.
14. Deri në tetor 2016, në vend kishte 16 banka dhe 9 IFJB të licencuara për të ofruar shërbimet e pagesave. Bankat tregtare zotërojnë pothuajse 91% të totalit të aktiveve financiare, dhe janë ofruesit kryesorë të shërbimeve të pagesave. Nëntë nga IFJB-të janë licencuar për të ofruar shërbime pagesash; dy kanë marrë të drejtën të emetojnë para elektronike; të tjerat marrin pjesë në dhënien e shërbimeve të pagesave të brendshme; dhe disa në dërgesat ndërkombëtare të emigrantëve.
15. Shoqëritë e Kursim-Kreditit (SHKK) kanë për qëllim të rrisin përfshirjen e tyre në sigurimin e shërbimeve të pagesave. Ato, për shkak të ndryshimeve të fundit ligjore⁶, kanë detyrimin ligjor të ofrojnë disa shërbime të pagesave (pagesa me para fizike, pasi SHKK-të nuk mund të emetojnë llogari rrjedhëse), megjithëse asnjë prej tyre nuk ka filluar të zbatojë ndonjë projekt specifik në këtë fushë.

⁶ Ligji 52/2016, datë 30.06.2016, "Për Shoqëritë e Kursim-Kreditit dhe Unionet e tyre".

Kuadri rregullator dhe ligjor

16. Baza ligjore për SKP-në rrjedh nga ligji “Për Bankën e Shqipërisë” i vitit 1997, i ndryshuar, ligji “Për sistemin e pagesave” i vitit 2013, si dhe ligji “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” i viti 2006. Ligji “Për sistemin e pagesave” vendos një bazë të shëndoshë ligjore për mirëfunksionimin e sistemit të dhe të instrumenteve të pagesave, duke ndërthurur konceptet ligjore themelore. Për më tepër, ligji “Për Bankën e Shqipërisë” dhe ligji “Për sistemin e pagesave”, në mënyrë të qartë, i japin autoritetin Bankës së Shqipërisë të veprojë si rregullator dhe mbikëqyrës të sistemit kombëtar të pagesave. Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë nxjerr rregullore, vendime, rregulla operationale, standarde dhe procedura që drejtojnë sistemet e pagesave që ajo operon, si dhe veprimtaritë e pjesëmarrësve të ndryshëm të SKP-së (për shembull operatorët e skemave të kartave të pagesave).
17. Po zhvillohet një kuadër ligjor që nxit risinë dhe konkurrencën në treg. Ligjet dhe rregulloret e BSH-së janë ndryshuar për t’iu përshtatur teknologjive dhe modeleve të reja të biznesit. Për shembull, ligji “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” ofron mundësinë që IFJB-të të konkurrojnë në tregun e pagesave, përfshirë emetimin dhe operimin e parasë elektronike (pasi të jenë licencuar si institucione të parasë elektronike). Më tej, janë krijuar themelet ligjore për sigurimin e shërbimeve financiare digjitale për pagesat elektronike, nënshkrimet elektronike, komunikimet elektronike dhe identifikimin elektronik të klientëve.
18. Kohët e fundit është prezantuar një kuadër gjithëpërfshirës ligjor dhe rregullator me masat për administrimin e rrezikut të pastrimit të parave (PPP) dhe të luftës kundër financimit të terrorizimit (LFT). Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshëm dhe ka zbatuar masat e kërkuara për forcimin e efektivitetit të sistemit të saj PPP. Ky kuadër ruan integritetin e sistemit financiar dhe, duke përvetësuar një metodologji të bazuar në rrezik, nuk pengon në mënyrë të panevojshme individët dhe bizneset që të kenë akses në përdorimin e shërbimeve financiare të rregulluara me ligj.
19. Në bazë të ligjeve ekzistuese, BSH-ja ka zhvilluar një tërësi rregulloresh që mbulojnë në detaje një gamë të gjerë aspektesh që lidhen me sistemet, instrumentet dhe

shërbimet e pagesave. Ndër të tjera, këtu përfshihen: rregulloret që përcaktojnë kriteret, procedurat dhe kushtet për licencimin e IFJB-ve për të ofruar shërbimet e pagesave, dhe për subjektet e licencuara për të operuar në sistemin e pagesave apo shtëpitë e klerimit; rregulloret për licencimin, operimin dhe administrimin e skemave të pagesave kombëtare me kartë; rregulloret për pagesat në formë elektronike; rregulloret për administrimin e rrezikut në veprimtaritë e pagesave të bankave dhe të IFJB-ve, përfshirë pagesat me jashtë; dhe rregulloret e PPP/FT-së.

20. Janë zhvilluar aspekte thelbësore për të mbështetur shtimin e veprimeve të klientit në llogaritë e transaksioneve dhe me instrumente bashkëkohore të pagesave, bazuar në ligje dhe rregullore të ndryshme. Shumë çështje në këtë fushë, të tilla si: mbrojtja e fondeve të klientëve të mbajtura në llogaritë e transaksioneve; transparencja në dispozitat e shërbimeve të pagesave; ose mekanizmat për pretendimet e konsumatorit përcaktohen në disa prej rregulloreve të BSH-së. Për më shumë, ekziston sigurimi i depozitave, i cili mbulon depozitat e parave në banka dhe në SHKK, ndërsa fondet në llogaritë e parasë elektronike mbrohen nëpërmjet dispozitave të tjera.⁷ Gjithashtu është miratuar ligji “Për mbrojtjen e konsumatorit” i vitit 2003, megjithëse ka një natyrë të përgjithshme, për arsye se nuk shënjestron në mënyrë specifike shërbimet e pagesave apo shërbimet e tjera financiare.

21. Për të trajtuar pjesën më të madhe të hapësirave të mbetura, Shqipëria do të intensifikojë përpjekjet e deritanishme për të harmonizuar legjislacionin kombëtar në përputhje me atë të Bashkimit Evropian (BE).⁸ Hapësirat për oportunitete në kuadrin ligjor dhe rregullator për pagesat përfshijnë arritjen e një metodologjie më të qëndrueshme në licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e bankave dhe institucioneve financiare jobanka që ofrojnë shërbimet e pagesave; sigurimin e një rregulloreje koherente në lidhje me nënkontraktimin e shërbimeve (*outsourcing*), duke përfshirë zhvillimin e një kuadri gjithëpërfshirës për përdorimin e agjentëve dhe nënagjentëve në sigurimin e shërbimeve të pagesave; dhe zhvillimin e një kuadri më të fortë për mbrojtjen e përdoruesve të shërbimeve të pagesave. Në këtë kontekst, BSH-ja tashmë është duke punuar në një numër projektesh, përfshirë: (i) përfarimin e Direktivës së BE-së për Shërbimet e Pagesave 2; (ii) përafrimin e mëtejshëm me Rregulloren e

⁷ Ligji i ndryshuar për Bankën në mënyrë të shprehur përjashton paranë elektronike nga koncepti i depozitës.

⁸ Shqipëria mori statusin e vendit kandidat për në BE në qershor 2014.

BQE-së 2014/28 (Rregullorja “Për kërkesat mbikëqyrëse për sistemet e pagesave me rëndësi sistemike”); dhe (iii) zbatimin në Shqipëri të “Rekomandimeve për sigurinë e pagesave nëpërmjet internetit”.

Përfshirja financiare në Shqipëri nga perspektiva e pagesave

22. Bazuar në bazën e të dhënave Global Findex, në vitin 2014, më pak se 40% e personave në moshë madhore⁹ në Shqipëri kishin llogari në një bankë apo në një ofrues tjetër të shërbimeve të pagesave. Duhet vënë në dukje se deri kohët e fundit, në Shqipëri, nuk kishte një koncept të tillë për “llogari transaksioni” ose “llogari pagesash”, dhe vetëm bankat mund të hapnin llogari. Ndryshimet në ligjin “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” në vitin 2011 (neni 4) dhe në vitin 2013, në rregulloret për licencimin e IFJB-ve, mundësuan veprimtarinë e emetimit të parasë elektronike. Deri më sot, janë licencuar dhe vepronë dy emetues jobanka të parasë elektronike.
23. Deri në fund të vitit 2015, individët zotëronin 3,094,995 llogari bankare rezidente dhe 18,347 llogari bankare jorezidente.¹⁰ Megjithatë, vlerësohet se vetëm rreth 700,000 individë të ndryshëm kanë llogari rrjedhëse në një bankë.¹¹ Lidhur me llogaritë e parasë elektronike me institucionet jobanka, numri total i llogarive të tilla të parasë elektronike që janë aktive (domethënë të paktën një transaksion në tre muaj) është rreth 60,000, ndjeshëm më shumë se 3% e popullsisë totale mbi moshën 15 vjeç në Shqipëri.¹²
24. Megjithëse ka pasur progres të moderuar nga viti 2011, pesha e personave në moshë madhore në Shqipëri që kishin një llogari në vitin 2014 mbetet ende e ulët krahasuar me vende të ngjashme në rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrorë (EAQ) dhe aq më shumë krahasuar me vendet me të ardhura mbi mesataren në rang botëror. Tabela 1 tregon të dhëna mbi mbajtjen dhe përdorimin e llogarive në Shqipëri në vitin 2014, dhe

⁹ Mosha 15 vjeç e sipër.

¹⁰ 192,995 llogari në banka rezidente dhe 1,326 llogari në banka jo rezidente.

¹¹ Në bazë të bazës së të dhënave Global Findex 2014 dhe në rezultatet e vërtetimit të konsumatorit të kryer nga Banka e Shqipërisë si pjesë e një studimi të BSH-së dhe Bankës Botërore për kostot e pagesave me vlerë të vogël në Shqipëri.

¹² Kjo do të thotë, të hamendësohet se të gjithë mbajtësit aktualë të llogarive të parave nëpërmjet shërbimit të telefonisë celulare janë individë që nuk janë të lidhur me një bankë, një rritje prej 3% e popullsisë e moshës 15 e sipër në Shqipëri tashmë kanë një llogari për të kryere dhe marrë pagesa dhe të ruajnë ca para nëpërmjet përdorimit të llogarive të parasë elektronike.

shifrat përkatëse për rajonin e EAQ si një i tërë, si dhe për vendet me të ardhura mbi mesataren.¹³

25. Tabela 1 tregon se përqindja e mbajtësve të llogarive në Shqipëri është disi më e ulët për femrat, personat e rinj në moshë dhe për ata që jetojnë në zona rurale.¹⁴ Kjo prirje përkon me të dhënat e vendeve të EAQ-së, por është ndjeshëm më e ulët për personat madhorë që i përkasin shtresës më të varfër prej 40%. Në Shqipëri, më pak se një në katër persona në moshë madhore që i përkasin grupit në fjalë kanë një llogari, krahasuar me pothuajse një në dy persona në vendet e tjera të EAQ-së dhe dy në tre në vendet me të ardhura mbi mesataren.¹⁵

Tabelë 1. Të dhënat bazë për mbajtjen dhe përdorimin e një llogarie në Shqipëri (në përqindje)

	Shqipëri	EAQ	Vendet me të ardhura mbi mesatare
Mbajtës llogarie (% e popullsisë e moshës 15+)			
Të gjithë personat në moshë madhore, viti 2014	38,0	51.4	70.5
Femra	33,6	47.4	67.3
Persona në moshë madhore të shtresës më të varfër	23,4	44.2	62.7
Persona në moshë madhore, të rinj (% mosha 15-24)	30,0	35.6	58.1
Persona në moshë madhore që jetojnë në zona rurale	33,2	45.7	68,8
Të gjithë personat në moshë madhore, viti 2011	28,3	43.3	57.4

Burimi: Banka Botërore Global Findex, 2014.

26. Shqipëria nuk ka një strategji formale për përfshirjen financiare, as nga autoritetet e sektorit publik dhe as nga industria bankare. Forma më e afërt e një strategjie formale në këtë fushë është strategjia afatmesme e KKSP-së për periudhën 2015-2020, e cila në Objektivin 7 përcakton “Nxitjen e përdorimit të instrumenteve dhe të sistemeve të pagesave, dhe rritjen e përfshirjes financiare”. Ajo, gjithashtu, përshkruan një numër masash për të arritur këto dhe objektiva të tjerë. Këto masa përfshijnë: i) zbatimin e Direktivës së Bashkimit Evropian “Për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm” (EU PSD 2); ii) krijimin e një strategjie për të ulur kostot e instrumenteve të pagesave;

¹³ Shqipëria klasifikohet nga Banka Botërore si një ekonomi me të ardhura mbi mesataren.

¹⁴ Kjo deri diku mund të shpjegohet me faktin se Qeveria e Shqipërisë vendosi me ligj kalimin e pagesave të punonjësve nëpërmjet sistemit bankar. Si u përmend më herët, normat e papunësisë për gratë, të rinjtë dhe personat madhorë në zonat rurale janë të larta. Kështu që, këto grupe kanë më pak të ngjarë të kenë një llogari.

¹⁵ Shifra krahasimore për rajonin e Afrikës Subsahariane është 24.6%.

dhe iii) kryerjen e studimeve për nevojat dhe mundësitë për zgjerimin e rrjeteve të ATM-ve dhe të POS-eve.

27. Megjithatë, në praktikë janë ndërmarrë nisma të ndryshme për përparimin e përfshirjes financiare në vend. Këto përpjekje janë udhëhequr kryesisht nga BSH-ja, SHSHB-ja dhe MAS-i.
28. Për më shumë, në vitin 2015, Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike ka publikuar Strategjinë e Agjendës Digjitale 2015-2020. Ndërsa, vetë strategjia nuk përfshin ndonjë referencë specifike për të arritur përdorimin më të gjerë të llogarive dhe të shërbimeve të tjera financiare nga individët dhe firmat në Shqipëri, ajo është thelbësore për materializimin e parakushteve të rëndësishme për përfshirjen financiare në Shqipëri (në lidhje me shërbimet financiare digjitale).
29. Ministri i Shtetit për Diasporën, i emëruar së fundmi, njoftoi projektin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën dhe Emigrantët, 2018-2024, që ka për qëllim të nxisë pjesëmarrjen e diasporës në zhvillimin ekonomik të vendit. Objektivat më të gjerë të kësaj iniciative dhe masa të caktuara janë në sinkron me aspekte të trajtuara në këtë SKPVV, veçanërisht lidhur me kanalizimin e dërgesave të emigrantëve nëpërmjet shërbimeve/produkteve të rregulluara, reduktimit të kostove, dhe përhapjes së informacionit/njohurive. Takimi i parë i Nivelit të Lartë për dërgesat e emigrantëve të Diasporës Shqiptare u mbajt në dhjetor 2017, në ambientet e Bankës së Shqipërisë.

Infrastruktura financiare që mbështet pagesat me vlerë të vogël në Shqipëri

Sistemi i pagesave ndërbankare me vlerë të madhe - AIPS

30. Nga këndvështrimi i infrastrukturës, shtylla kurrizore e sistemit të shlyerjeve në Shqipëri është sistemi AIPS. AIPS-i zotërohet dhe operohet nga Banka e Shqipërisë, ajo përbën sistemin e vetëm për shlyerjen e pagesave ndërbankare me vlerë të madhe në monedhën vendase, si dhe shlyerjen finale të detyrimeve që vijnë nga sistemet e tjera të pagesave dhe nga shtëpitë e klerimit në Shqipëri. AIPS-i është një sistem bashkëkohor RTGS (Sistemi për Shlyerjet Bruto në Kohë Reale), programi i të cilit u

përditësua në vitin 2013, dhe që u ofron bankave instrumentet e nevojshme për kryerjen e transaksioneve të pagesave, në mënyrë të sigurt dhe eficiente.

31. Aktualisht janë 16 pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në AIPS- të gjitha bankat e licencuara dhe vetë Banka e Shqipërisë. Neni 14 i Rregullores së AIPS-it i përcakton pjesëmarrësit në AIPS si ata “të cilët kryejnë pagesat direkt nga llogaritë e tyre të shlyerjes” në BSH, dhe e kufizon këtë pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në AIPS për bankat dhe BSH-në. Në praktikë, institucionet jobanka ndalohen të bëhen pjesëmarrëse të drejtpërdrejta në AIPS, për shkak të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”, i cili përcakton se vetëm bankat mund të hapin llogari dhe të mbajnë depozita në BSH. Ky kufizim zbatohet edhe ndaj operatorëve të sistemeve dhe shtëpive të tjera të klerimit, të cilët kanë nevojë të shlyejnë pozicionet e këtyre sistemeve dhe shtëpive të klerimi nëpërmjet një agjenti shlyerës (domethënë një banke tregtare ose BSH-së).

Sistemi i klerimit të pagesave me vlerë të vogël – AECH

32. Gjithashtu, BSH-ja zotëron dhe operon sistemin AECH, një sistem klerimi i automatizuar bashkëkohor, me një arkitekturë të përgjithshme të ngjashme me atë të AIPS-it. Megjithëse, në parim, AECH-ja mundëson përpunimin e transfertave të kreditit dhe debitimeve të drejtpërdrejta, deri më sot procesohen vetëm të parat. Vëllimi i operacioneve në AECH është rritur shumë ndërmjet viteve 2009 dhe 2011, ndërsa që nga ky vit është rritur vetëm me 5% në vit. Edhe programi i AECH-së u përditësua në vitin 2013, në përputhje me standardet e SEPA-s.

33. Sipas nenit 16 të Rregullores së AECH-së, pjesëmarrësit në sistem kategorizohen në pjesëmarrës të drejtpërdrejtë dhe në pjesëmarrës të tërthortë. Pjesëmarrës të drejtpërdrejtë aktualisht janë bankat tregtare dhe BSH-ja. Nga ana tjetër, pjesëmarrësit e tërthortë mund të dërgojnë dhe të marrin *file* pagesash në emër të tyre, por në sistemin AIPS shlyejnë nëpërmjet llogarisë së një agjenti shlyerjeje.

I vetmi pjesëmarrës i tërthortë, për momentin, është Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Për t’u bërë pjesëmarrës i tërthortë në AECH, një kandidat duhet të marrë miratimin e Këshillit Mbikëqyrës të BSH-së. Rregullorja e AECH-së nuk i specifikon kriteret që duhet të ndjekë Këshilli Mbikëqyrës në këtë rast.

34. Ndërsa në Shqipëri nuk ka një shërbim “*instant payment*”, në sistemin AECH zhvillohen tre seanca ditore kleringu dhe rregulloret për funksionimin e tij përcaktojnë

që një bankë përfituese duhet të kreditojë llogarinë e klientit përfitues brenda të njëjtës datëvalutë. Kështu, individët që kanë llogari bankare në Shqipëri mund të kryejnë transferta me vlerë të vogël, person me person dhe person me biznes me të njëjtën datëvalutë (për aq kohë sa pagesa të jetë iniciuar jo më vonë se ora 14:30).¹⁶ Megjithatë, pjesëmarrësit e tregut dhe BSH-ja po e konsiderojnë realisht mundësinë për të implementuar “*instant payments*” në tregun e pagesave me vlerë të vogël, me një disponueshmëri të shërbimit 24/7.

35. AECH kleron vetëm urdhërpagesat në monedhën vendase (Lek). Gjithashtu në Shqipëri kryhen edhe pagesa në euro, veçanërisht në sektorin e korporatave. Ka pasur diskutime lidhur me nevojën për të krijuar një shtëpi klerimi për këto lloj pagesash, për të ulur kostot dhe kohën që lidhet me përdorimin e bankave korresponduese jashtë vendit.
36. Ndërsa AECH-ja, në përgjithësi, përmban praktikat më të mira në rregulloren e saj, pozicionet neto debitore nuk kolateralizohen *ex ante* (paraprakisht) dhe as nuk ka kufizime për masën e pozicioneve debitore. Një pjesëmarrës që nuk ka fonde të mjaftueshme në llogarinë AIPS për shlyerjen e pozicionit të tij neto debitor në AECH mund të përfitojë nga lehtësia e likuiditetit brenda ditës të sistemit AIPS. Kredia brenda ditës nga BSH-ja duhet të kolateralizohet me tituj të qeverisë.

Përpunimi dhe switch-i i kartave

37. Aktualisht nuk ka një strukturë kombëtare në Shqipëri për shkëmbimin e transaksioneve të pagesave me kartë të zotëruesve të një karte bankare me një terminal POS të një tregtari nga një bankë tjetër, ATM ose pajisje të tjera pranuese kartash për autentifikimin dhe autorizimin e transaksionit. Gjithsesi, në pjesën më të madhe të rasteve është e mundur të tërheqësh para/të paguash me karta Visa ose Master, të lëshuara nga një bankë vendase në terminalin ATM/POS të një banke tjetër, pasi pjesa më e madhe e pajisjeve të pranimit të këtyre kartave janë “të ndërlidhura”, nëpërmjet rrjeteve përpunuese globale të Visa dhe Mastercard.
38. **Pay Link** është një operator i skemës së pagesave me kartë dhe prodhues i kartave të pagesave, i licencuar si operator i sistemit të pagesave nga BSH-ja. Tashmë ai ka një

¹⁶ Megjithatë, të gjitha urdhërpagesat me vlerë mbi 1.5 milion lekë duhet të kanalizohen nëpërmjet sistemit AIPS.

zgjidhje *switch* të pagesave me kartë, e cila është e gatshme për t'u zbatuar, me certifikime si përpunues palë e tretë nga Visa dhe Mastercard. Megjithatë, banka të tjera ende nuk kanë shprehur interes që të bëhen përdoruese të kësaj zgjidhjeje *switch*. Një arsye duket të jetë se *Pay Link* zotërohet nga një bankë, e cila është gjithashtu emetuese kartash, si rrjedhojë një konkurrence e drejtpërdrejtë.

Infrastruktura e ID dhe TIK në Shqipëri

Sistemi ID i identifikimit të qytetarit

39. Duke filluar nga viti 2009, Shqipëria ka emetuar karta ID *biometrike* për qytetarët shqiptarë që jetojnë në Shqipëri dhe jashtë saj, të cilët kanë mbushur 16 vjeç. Karta ID biometrike kërkohet për shërbime të ndryshme të rëndësishme, të cilat ofrohen si nga sektori publik ashtu edhe nga ai privat (për shembull, hapja e një llogarie bankare). Për rrjedhojë, që prej vitit 2015, çdo qytetar shqiptar është i pajisur me kartë ID biometrike.
40. Subjektet qeveritare dhe të biznesit mund të verifikojnë identitetin e një individi *online* nëpërmjet shërbimit në faqen e internetit të ofruar nga Aleat (shërbimi aktual njihet si “*e-service Aleat Identity Services*”). Për shembull, në momentin e aplikimit për një llogari, aplikuesi duhet të paraqesë kartën ID biometrike të tij/të saj. Bankat që përdorin e-Aleat kanë lexues të kartave ID biometrike në të cilat mbajtësi i kartës ID fut PIN-in e tij ose gjurmën e gishtave për certifikim. Ky shërbim është ende në zhvillim e sipër. Në fillim të vitit 2017, vetëm pesë banka dhe vetëm një OSHP jobankë kishte regjistruar shërbimet në e-Aleat.

Infrastruktura TIK

41. Sipas të dhënave të Bankës Botërore, në vitin 2012, 100% e popullsisë rezidente në Shqipëri, përfshirë atë urbane dhe rurale, kishin energji elektrike.
42. Numri i regjistrimeve të telefonave celularë kishte arritur rreth 3.4 milionë në fund të vitit 2016, sipas Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit, dhe me një normë depërtimi prej 105%. Në të njëjtin vit, për çdo 100 banorë ishin rreth 41 abonime *broand band* (brezgjerë) aktive (teknologji 3G dhe 4G të telefonisë celulare) krahasuar

me 33 për Bosnjën, 44 për Maqedoninë dhe 71 për Serbinë. Në të kundërt, abonimet në rrjete fikse të *broad band* (brezgjerë) kishin një normë depërtimi prej 7.6%.

43. **Shqipëria ka miratuar Planin Kombëtar për Zhvillimin e Broadband-it, 2013-2020, me vizion zhvillimin e infrastrukturës dhe shërbimeve Broadband në të gjithë vendin, me qëllim që të fitojë akses në shërbimet elektronike në fusha të ndryshme, të tilla si: shëndetësia, arsimi, tregtia, shërbimet qeveritare etj.** Sipas BNT, në fund të vitit 2016, 63% e individëve shqiptarë përdorin internetin, në mënyrë të ngjashme me vende si Bosnja (65%), Mali i Zi (65%) dhe Serbia (64%). Nga ana tjetër, me 35% të individëve që kanë akses (fikse ose të kombinuar) në internet, Shqipëria renditet pas vendeve të ngjashme me të.

Instrumentet e pagesave me vlerë të vogël të përdorura në Shqipëri

44. Instrumentet e pagesave me vlerë të vogël përcaktohen si instrumente që lehtësojnë transferimin e fondeve. Instrumentet e pagesave me vlerë të vogël përfshijnë parandë fizike, çeqet, kartat e kreditit dhe të debitit, transfertat e kreditit dhe debitimet direkte, si dhe instrumentet novatore të pagesave, të tilla si paraja elektronike. Pagesat me vlerë të vogël mund të iniciohen nga vetë personi ose në distancë. Përdoruesit e instrumenteve të pagesave mund të kategorizohen në konsumatorë, biznese dhe agjenci qeveritare. Të gjithë kanë një rol të dyfishtë, duke qenë pagues për disa transaksione dhe marrës për disa të tjera. Në varësi të kombinimit pagues - përfitues i pagesës, pagesat me vlerë të vogël mund të kategorizohen në lloje të ndryshme. Tabela 2 më poshtë tregon kombinimet e mundshme.

Tabelë 2. Lloje të ndryshme të pagesave me vlerë të vogël, në bazë të kombinimit pagues - marrës i pagesës

Marrës i pagesës / Pagues	Konsumator	Biznes	Subjekt qeveritar
Konsumator	P2P	P2B	P2Q
Biznes	B2P	B2B	B2Q
Subjekt qeveritar	Q2P	Q2B	Q2Q

P=Person, B=Biznes, Q=Qeveri

Burimi: World Bank (2015), “A Practical Guide for Measuring the Costs of Retail Payments”.

Paraja fizike

45. Paraja fizike (*cash*), deri më sot, është mjeti mbizotërues i pagesave në Shqipëri, veçanërisht për pagesat me vlerë të vogël. Një studim mbi koston e pagesave me vlerë të vogël në Shqipëri tregon se 96% e pagesave të iniciuara nga konsumatorët kryhen në para fizike. Pas ushqimeve dhe mallrave të nevojshme, konsumatorët shqiptarë kryejnë pjesën më të madhe të pagesave për fatura dhe shërbime periodike, nga të cilat 90% kryhen me para fizike. Transfertat e brendshme person-me-person (P2P) kryhen rëndom me para fizike (95%). Dërgesat ndërkombëtare të emigrantëve pothuajse në mënyrë ekskluzive disbursohen me para fizike. Në mënyrë të ngjashme, bizneset kryejnë pjesën më të madhe (60%) të pagesave të tyre me para fizike, duke qenë mikro-biznese më të varura nga paraja fizike (93% të të gjitha transaksioneve të iniciuara) në raport me ato të mëdha. Qeveria ka bërë progres të moderuar për të reduktuar përdorimin e parasë fizike në pagesat e pagave (Q2P), dhe veçanërisht për pagesat për furnitorët, shitësit dhe kontraktorët (Q2B). Nga ana tjetër, pensionet e pleqërisë kanalizohen kryesisht nëpërmjet kanaleve fizike të shërbimit dhe paguhen me para fizike.¹⁷

Instrumentet e pagesave që nuk kryhen me para fizike

46. Përdorimi i instrumenteve të pagesave jo me para fizike (jo *cash*) në Shqipëri, për transaksione të ndryshme nga tërheqja e parave fizike, ka pasur një rritje të qëndrueshme që nga viti 2011. Numri total i transaksioneve të pagesave që nuk kryhen me para fizike për banor në Shqipëri ishte 4.3 në vitin 2016, ende larg nga vendet me të ardhura mbi mesataren dhe nga vendet e tjera të zhvilluara. Për shembull, në vitin 2015, Mali i Zi dhe Serbia raportonin përkatësisht 26 dhe 62 transaksione jo me para fizike për banor. Vendet me të ardhura të larta raportojnë më shumë se 200 transaksione jo me para fizike për banor në baza vjetore.

47. Transfertat e kreditit janë instrumente të pagesave që nuk kryhen me para në dorë të përdorura rëndom, ndjekur nga pagesat me kartë në pikat e shitjeve, të cilat u rritën pothuajse 200% gjatë periudhës 2012-2016. Tabela 3 tregon të dhëna për përdorimin e instrumenteve të ndryshme të pagesave të vlefshme në Shqipëri. Kartat e pagesave

¹⁷ Burimi: Studim i BSH dhe Bankës Botërore për Kostot e Pagesave me Vlerë të Vogël në Shqipëri (në vazhdim). (Eng. BoA-World Bank Study on the Costs of Retail Payments in Albania (ongoing). Të dhëna nga ana e kërkesës janë të vitit 2014.

kanë ende mjaft hapësirë për rritje të mëtejshme, duke marrë parasysh faktin se vetëm 22-24% e të rriturve në Shqipëri kanë kartë debiti (krahasuar me rreth 70% për vendet e EAQ-së dhe vendet me të ardhura mbi mesataren, si një e tërë) dhe se ato ende përdoren më shumë për tërheqje të parasë fizike në ATM.

48. Përdorimi i çeqeve dhe transfertat e kreditit në formë letër në Shqipëri nuk po rriten më ose po ulen. Përveç kartave të pagesave, kanalet elektronike të inicimit po rriten për kryerjen e transfertave të kreditit dhe debitime direkte, duke i kthyer ato në pagesa plotësisht elektronike.¹⁸ Në vitin 2016, transfertat elektronike të kreditit u rritën me 28%. Shërbimet bankare *online* ofrohen nga pjesa më e madhe e bankave. Megjithatë, depërtimi i këtij shërbimi është ende i ulët. Në fund të vitit 2015, vetëm rreth 130,000 e të gjitha llogarive të mbajtura nga individë mund të përdreshin nëpërmjet bankingut *online*.
49. Pagesat përmes parasë elektronike filluan vetëm në vitin 2015. Pas dy vitesh, këto lloje pagesash nga institucione jobanka po tregojnë një tendencë në rritje, duke përbërë tashmë rreth 2% të totalit të pagesave që nuk kryhen me para fizike.

Tabelë 3. Të dhëna bazë mbi përdorimin e instrumenteve të pagesave që nuk kryhen me para fizike në Shqipëri

(Transaksione të iniciuara nga klientë, përfshirë individë dhe biznese)

	2012	2013	2014	2015	2016
1. Transferta krediti	6.376.269	6.086.231	6.265.984	6.241.373	5.980.144
2. Transferta elektronike të kreditit	236.215	322,672	1,249,294	1.404.052	1.791.989
3. Pagesa me kartë	1.107.425	1,496,640	2,124,304	2,481,524	3,200,215
4. Debitime direkte (brenda bankës)	975.786	720,350	433,778	457,604	732,210
5. Pagesa me para elektronike	-	-	-	156.283	205.200
6. Çeqe	63.096	49.205	44.372	47.145	32.576
Totali i pagesa që nuk kryhen me para fizike,	8.758.791	8.675.098	10.254.805	11.003.087	11.942.334
Pagesa që nuk kryhen me para fizike për frymë	3,13	3,10	3,67	3,93	4,26

Burimi: Banka e Shqipërisë.

50. Arsyet për përdorimin ende të ulët të instrumenteve të pagesave jo me para fizike në Shqipëri variojnë që nga pesha e ulët e personave madhorë që kanë një llogari, deri tek konceptimi i produkteve të ndryshme të pagesave të disponueshme në vend dhe

¹⁸ Instrumentet e pagesave elektronike përdorin mjete elektronike për inicimin, autorizimin dhe certifikimin e një transaksioni pagese. Megjithatë, ndonëse një transaksion mund të iniciohet në mënyrë elektronike, në disa raste, procesimi i mëpasshëm i kreditimit dhe shlyerjes mund të përfshijë disa procedura manuale.

informaliteti i lartë në ekonomi dhe në tregun e punës. Një numër i konsiderueshëm i personave në moshë madhore që kanë një llogari transaksionesh, ka shumë të ngjarë të çojë në përdorim më të lartë të instrumenteve të pagesave jo me para fizike, ndonëse jo domosdoshmërisht. Mbajtësit e një llogarie mund të vendosin të mos përdorin opsionet e pagesave jo me para fizike nga llogaritë e tyre, thjesht për arsyen se ato nuk i përmbushin nevojat e tyre. Hapësira informuese 1 ofron një përmbledhje të faktorëve “të propozuar” që influencojnë zotërimin e instrumenteve të ndryshme të pagesave nga përdoruesit (përfshirë paranë fizike), në bazë të përvojës së Bankës Botërore. Këta faktorë lidhen si me konceptimin thelbësor të instrumenteve të pagesave ashtu dhe me elementet apo veçoritë që ofruesi i shërbimit vendos t’i përfshijë në produktin e pagesave, nëpërmjet të cilit ai instrument përdoret. Nga ana tjetër, nivelet e larta të informalitetit në ekonomi dhe në tregun e punës do të përpiqen të ruajnë një nivel të ulët të personave madhorë që kanë dhe që përdorin rregullisht një llogari, dhe kanë një parapëlqim të fortë për paranë fizike.

Hapësirë informative 1: Faktorët që ndikojnë në Përvetësimin e Instrumenteve Specifike të Pagesave me Vlerë të Vogël

Përdorimi i çdo instrumenti të caktuar pagesash me vlerë të vogël nga konsumatorët, bizneset dhe qeveria, ndikohet nga fakti se sa përshtatet ky instrument me nevojat specifike të paguesit dhe të përfituesit të pagesës, si dhe me faktin se si secili prej tyre percepton instrumentin lidhur me rrezikun, likuiditetin, koston, pranimin dhe lehtësinë. Për një pagues, zgjedhja e instrumenteve të pagesave ndikohet në mënyrë thelbësore nga faktorët e mëposhtëm.

Kostoja: Përdorimi i instrumenteve të pagesave përfshin si kostot *eksplicite* dhe ato *implicite*. Kostot eksplicite përfshijnë tarifa të drejtpërdrejta të paguara nga paguesi për përdorimin e instrumentit, të tilla si komisione për transaksion. Kostot implicite, përfshijnë, për shembull, kohën në pritje për përpunimin e një kërkesë pagese ose koston e kohës së shpenzuar duke pritur për të marrë para fizike për të kryer pagesa, ose për të përdorur instrumentet e pagesave që nuk kryhen me para fizike.

Siguria dhe besueshmëria: Paguesi ka nevojë të ketë një nivel të lartë besimi se instrumenti i pagesës do të funksionojë sikurse pritët dhe do të shlyejë detyrimin e pagesës, ashtu siç është kërkuar. Kjo përfshin, ndër të tjera, aspekte që lidhen me kohën gjatë së cilës sistemi është i disponueshëm, keqpërdorim me për qëllime mashtrimi, dhe korrigjimin e gabimeve në përpunimin e kërkesës.

Volitshmëria: Instrumenti i pagesave duhet të jetë komod për t'u përdorur. Kjo përfshin aspekte të tilla si: çfarë duhet të memorizojë paguesi; ose se çfarë duhet të mbajë fizikisht për të kryer një pagesë; sa kohë duhet që të kryhet transaksioni kur përdoret instrumenti në fjalë; dhe aspekte të tjera të lidhura me të.

Pranimi: Një pagues mund të dëshirojë që instrumenti i pagesës të pranohet gjerësisht. Për shembull, një zotërues karte pagesash mund të mos e shohë dobinë e kartës nëse ajo nuk pranohet në vende si dyqanet ushqimore dhe restorantet, apo nuk mund të përdoret për pagesa utilitare dhe të shlyer detyrime të tjera, me peshë të rëndësishme në pagesat rutinë.

Konfirmimi dhe rakordimi i pagesës: Një pagues mund të dëshirojë një konfirmim për inicimin dhe përpunimin e pagesës. Kjo do të shërbejë si regjistrim rakordimi edhe si provë që pagesa është kryer, dhe do ta ndihmojë paguesin të administrojë dhe të monitorojë llogarinë e tij të pagesave.

Për një përfitues pagese, faktorët që ndikojnë zgjedhjen e instrumenteve të pagesave janë të ngjashme me ato të përmendura më lart, por kanë disa dallime të rëndësishme.

Kostoja: Përfituesi i pagesës has në kosto implicite dhe eksplicite të ndryshme kur pranon një instrument pagese. Paraja fizike, për shembull, ka kosto mbajtjeje dhe ruajtjeje. Një kosto implicite e rëndësishme është koha që shpenzohet për kalimin e fondeve në llogarinë e marrësit. Sa më e gjatë vonesa, aq më e lartë është, ndër të tjera, kostoja e interesit të munguar dhe/ose kostoja për administrimin e likuiditetit.

Pranimi: Në përgjithësi, përfituesi i pagesës, pranon ato instrumente pagesash që preferohen nga një pjesë sa më e madhe paguesish. Disa instrumente pagesash kërkojnë nga përfituesi të ketë një llogari depozitë në një bankë apo ofrues shërbimi të pagesash. Përveç kësaj, për disa instrumente, marrësi i pagesës do të duhet të përdorë infrastrukturë të caktuar, si terminale POS dhe mjete të tjera të telekomunikimit.

Siguria dhe besueshmëria: Paguesi duhet të ketë besim se instrumenti i pagesës që ai ka pranuar do të përpunohet ashtu si pritët dhe pagesa do të kryhet. Kjo përfshin aspekte të tilla si koha e sigurt e përpunimit, koha e funksionimit të sistemit, mosrefuzim i pagesës dhe përfundimi i shlyerjes.

Rakordimi i pagesës dhe gjurmët e kontrollit: Një përfitues pagese ka nevojë për informacion për rakordimin e pagesës për të mundësuar regjistrimin. Gjurmët e kontrollit të pagesës janë gjithashtu të rëndësishme, edhe kur, për shembull duhet të mbrohen pretendime që lidhen me kërkesën për refuzimin e pagesës.

Burimi: Banka Botërore (2012), "Zhvillimi i një strategjie gjithëpërfshirëse kombëtare të pagesave me vlerë të vogël". (Eng.: World Bank, 2012, "Developing a comprehensive national retail payments strategy").

Qeveria si përdoruese e shërbimeve të pagesave

51. Disbursimet në masë të sektorit publik, në mënyrë thelbësore, përfshijnë pagesa të rregullta të përfitimeve sociale ose grante, paga, pensione dhe pagesa e kontribute të tjera të sigurimeve shoqërore. Sektori publik në Shqipëri ka të punësuar 164,120 individë.¹⁹ Në nivel qeverie qendrore, pagat dhe kompensimet e tjera, në përgjithësi, paguhen nëpërmjet një llogarie bankare. E njëjta praktikë ndiqet dhe në nivel lokal.
52. Instituti i Sigurimeve Shoqërore është një nga pagesit më të mëdhenj në vend sipas vëllimit. Nga të gjitha pagesat e ISSH-së, pensionet e pleqërisë kanë vëllimin më të madh, dhe disbursohen thuajse tërësisht në para fizike në sportelet e Postës Shqiptare. Vitet e fundit, megjithëse me pak sukses, janë bërë përpjekje për të kanalizuar pensionet nëpërmjet mjeteve elektronike në sistemin bankar. ISSH-ja gjithashtu administron disa programe të asistencës sociale p.sh., ndihma ekonomike, ku përfshihen transferta të parasë fizike për individët me të ardhura të ulëta. Këto pagesa dërgohen nëpërmjet llogarive ose me para fizike tek arkëtari i bankës.
53. Pagesat ndaj Qeverisë Qendrore, detyrimeve doganore dhe kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore mblidhen nëpërmjet kanaleve bankare. Duke iu referuar të dhënave nga kahu i kërkesës për përdorimin e instrumenteve të pagesave për arkëtimet e qeverisë rezulton se vëllimin vjetor i pagesave është rreth 1.3 milion në vit. Nga këto, 80% paguhen me para fizike.
54. Portali e-Albania përfaqëson një përpjekje të qeverisë qendrore për të digjitalizuar ofrimin e shërbimeve publike. Ky portal ofron 470 shërbime të ndryshme publike, megjithëse aktualisht më pak se dymbëdhjetë mund të paguhen *online*. Shërbimet e pagesave që varen nga bashkitë nuk janë të integruara në e-Albania. Pagesat për shërbime të ofruara në bashki pothuajse gjithmonë mblidhen në para fizike në vend.

Pikat dhe kanalet përkatëse të aksesit në Shqipëri

Degët dhe agjentët e bankës

55. Në përgjithësi, infrastruktura bankare është e përqendruar në qytetet e mëdha. Në vitin 2015, numri i degëve të bankave për 100,000 persona në moshë madhore ishte 21.9.

¹⁹ Pagesa e pagave - përfshirë sektorin publik dhe atë privat - përbejnë 23% (sipas volumit) të pagesave totale vjetore të marra nga persona me moshë madhore në Shqipëri.

Kjo shifër është e ngjashme me atë në vendet fqinje: vendet në zhvillim në rajonin e EAQ-së kanë një mesatare 22.1, ndërsa vendet me të ardhura mbi mesataren në përgjithësi kanë një mesatare 15.9.

56. Modeli i agjentit bankar ose korrespondentit bankar nuk ka qenë i zhvilluar në Shqipëri. Kështu që, megjithëse numri i degëve të bankave për 100,000 persona në moshë madhore duket të jetë relativisht i lartë, bankat në shumë vende me të ardhura mesatare gjithashtu ofrojnë shërbime “*in person*”, nëpërmjet pikave fizike të aksesit të zotëruara nga palë të treta (domethënë agjentëve), të cilët u lejojnë të kenë një akses shumë më të gjerë se sa po të marrim parasysh vetëm rrjetin e degëve të tyre. Për më shumë, pjesa më e madhe e bankave në Shqipëri i kanë mbyllur disa degë vitet e fundit.

ATM dhe terminale POS

57. Në përgjithësi, infrastruktura bankare dhe e pagesave me vlerë të vogël në Shqipëri është më pak e zhvilluar se sa në vendet fqinje apo vende të ngjashme me nivelin e zhvillimit ekonomik të saj. Në vitin 2016, në Shqipëri kishte 34 ATM për 100,000 persona në moshë madhore, krahasuar me 56.4 për vendet në zhvillim në rajonin e EAQ (2015). Mesatarja e vendeve me të ardhura mbi mesataren është 51.1 ATM për 100,000 persona në moshë madhore. Terminalet POS u rritën në 302 për 100,000 persona në moshë madhore në vitin 2015, krahasuar me 726 në Kosovë, 1,102 në Serbi dhe më shumë se 2,000 në Mal të Zi.
58. Gjatë periudhës 2010-2016, numri i ATM-ve u zgjerua në më pak se 1% mesatarisht në vit.²⁰ Zgjerimi i numrit të terminaleve POS arriti një mesatare prej më shumë se 70% në vit. ATM-të përdoren pothuajse vetëm për tërheqje parash, pasi vetëm 15% e numrit total të ATM-ve ofrojnë funksione të transferimit të fondeve. Terminalet POS përdoren pothuajse vetëm për pagesa me kartë tek tregtarët, ndonëse disa banka kanë futur shërbimet e rimbursimit për përdorimin e kartës me *cashback*²¹. Tabela 4 tregon disa të dhëna bazë për ATM-të dhe terminalet POS në Shqipëri.

Tabelë 4. ATM dhe Terminale POS në Shqipëri, në vitin 2016

²⁰ Është e vlefshme të vihet në dukje se ngadalësimi në zgjerimin e pikave të aksesit në Shqipëri përkon me efektet e raundit të dytë të krizës financiare ndërkombëtare në ekonominë shqiptare dhe në sistemin bankar.

²¹ *Cash back* – përfitime të ndryshme që përfton mbajtësi i kartës nga kompania e kartave për përdorimin e kartës në blerje.

ATM , prej të cilave	800
ATM me funksion tërheqje parash	776
ATM me funksion transferte krediti	120
ATM me funksion depozite	94
Terminale POS prej të cilave	7.111
Terminale POS me funksion tërheqje parash	97
Terminale EFTPOS	7.014
Terminale virtuale POS	28
Terminale të parasë elektronike	680

Burimi: Banka e Shqipërisë.

59. Mbulimi gjeografik i ATM-ve dhe terminaleve POS mbetet ende i kufizuar. Në vitin 2015, rreth 57% e ATM-ve dhe 80% e POS-eve ishin përqendruar në rajonin e Tiranës. Mbulimi është i kufizuar edhe për shkak se ka ndërveprim të kufizuar midis këtyre kanaleve të aksesit.

Kanale të tjera të ofrimit të shërbimit të pagesave

60. **Posta Shqiptare sh.a. është e licencuar nga BSH-ja si IFJB për ofrimin e shërbimit të pagesave.** Ajo ka 537 degë, nëpërmjet të cilave, përveç shërbimeve postare, shlyhen me para fizike pagesat për qeverinë dhe shpërndahen pensionet. Në fakt, pagesa e pensioneve përbën gati 75% të vëllimit total të pagesave që administrohen nga Posta Shqiptare. Nga ana e arkëtimit, taksat dhe disa shërbime të tjera utilitare mund të paguhet në degët e këtij subjekti. Ndërkohë, janë duke u zhvilluar edhe plane midis një prej bankave që operon në Shqipëri dhe Postës Shqiptare për ta pajisur këtë të fundit me terminale POS që mundësojnë *cashback*/tërheqjen e parave për klientët që kanë llogari pranë kësaj banke.
61. **Ndryshe nga bankat, emetuesit e parasë elektronike në Shqipëri kanë zhvilluar rrjete të agjentëve përveç degëve/vendndodhjeve të tyre.** Secili prej dy emetuesve të parasë elektronike ka një rrjet me afërsisht 300 pika aksesit. Një nga këta emetues të parasë elektronike ka ekskluzivitet në pothuajse gjysmën e pikave të tij të aksesit (këto pika ofrojnë shërbime pagesash vetëm në lidhje me atë emetues të parasë elektronike), ndërsa emetuesi tjetër i parasë elektronike ka ekskluzivitet në të gjithë pikat e tij të aksesit.
62. **Rrjete të tjera janë ato të dy IFJB-ve që janë ofruesit më të mëdhenj të shërbimit të remitancave në Shqipëri.** Të dy këta ofrues, kanë zhvilluar një rrjet prej rreth 600

pikash shërbimi (pasi janë zbritur ato pika që aktualisht janë degë të Postës Shqiptare). Një nga këta ofrues të shërbimit të dërgesave të emigrantëve kërkon ekskluzivitet tek të gjithë agjentët e tij, përveç Postës Shqiptare.

63. Shoqëritë e Kursim-Kreditit (SHKK) kanë një rrjet domethënës degësh. Më e madhja e tyre ka 82 degë, shumë prej tyre në zona rurale në jug dhe në qendër të vendit.

IV. VIZIONI DHE STRATEGJIA PËR ZHVILLIMIN E NJË SISTEMI PAGESASH ME VLERË TË VOGËL NË SHQIPËRI

Vizioni ynë

Të krijojmë një treg modern dhe gjithëpërfshirës të pagesave me vlerë të vogël në Shqipëri, mbështetur nga infrastruktura të sigurta dhe eficiente pagesash, si dhe nga një gamë e gjerë instrumentesh dhe shërbimesh pagesash që plotësojnë nevojat e përdoruesve financiarisht të aftë të shërbimit të pagesave në të gjithë vendin.

Qëllimi ynë është që përmirësimet në tregun e pagesave me vlerë të vogël t'u japin qytetarëve më shumë zgjedhje, në sa më shumë vende, për kryerjen e transaksioneve të tyre të përditshme, në një mënyrë të përshtatshme dhe me kosto efektive, në mbështetje edhe të objektivit të përfshirjes më të gjerë financiare.

1. **Objektivi kryesor i SKPVV-së do të jetë nxitja e përdorimit intensiv të instrumenteve moderne të pagesave (plotësisht elektronike) me vlerë të vogël në të gjithë vendin, me qëllim arritjen e 10 pagesave jo me para fizike për frymë, deri në fund të vitit 2022.**²² Ky objektivi do të çonte në dyfishimin e rritjes së përdorimit të pagesave të kryera jo me para fizike në periudhën 2012-2016, në pesë vitet e ardhshme. Sidoqoftë, ky nivel i ri është ende shumë më poshtë se shifra përkuese ekzistuese për vendet me të ardhura mesatare, në Ballkanin Perëndimor dhe rajone të tjera. Prandaj, objektivi i kryerjes së 10 pagesave jo me para fizike për frymë, deri në fund të vitit 2022, konsiderohet ambicioz, por gjithsesi i arsyeshëm.

2. **Zgjerimi i mundësisë për aksesin në llogaritë e transaksioneve është një kusht i domosdoshëm për të arritur objektivin kryesor. Në lidhje me këtë, Shqipëria synon të**

²² Nga një tregues bazë prej 4.3 pagesash pa para fizike për frymë në fund të vitit 2016.

arrijë një raport të zotërimit të llogarisë në nivelin 70% deri në vitin 2020, vlerë e njëjtë me nivelin e arritur aktualisht nga vendet me të ardhura mesatare. Në këtë drejtim, BSH-ja dhe aktorët përkatës do të përpiqen të zbatojnë rekomandimet lidhur me rritjen e zotërimit të llogarive të përfshira në raportin "Arritja e Përfshirjes efektive Financiare në Shqipëri - Perspektiva e Pagesave", përgatitur nga Grupi i Bankës Botërore.²³

3. Zbatimi i SKPVV-së ka për qëllim jo vetëm rritjen e niveleve të zotërimit dhe përdorimit të llogarive, por edhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të pagesave për klientët. Zbatimi i suksesshëm i SKPVV-së do t'u sjellë përfitime klientëve ekzistues dhe të rinj nëpërmjet:

- (i) Rritjes së shpejtësisë me të cilën nisen, klerohen dhe shlyhen pagesat;
- (ii) Rritjes së besueshmërisë së pagesave të bëra përmes infrastrukturës vendase dhe shpërndarjes së kanaleve të pranimit të pagesave që mbështesin pagesat me vlerë të vogël;
- (iii) Rritjes së volitshmërisë për përdoruesit, duke rritur mundësinë për të paguar në mënyrë elektronike në distancë ose në sportel;
- (iv) Ofrimit të shërbimeve të pagesave gjithnjë e më të përballueshme për individët, bizneset dhe qeverinë, duke promovuar përmirësime në infrastrukturë (financiare dhe të tjera) dhe duke nxitur rritjen e konkurrencës dhe inovacionit në ofrimin e shërbimeve të pagesave.

IV.1 Parimet udhëzuese

4. SKPVV-ja duhet të zbatohet me rigorozitet. Sapo të miratohet, SKPVV-ja do të zbatohet sipas një afati kohor rigoroz. Në varësi të ecurisë së zbatimit, besueshmëria e të gjitha institucioneve të përfshira në strategji do të vendoset përballë publikut shqiptar. Ecuria do të monitorohet në bazë të një numri treguesish, të cilët diskutohen në seksionin 5 të kësaj SKPVV-je. Mekanizmat e llogaridhënies transparente do të sigurojnë që secili lojtar të përgjigjet për performancën e tij në përparimin e zbatimit.

5. Zbatimi i SKPVV-së do të bazohet në gjashtë parime udhëzuese. Këto parime do të mbështesin aktivitetin e BSH-së, agjencive qeveritare, ofruesve të shërbimeve të pagesave

²³ Ky raport bazohet në raportin "Aspektet e pagesës për përfshirjen financiare" të publikuar nga Komiteti mbi Pagesat dhe Infrastrukturën e Tregut dhe Grupi i Bankës Botërore, në prill 2016.

banka dhe jobanka, dhe të gjithë aktorëve të tjerë në përmbushjen e përgjegjësive të tyre ndaj SPKVV-së. Parimet udhëzuese në thelb ndjekin Udhëzimet e Grupit të Bankës Botërore për zhvillimin e një Strategjie Kombëtare Gjithëpërfshirëse të Pagesave me Vlerë të Vogël dhe janë listuar më poshtë.

Parimi udhëzues 1: Transparenca, paanshmëria dhe mbrojtja e përdoruesve

6. Transparenca është tejet e rëndësishme për rritjen e konkurrencës dhe forcimin e mbrojtjes së përdoruesve të pagesave me vlerë të vogël. Kryerja e veprimeve në tregun e pagesave me vlerë të vogël, në mënyrë sa më transparente, do të zvogëlonte stimujt e sjelljeve abuzive nga ofruesit e shërbimeve të pagesave individuale dhe operatorët. Një aspekt kyç i transparencës lidhet me njoftimin e çmimeve për shërbimet/produktet e ndryshme të pagesave të ofruara sipas një metodologjie që lejon krahasime efektive, së bashku me kushtet e tjera përkatëse.

7. Paanshmëria në tregun e brendshëm të pagesave me vlerë të vogël do të promovohet për të siguruar që aktorët të kenë perceptimin se interesat dhe nevojat e tyre individuale janë marrë në konsideratë dhe janë trajtuar sa dhe si duhet nga rregullatorët, mbikëqyrësit dhe operatorët e sistemeve të pagesave dhe të rrjeteve të pikave të aksesit. Paanshmëria ka të bëjë me trajtimin e barabartë të bankave dhe ofruesve të autorizuar të shërbimeve të pagesave jobanka, duke përfshirë zbatimin e kriterëve jodiskriminuesë të bazuara në rrezik për pjesëmarrje në sistemet e pagesave ndërbankare dhe rrjeteve të tjera të pagesave me vlerë të vogël. Gjithashtu, ajo i referohet përdorimit të sanksioneve efektive për penalizimin e sjelljeve abuzive të tregut. Për përforcimin e këtij perceptimi do të ndihmojnë bisedimet e vazhdueshme lidhur me politikat midis BSH-së dhe aktorëve të tregut e palë të tjera të interesuara, dhe kapaciteti që ka BSH-ja për të ushtruar autoritetin e saj me kompetencë, vazhdimësi dhe transparencë. Hapi i parë në këtë drejtim është kryer nëpërmjet përfshirjes së aktorëve të tregut në diskutimin dhe përpunimin e kësaj SKPVV-je.

8. Informacioni për qëllime edukimi do të fokusohet drejt përdoruesve të rinj potencialë, si dhe për rritjen e kulturës financiare të përdoruesve ekzistues, përfshirë përfituesit e dërgesave të emigrantëve. Përpjekjet për edukim dhe transparencë ndihmojnë në nxitjen e konkurrencës efektive dhe në përforcimin e disiplinës së tregut, duke bërë që informacioni përkatës të jetë lehtësisht i arritshëm për përdoruesit ekzistues dhe të rinj. Do të

rritet ndërgjegjësimi mbi veçoritë e instrumenteve moderne të pagesave dhe mënyra se si ato mund të ndihmojnë individët dhe bizneset të përmbushin nevojat e tyre lidhur me pagesat, i përdoruesve ekzistues dhe atyre të rinj, me fokusin tek këta të fundit, duke pasur parasysh ekspozimin e tyre të kufizuar ndaj shërbimeve moderne financiare.

9. Përpjekjet për mbrojtjen e konsumatorit do të zvogëlojnë pabarazitë e informacionit, të burimeve dhe fuqisë, që janë karakteristike për një marrëdhënie shërbimi midis individëve (ose bizneseve të vogla) dhe bankave ose ofruesve të shërbimeve të pagesave. Bashkë me sigurimin e informacionit për vendimmarrje më të mirë të përmendur më sipër, këto përpjekje do të përfshijnë edhe ndalimin e bankave dhe ofruesve të shërbimeve të pagesave për t'u angazhuar në praktika të padrejta ose të pasakta, duke u siguruar që të zbatohen mekanizmat të mjaftueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të konsumatorëve.

Parimi udhëzues 2: Infrastruktura e pagesave dhe rrjetet e pikave të aksesit moderne dhe ndërvepruese

10. Infrastruktura moderne e pagesave do të shërbejë për të mbështetur përpunimin e të gjitha instrumenteve përkatëse të pagesave. BSH-ja ka zbatuar dy nga infrastrukturat kryesore të pagesave që lejojnë klerimin e transfertave të kreditit me vlerë të vogël dhe shlyerjen e tyre përfundimtare në llogaritë e shlyerjes pranë bankës qendrore. Banka e Shqipërisë do të promovojë zbatimin e infrastrukturave të tjera të nevojshme (p.sh. për procesimin e transaksioneve të pagesave me kartë, si edhe për të mundësuar “*instant payments*” në fushën e pagesave me vlerë të vogël), edhe pse zbatimi i tyre aktual dhe funksionimi i tyre efektiv do të jenë përgjegjësi e sektorit privat.

11. Të gjitha infrastrukturat e pagesave që konsiderohen me rëndësi sistemike nga Banka e Shqipërisë do të zbatojnë "Parimet për infrastrukturën e tregut financiar" (PITF) të CPMI-IOSCO. Infrastrukturat e tjera të pagesave do të ndjekin praktikën më të mira ndërkombëtare dhe mund të kërkohet që të zbatojnë edhe një nënset të PITF-ve të CPMI-IOSCO. BSH-ja do të vlerësojë shkallën e rëndësisë sistemike të infrastrukturave, në vazhdimësi, dhe do të përcaktojë standardet ndërkombëtare/praktikat më të mira që duhet të respektohen (shih gjithashtu Parimin Udhëzues 6).

12. Infrastruktura e pagesave dhe rrjetet e pikave të aksesit do të jenë ndërvepruese. Kjo do të sigurojë akses të drejtë dhe të barabartë, si dhe do të mbështesë efikasitetin, duke

minimizuar kështu rreziqet financiare, operacionale dhe rreziqe të tjera. Rrjetet e pikave të aksesit ndërvepruese do të mundësojnë shfrytëzimin pa ndërprerje të produkteve të pagesave në vendndodhje të ndryshme në të gjithë vendin, me një kosto të arsyeshme.

Parimi udhëzues 3: Kuadri i përshtatshëm ligjor dhe rregullator

13. Rregullat jodiskriminuese të hyrjes dhe kushtet e pjesëmarrjes në treg për ofrimin e shërbimeve të pagesave me vlerë të vogël do të ruhen dhe rriten sipas nevojës.

Këto rregulla luajnë një rol kritik në sigurimin e kontestimit dhe lehtësimin e pjesëmarrjes së gjerë në tregun e pagesave me vlerë të vogël, në nxitjen e inovacionit dhe në përgjithësi në vendosjen dhe ruajtjen e barazisë midis ofruesve të shërbimeve të pagesave të autorizuara, pavarësisht nga natyra apo madhësia e tyre.

14. Rregullorja e pagesave do të përshtatet me zhvillimin e tregut dhe praktikën më të mirë ndërkombëtare. Në aspektin rregullator, aktiviteti i BSH-së do të synojë mirëfunksionimin e pagesave me vlerë të vogël dhe më gjerësisht të SKP-së, duke promovuar efikasitetin dhe përballueshmërinë e tyre, si edhe duke u siguruar që të zhvillohet me kalimin e kohës, në mënyrë që të përputhet me nevojat e pagesave të ekonomisë shqiptare në rritje.

Parimi udhëzues 4: Konkurrenca e fortë, e plotësuar nga bashkëpunimi

15. Tregu për ofrimin e shërbimeve të pagesave me vlerë të vogël do të mbrohet nga sjellja anti-konkurruese e ofruesve individualë të shërbimeve të pagesave apo e operatorëve të sistemeve të pagesave. Aktorët e tregut, duke qenë se janë në gjendje të arrijnë dhe të shfrytëzojnë pozicione monopoliste, mund të vënë në rrezik kapacitetin e inovacionit, cilësinë e shërbimeve dhe sigurimin e shërbimeve të pagesave për konsumatorët me çmime konkurruese. Si mbikëqyrës i SKP-së, BSH është në një pozitë të privilegjuar për të monitoruar zhvillimet e tregut dhe për të ndërhyrë ose për të bashkëpunuar me autoritetet kompetente, në rast se identifikohen praktikat monopoliste.

16. Mbrojtja ndaj sjelljes anti-konkurruese nuk do të përjashtojë mundësinë që subjekte individuale të bëhen ofrues kryesorë të shërbimeve kritike infrastrukturore, duke u transferuar kështu klientëve përfitimet e ekonomisë së shkallës dhe grupimit të burimeve për prodhimin e disa produkteve. Megjithatë, mbrojtja e konkurrencës së tregut, gara dhe zbatimi i rreptë i rregullave kundër praktikave abuzuese të tregut, do të bëjnë të

mundur që asnjë operator individual apo grup operatorësh të sistemit të pagesave të mund të keqpërdorin ofruesit e shërbimeve të pagesave ose të pengojë hyrjet e reja në treg (shih më poshtë).

17. Do të duhet të vendoset ekuilibër midis konkurrencës dhe bashkëpunimit brenda industrisë së pagesave me vlerë të vogël. Ndërsa konkurrenca mundëson ofrimin efektiv të shërbimeve të pagesave me vlerë të vogël, novatore dhe me kosto efektive, bashkëpunimi ndërmjet aktorëve të tregut, ndërmjet tyre dhe BSH-së, është i nevojshëm për ndërtimin e infrastrukturave të përbashkëta, për përcaktimin dhe miratimin e standardeve të përbashkëta për shërbimet dhe për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme kolektive. Prandaj, BSH-ja do të vazhdojë të nxisë nivelin e kërkuar të bashkëpunimit të industrisë përmes stimujve dhe rregullave të përshtatshme, dialogut dhe “moral suasion”. Për më tepër, BSH-ja do të marrë një rol udhëheqës në nxitjen e nismave të sektorit privat, sa herë që të jetë e nevojshme. Kjo do të ndihmojë sektorin privat që të bëhet një forcë vetëfunksionuese për zhvillimin e një SKPVV-je të sigurt dhe efikase.

Parimi udhëzues 5: Qeverisja dhe përgjegjësitë e rrezikut

18. Një kuadër i përshtatshëm i menaxhimit të rrezikut do të sigurojë identifikimin dhe administrimin e duhur të rreziqeve dhe kostove në tregun e pagesave me vlerë të vogël. Aktorët e tregut duhet të jenë mjaft të ndërgjegjshëm mbi rreziqet dhe kostot gjatë projektimit dhe operimit të sistemeve të tyre. Kërkohe ruajtja e një ekuilibri midis reduktimit të rrezikut dhe kostove shoqëruese, duke pasur parasysh se zhvillimet e reja të tregut mund të ndryshojnë herë pas here ekuilibrin aktual. Ndërsa BSH-ja vazhdon të mbikëqyrë SKP-në si një e tërë, si dhe të mbikëqyrë ofruesit e shërbimeve të pagesave/ operatorët e sistemit të pagesave, këta të fundit mbajnë përgjegjësinë kryesore për administrimin e rreziqeve që ata paraqesin në tregun e pagesave me vlerë të vogël dhe SKP-në më gjerë.

19. Do të ndiqet një qasje progresive, por e kujdesshme, në përgjigjen ndaj zhvillimeve të reja teknologjike. Është e domosdoshme që rreziqet e përfshira gjatë hapjes së SKP-së për aktorë të rinj dhe instrumente të reja të kuptohen dhe të vlerësohen plotësisht. Qasja e përgjithshme e BSH-së do të synojë pranimin dhe lehtësimin e inovacionit, duke u siguruar që rreziqet e identifikuar ose të mundshme të kuptohen, të vlerësohen dhe (në fund) të administrohen siç duhet, dhe që përgjegjësitë përkatëse të shpërndahen si duhet.

20. Marrëveshje të arsyeshme dhe efektive të qeverisjes do të mbështesin ofrimin dhe ndarjen e shërbimeve infrastrukturore nga subjektet e sektorit publik ose privat. Për të siguruar që shërbimet infrastrukturore të funksionojnë pa probleme dhe për të siguruar ndërveprimin, qeverisja e tyre do të duhet të pasqyrojë nevojat dhe interesat e të gjitha institucioneve pjesëmarrëse, të rregullatorëve dhe të ekonomisë në tërësi, duke ruajtur një ekuilibër ndërmjet interesave private dhe qëllimeve publike.

21. Operatorët e sistemeve të pagesave dhe ofruesit e shërbimeve të pagesave duhet që, në asnjë moment, të mos kryejnë veprime që mund të rrezikojë besimin e publikut në SKP ose më gjerë, në sistemin financiar. Besimi i publikut në sistemet e pagesave, veçanërisht në ato me vlerë të vogël, është shumë i rëndësishëm. Në këtë drejtim, BSH-ja do të bashkëpunojë me autoritetet përkatëse, sipas nevojës, për t'u mbrojtur nga të gjitha format penale të keqpërdorimit të sistemit të pagesave, si mashtrimi, shkelja e integritetit të të dhënave, pastrimi i parave ose financimi i aktiviteteve terroriste.

Parimi udhëzues 6: Mbikëqyrja efektive

22. Nëpërmjet mbikëqyrjes, BSH-ja do të synojë ruajtjen e sigurisë së tregut të pagesave me vlerë të vogël dhe të SKP-së më gjerësisht, sikundër dhe promovimin e efikasitetit, përballueshmërisë dhe përfshirjes. BSH-ja do të vazhdojë të përforcojë kapacitetin e saj të brendshëm të nevojshëm për të mbikëqyrur në mënyrë efektive një treg të pagesave me vlerë të vogël gjithnjë e më kompleks. BSH-ja do të zgjerojë kuadrin e saj të politikave të mbikëqyrjes për të mbuluar shërbimet e pagesave me vlerë të vogël dhe do ta zbatojë vazhdimisht këtë strukturë në gjithë tregun e pagesave me vlerë të vogël.

23. Gjatë implementimit të përgjegjësisë së saj mbikëqyrëse, BSH-ja do të vazhdojë të zbatojë praktikatat më të mira, në përputhje me parimet dhe standardet e zhvilluara nga komuniteti financiar ndërkombëtar. Për mbikëqyrjen e instrumenteve specifike të pagesave me vlerë të vogël, shërbimeve dhe skemave, BSH-ja do të adoptojë udhëzime ndërkombëtare²⁴ dhe do të shqyrtojë përvojat dhe praktikatat e zhvilluara nga bankat e tjera qendrore ku synohet zbutja e rreziqeve në lidhje me shërbimet dhe instrumentet e pagesave me vlerë të vogël.²⁵ Në masën që çdo sistem pagesash me vlerë të vogël është konceptuar me

²⁴Të tilla si KPIT-Grupi i Bankës Botërore "Parimet e përgjithshme për shërbimet ndërkombëtare të dërgesave të emigrantëve" (2007) dhe parimet udhëzuese në raportin "Aspektet e pagesës për përfshirjen financiare" (2016).

²⁵Për shembull, ka disa raporte nga Banka Qendrore Evropiane: Qasja e harmonizuar e mbikëqyrjes dhe standardet e mbikëqyrjes për instrumentet e pagesave (2009); Rekomandime për sigurinë e pagesave në

rëndësi sistemike, Banka e Shqipërisë do të sigurojë pajtueshmërinë e këtyre sistemeve me PITF CPMI-IOSCO.

24. Si pjesë e aktiviteteve të saj mbikëqyrëse, BSH-ja do të sigurojë dialog të vazhdueshëm politikash me të gjithë aktorët e rëndësishëm të tregut të pagesave me vlerë të vogël. Një dialog i tillë do të jetë i nevojshëm për të siguruar përfaqësim të drejtë të të gjithë interesave publike dhe private në proceset vendimmarrëse në lidhje me tregun e pagesave me vlerë të vogël. Kjo do të ndihmojë për të siguruar konsensus mbi zgjedhjet e politikave dhe për të përmirësuar cilësinë e hartimit të politikave sikundër dhe do të ofrojë një mënyrë për BSH-në për t'u dhënë palëve të interesuara udhëzime mbi politikën e saj orientuese dhe mundësinë që ato të japin përgjigje. Aty ku është e nevojshme, BSH-ja do të përdorë dialogun si rrugëdalje për të bindur shtresat e tregut, si mënyra për të shpërndarë njohuritë mbi praktikën më të mira në të gjithë industrinë dhe si mjet për të rregulluar masat vullnetare për veprim kolektiv në nivel industri (për shembull, për vendimet që përfshijnë investimet infrastrukturore dhe masat për zbutjen e rreziqeve).

25. Si katalizator për ndryshim, BSH-ja do të miratojë dhe/ose do të promovojë masa për të lehtësuar një zhvillim më të shpejtë të tregut të pagesave me vlerë të vogël. Për shembull, BSH-ja do të lehtësojë përvetësimin, nga ofruesit e shërbimeve të pagesave, të standardeve të përbashkëta për llojet e veçanta të instrumenteve të pagesave me vlerë të vogël. Po kështu, do të sigurojë, me rregullore, nëse është e nevojshme, që operatorët e sistemeve të pagesave me vlerë të vogël dhe rrjeteve të pikave të aksesit të krijojnë rregulla dhe procedura për shlyerjen efikase, të besueshme dhe të sigurt të transaksioneve të pagesave me vlerë të vogël.

IV.2 Fushat dhe veprimet strategjike

26. Veprimet e parashikuara nga BSH-ja për zbatimin e SKPVV-së në Shqipëri janë në përputhje me parimet udhëzuese të parashtruara më herët dhe mund të ndahen në tetë fusha të gjera strategjike: (i) angazhimi i palëve të interesuara në SKPVV; (ii) kuadri ligjor dhe rregullator; (iii) përmirësimi i pagesave dhe infrastrukturave mbështetëse; (iv) shërbime pagesash të bazuara në llogaritë e transaksioneve dhe fokusuar te klientët; (v)

internet (2013); Udhëzues vlerësimi për sigurinë e pagesave në internet (2014); Udhëzues për vlerësimin e skemave të transfertave të kreditit kundrejt standardeve të mbikëqyrjes (2014); dhe, Udhëzuesi për vlerësimin e skemave të pagesave me kartë kundrejt standardeve të mbikëqyrjes (2015).

rrjetet e pikave të aksesit; (vi) edukimi financiar, (vii) shfrytëzimi i programeve me vëllim të lartë pagesash për të rritur vëllimin e biznesit; dhe (viii) mbikëqyrja efektive.

i) Angazhim më i madh i palëve të interesuara

Lehtësimi i reformës së tregut të pagesave me vlerë të vogël si një përpjekje e përbashkët publike-private

27. KKSP-ja në Shqipëri do të zgjerojë anëtarësimin e saj dhe do të rifreskojë gjithashtu aktivitetet e saj për të lehtësuar zbatimin e SKPVV-së. Nën udhëheqjen e BSH-së, KKSP-ja e Shqipërisë ka shërbyer si një forum i rëndësishëm për të lehtësuar diskutimin ndërsektorial mbi çështjet e sistemit të pagesave. Për lehtësimin e reformës së tregut të pagesave me vlerë të vogël, KKSP-ja do të zgjerojë përbërjen e saj duke përfshirë ofruesit jobankarë të shërbimeve të pagesave, si anëtarë me të drejtë vote. Për më tepër, KKSP-ja do të ketë një rol më aktiv dhe më të dukshëm në kontekstin e SKPVV-së. Si rrjedhojë, do të krijohet një grup pune për shqyrtimin e tregut të pagesave me vlerë të vogël, grup i cili do të mblidhet çdo tre muaj për të monitoruar dhe raportuar ecurinë e SKPVV-së, si dhe për të informuar mbi pengesat që hasen apo për të sugjeruar përfshirjen e KKSP-së sipas nevojës.

28. BSH-ja dhe KKSP-ja do të nxisin përfshirjen më të madhe të sektorit privat në lidhje me vendimet që janë në interes të përbashkët dhe kanë rëndësi publike për tregun kombëtar të pagesave me vlerë të vogël. Këto fusha mund të përfshijnë aspekte të tilla si: zgjedhjet në lidhje me standardet operationale; adoptimi dhe projektimi i infrastrukturës; mënyrat për të arritur ndërveprimin e instrumenteve të pagesave ndërmjet llogarive bankare dhe atyre të parave elektronike; menaxhimin e riskut; dhe adresimi i çështjeve që lidhen me besimin publik.

Akses më i lartë në llogaritë e transaksioneve

29. Shqipëria do të miratojë një qasje të qëllimshme, të koordinuar dhe strategjike, që përfshin dhe angazhon si sektorin publik ashtu edhe atë privat, për të rritur aksesin në llogaritë e transaksioneve dhe për të pasur një përfshirje më të gjerë financiare. Do të krijohet një grup koordinimi për të siguruar që burimet dhe veprimet të koordinohen për një përfshirjen më të madhe financiare.²⁶ Në fazën e parë (2018-2020), grupi koordinues do të

²⁶Qëllimet dhe strategjitë specifike në lidhje me përfshirjen financiare janë në përputhje me këtë SKPVV.

përqendrohet në progresin në lidhje me aksesin dhe përdorimin e llogarive të transaksioneve, duke mbajtur parasysh rekomandimet e përfshira në raportin "Arritja e përfshirjes efektive financiare në Shqipëri - Perspektiva e pagesave". Në një fazë të dytë, në këtë përpjekje do të përfshihen edhe shërbime të tjera financiare që duhet të jenë gjerësisht në dispozicion të individëve dhe bizneseve, si kredia, kursimet dhe sigurimet.

Ndërtimi i kapaciteteve në gjithë industrinë e pagesave

30. BSH-ja, në bashkëpunim me aktorë të tjerë, do të kërkojë të zhvillojë kapacitete dhe njohuri të mjaftueshme për çështjet e pagesave me vlerë të vogël. Pjesëmarrja aktive e industrisë, bashkëpunimi dhe investimi do të jenë të nevojshëm. Përpjekjet e përbashkëta do të synojnë të adresojnë nevojat e burimeve njerëzore të industrisë, nëpërmjet seminareve, *workshop*-ve dhe asistencës teknike. Për këtë qëllim, nismat për krijimin e kapaciteteve do të organizohen, nëse është e nevojshme, me mbështetjen e jashtme nga organizatat ndërkombëtare dhe institucionet partnere.

31. BSH-ja do të kërkojë të promovojë burimet për ndihmë teknike nga ekspertë të jashtëm, agjenci të specializuara ose kolegë të vendeve të tjera. Organizatat ndërkombëtare do të jenë burime jashtëzakonisht të dobishme të asistencës teknike, ndërsa dialogu dhe shkëmbimet me bankat e tjera qendrore dhe autoritetet kombëtare do të ofrojnë perspektiva unike dhe shkëmbime të njohurive të aplikuara. Këto burime njohurish do të shërbejnë për të adresuar sfidat e SKPVV-së, duke përfshirë inovacionet ligjore dhe rregullatore, mbikëqyrjen e shërbimeve të pagesave, politikat e çmimeve për produktet dhe shërbimet e pagesave, duke arritur mes të tjerash edhe ndërveprimin.

ii) Konsolidimi i një mjedisi rregullator të favorshëm për pagesat me vlerë të vogël

Sigurimi i neutralitetit dhe proporcionalitetit

32. BSH-ja do të finalizojë përafrimin e direktivave përkatëse të BE-së, gjë që do të ndihmojë në sigurimin e një qasjeje më të qëndrueshme të rregullimit të llojeve të ndryshme të ofruesve të shërbimeve të pagesave. Përmes kësaj mënyre do të sigurohet një qasje funksionale në rregullimin e sistemit të pagesave, duke vendosur në mënyrë të vazhdueshme kërkesat rregullatore për të gjitha llojet e ndryshme të ofruesve të shërbimeve të pagesave, si dhe lehtëson më tej hyrjen në treg duke krijuar mundësi të barabarta për konkurrencën dhe inovacionin.

33. BSH-ja, së bashku me Shoqatën Shqiptare të Bankave (SHSHB) ,përfaqësuesit e ofruesve të shërbimeve të pagesave jobankare dhe të operatorëve të sistemit të pagesave, do të rishikojnë vazhdimisht kuadrin ligjor dhe rregullator të tregut shqiptar të pagesave me vlerë të vogël. Ky rishikim është i rëndësishëm për sa i përket ritmit të shpejtë të avancimit teknologjik, ndryshimit të shpejtë të praktikave të biznesit dhe evolucionit të shpejtë të tipologjive të rrezikut (duke përfshirë lloje të ndryshme të krimeve, si p.sh.ai kibernetik), të cilat karakterizojnë tregjet moderne të pagesave me vlerë të vogël. Një rishikim gjithëpërfshirës i përbashkët do të kryhet të paktën një herë në vit, ose më shpesh, nëse do të jetë e nevojshme.

Mundësimi i modeleve inovative të biznesit

34. Përdorimi i palëve të treta si agjentë dhe nënagjentë për ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe shërbimeve të tjera të lidhura me pagesat do të rregullohen tërësisht nga BSH-ja. Përdorimi i këtyre agjentëve dhe nënagjentëve do të lejohet për të gjithë llojet e ofruesve të shërbimeve të pagesave. BSH-ja do të përcaktojë në mënyrë të qartë standardet minimale që agjentët duhet të përmbushin dhe do të theksohet qartazi se aktorët kryesorë (d.m.th. bankat, IFJB-të etj.) do të mbajnë përgjegjësi të plotë për çdo veprim të agjentëve të tyre. Marrëveshjet e ekskluzivitetit në lidhje me përdorimin e agjentëve do të jenë rreptësisht të ndaluara.

35. BSH-ja do të rregullojë, në mënyrë vazhdueshme, përdorimin e shërbimeve të ofruara me nënkontraktorë në të gjithë sektorin e pagesave, duke u fokusuar veçanërisht në përdorimin e shërbimeve teknike nga ofruesit. Rregullorja themelore do të sigurojë që nënkontraktimi i funksioneve të rëndësishme operationale nuk do të dëmtojë materialisht cilësinë e ofruesve të shërbimit të pagesave ose kontrollin e brendshëm të operatorëve të sistemit të pagesave si dhe aftësinë e BSH-së për t'i mbikëqyrur ato në mënyrë efektive. BSH-ja, gjithashtu, do të ketë të drejtën për të zgjeruar mbikëqyrjen e saj dhe për të caktuar kërkesat që duhet të aplikohen nga ofruesit e shërbimeve teknike.

Fuqizimi i mbikëqyrjes së shërbimeve të pagesave

36. Banka e Shqipërisë do të iniciojë rishikimin e bazës ligjore të kompetencave të saj rregullatore dhe mbikëqyrëse (d.m.th. në nivel statutor), me qëllim shtrirjen në mënyrë eksplicite të kompetencave në shërbimet e pagesave.. Ligji për Sistemin e Pagesave i jep BSH-së përgjegjësi të qarta për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave dhe instrumenteve të tyre, por kompetenca të tilla nuk përmend qartë kur bëhet

fjalë për ofrimin e shërbimeve të pagesave në përgjithësi. Ky rishikim mund të shkaktojë një ripunim të përkufizimeve në ligj, për të siguruar qartësi të mëtijshme dhe për të përfituar nga përafrimi i direktivave përkatëse të BE-së (shih më lart).

Mbrojtja e të drejtave të përdoruesit, transparenca dhe promovimi i të mirës publike

37. Qeveria shqiptare do të qartësojë dhe detajojë më tej kuadrin e mbrojtjes së konsumatorit, duke krijuar një zyrë/agjenci me kompetenca dhe përgjegjësi për monitorimin dhe zbatimin e mbrojtjes së përdoruesve të pagesave dhe shërbimeve të tjera financiare. Në fushën e pagesave, përpjekjet e kësaj agjencie të re do të jenë në përputhje me dispozitat ekzistuese mbi transparençën dhe mbrojtjen e konsumatorit të BSH-së dhe me ato që rrjedhin nga transpozimi i PSD2 i BE-së.

38. BSH-ja do të vazhdojë të punojë për mbrojtjen e të drejtave të përdoruesve të shërbimeve të pagesave. Në veçanti, me anë të një rregulloreje, BSH-ja do të kërkojë nga ofruesit e shërbimeve të pagesave që të zbatojnë një mekanizëm rekursi dhe zgjidhjeje të mosmarrëveshjeve, për të adresuar kështu kërkesat dhe ankesat e konsumatorit. Kjo do të thotë që përdoruesit do të kenë një mekanizëm lehtësisht të përdorueshëm dhe të përballueshëm për zgjidhjen e konflikteve, pa pasur nevojë për ndërmjetësimin e gjykatës. Ndër veçoritë e tjera, rregullimi do të kërkojë që ky mekanizëm të përfshijë procedura të qarta, të jetë lehtësisht i zbatueshëm dhe në dispozicion të publikut në rast mashtrimi dhe mosmarrëveshjeve. Ai duhet t'i vihet në dispozicion të gjithë konsumatorëve, pavarësisht nga lloji i OSHP-së që ofron shërbimin. Funksionimi i këtij mekanizmi do të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme përmes mbikëqyrjes së BSH-së.

Parandalimi i përdorimit të tregut të pagesave me vlerë të vogël për qëllime kriminale (dhe të SKP-së më gjerë)

39. Autoritetet kompetente do të përforcojnë strukturën e shkallëzuar të përputhshmërisë, duke nxjerrë një rregullore që mbështet këtë qasje ndaj përputhshmërisë. Një strukturë e pajtueshmërisë së shkallëzuar krijon ekuilibrin e përshtatshëm midis rrezikut dhe përputhshmërisë, lidhur me madhësinë e transaksionit dhe nevojat e volumit. Në Shqipëri, kjo qasje aktualisht mbështetet vetëm në një udhëzim të miratuar nga BSH-ja. BSH-ja është e vetëdijshme se një udhëzim i tillë nuk zëvendëson detyrimet ligjore të subjekteve, dhe se është e nevojshme të ketë më shumë siguri, në mënyrë që subjektet të jenë të gatshme të zbatojnë në praktikë qasjen e bazuar në rrezik.

iii) Përmirësimet e pagesave dhe infrastrukturave tjera mbështetëse

Duhet të jenë të gatshme të gjitha infrastrukturat dhe instrumentet kryesore të pagesave

40. BSH-ja dhe operatorët privatë të licensuar nga BSH-ja, dhe me mbështetjen e SHSHB-së, do të punojnë së bashku në mënyrë që *domestic card switch* të bëhet operacional për të gjithë emetuesit e kartave dhe të përdoret gjerësisht prej tyre. Kjo duhet të materializohet sa më shpejt, por jo më vonë se viti 2022. *Card switch* është një infrastrukturë e domosdoshme në një treg modern pagesash. Përmes marrëveshjeve ndërvepruese, transaksionet e kryera me kartë në çdo pajisje që pranon përdorimin e kartës mund të përpunohen nëpërmjet tij. Pagesat me karta në Shqipëri, nuk janë kanalizuar ende për miratim, shkëmbim apo shlyerje nëpërmjet një infrastrukture të tillë.

41. Një *card switch kombëtar* do të bëjë të mundur që të gjitha kartat e ndryshme të emetuara në Shqipëri të kanalizohen, klerohen dhe shlyhen nëpërmjet kësaj infrastrukture. Efikasiteti i përpunimit të pagesës me kartë do të rritet, duke ofruar njësi emetuese të kartave me një pikë të vetme aksesit nga e cila të mund të arrijnë në të gjithë tregun. Me kalimin e kohës, *switch-i kombëtar* duhet të jetë në gjendje të funksionojë edhe me kanale të tjera pagesash, si p.sh.ato nëpërmjet celularit. Për më tepër, në kushtet kur një *card switch* futet në treg, BSH-ja do të përpiqet të arrijë ndërveprimin midis *switch-eve*.

42. BSH-ja, së bashku me SHSHB-në dhe aktorët e tjerë të tregut do të analizojnë, dhe në bazë të gjetjeve, do të hartojnë një studim të fizibilitetit për zhvillimin e projektit "*instant payment*" në Shqipëri. Ky vendim bazohet në Studimin e Kostos së instrumentave të pagesave të përdorura në Shqipëri²⁷, i cili tregon se transfertat elektronike të kreditit janë instrumentat elektronikë të pagesave më efikase të përdorura në ekonominë shqiptare, si edhe bazuar në zhvillimet e fundit në arenën ndërkombëtare. *Switch-i kombëtar* dhe iniciativa "*instant payment*" do të zhvillohen si një projekt i përbashkët nga pikëpamja e fizibilitetit.

43. Pjesëmarrësit e BSH-së dhe AECH do të zbatojnë debitimet ndërbankare direkte në AECH, jo më vonë se 2019. Çdo faturues do të jetë në gjendje të debitojë çdo llogari bankare ose të parasë elektronike në sistemin financiar nga një pikë/llogari e vetme, duke rritur efikasitetin. Për më tepër, debitimet direkte ndërbankare do të ekuilibrojnë më tej fushën e veprimit për bankat e vogla dhe ofruesit e shërbimeve të pagesave që nuk kanë një

²⁷ <http://documents.worldbank.org/curated/en/318231529480715381/The-retail-payment-costs-and-savings-in-Albania>.

rrjet të gjerë fizik, për të mundësuar tërheqien e faturuesit dhe llogarimbajtësit që duhet të paguajnë shërbimet e marra nga këta faturues.

44. BSH-ja dhe SHSHB-ja do të marrin një vendim sa më shpejt për krijimin e një shtëpi klerimi për transfertat në euro, përfshirë vendimet kyçe përsa i përket personit që do të jetë operatori dhe agjenti i shlyerjes. Nëse zbatohet, kjo infrastrukturë e re do të hartohet në mënyrë të tillë që pajtueshmëria me PITF-të e CPMI-IOSCO të sigurohet *ex ante* dhe të bëhet një plotësues dhe jo një zëvendësues për të bërë pagesa në lekë.

[Aksesi në infrastrukturën e pagesave duhet bërë në mënyrë korrekte](#)

45. BSH-ja do të sigurojë që rregulloret dhe rregullat e tjera e të gjithë infrastrukturës së sistemit të pagesave në vend, të garantojnë akses korrekt dhe të hapur, duke marrë masat mbrojtëse të nevojshme ndaj rreziqeve financiare, operacionale dhe të tjera. Aty ku është e nevojshme, do të ndiqen reformat ligjore. BSH-ja do t'i përmbahet rreptësisht Parimit 18, të Parimeve të CPMI-IOSCO për Infrastrukturat e Tregut Financiar ("Infrastruktura e tregut financiar duhet të ketë kritere objektive, të bazuara në rrezik dhe të njoftuara publikisht për pjesëmarrje, të cilat lejojnë akses korrekt dhe të hapur"). BSH-ja do të përfitojë nga puna e saj aktuale për përafrimin e PSD-2 sipas BE-së për të bërë ndryshime ligjore në lidhje me këtë qëllim (në rastet kur është e nevojshme, pra për sistemet e pagesave ku ajo vetë vepron).

46. Në rastin e AECH-së, në periudhën e afërt (2018), Banka e Shqipërisë do të operacionalizojë kategorinë e "pjesëmarrjes të tërthortë". Kjo kategori pjesëmarrëse e përshkruar në rregulloren për AECH mund të jetë e dobishme për disa IFJB që ofrojnë shërbime të pagesave dhe/ose emetojnë para elektronike. Në këtë rregullore, BSH-ja do të zhvillojë dhe do të përfshijë një seri kriteresh objektive, transparente dhe të bazuara në rrezik, që duhet të përmbushen për të arritur këtë lloj aksesi në sistemin AECH.

[Minimizimi i rreziqeve financiare](#)

47. Administrimi i rreziqeve të kredisë dhe likuiditetit në AECH do të përmirësohet nga BSH-ja, në rolin e saj si operator dhe mbikëqyrës i këtij sistemi pagesash. Pozicionet neto të debitit të shkaktuara nga pjesëmarrësit do të kolateralizohen "ex ante". Së bashku me reduktimin e rreziqeve të kredisë dhe likuiditetit, kjo masë do të lehtësojë ofruesin e shërbimeve të pagesave jobanka që do të bëhen pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në sistemin AECH (pasi kështu nuk do të kishin nevojë të hynin në lehtësinë e likuiditetit brenda dite të BSH-së si mjet sigurimi për shlyerjen e pozicionit AECH). BSH-ja

do të analizojë vendosjen e kufizimeve për sa i përket pozicionit të debitit neto të pjesëmarrësve të sistemit AECH.

48. AIPS dhe AECH do të vlerësohen në mënyrë të detajuar kundrejt Parimeve të CPMI-IOSCO për Infrastrukturat e Tregut Financiar. BSH-ja do të kryejë një vlerësim të këtyre dy sistemeve dhe do t'i kërkojë Grupit të Bankës Botërore të kryejë një vlerësim të detajuar të jashtëm. Vetë vlerësimi nga ana e BSH-së do të shërbejë si një kontribut për këtë të fundit.

49. BSH-ja do të sigurojë që çdo sistem pagese që operohet nga sektori privat të marrë masa të forta administrimi të rrezikut në marrëveshjet e tyre mbi klerimin dhe shlyerjen.²⁸

Shfrytëzimi i infrastrukturës së ID-ve dhe shërbimeve të identifikimit

50. Ministria e Brendshme, Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike, dhe Aleat²⁹ do të sigurojnë që renovimi i kartave biometrike të identifikimit të lëshuara në vitin 2009 të përfundojë pa hasur probleme, gjatë vitit 2019. Kjo do t'i lejojë shërbimet e verifikimit të identitetit *online* të funksionojnë normalisht dhe në mënyrë efektive.

51. Ministria e Brendshme do të sigurojë që të gjithë ofruesit e shërbimeve financiare dhe palët e tjera me një qëllim legjitim, të mund të përdorin shërbimin *online* aktual (dhe të ardhshëm) të verifikimit të identitetit, në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. Ndërsa *e-Aleat Identity Services* është një kompani private, ajo do të ofrojë një shërbim publik³⁰ duke ruajtur balancën në treg. Për më tepër, burimi i të dhënave për të është Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (një bazë të dhënash publike).

²⁸ Shih veprimet për mbikëqyrjen efektive të pagesave nga BSH-ja.

²⁹ Në rolin e saj aktual si koncesionar për lëshimin e kartave biometrike të identitetit në Shqipëri, të paktën deri në 2023.

³⁰ Në përgjithësi, një shërbim komunal është një organizatë që mban infrastrukturën për një "shërbim publik", shpesh duke ofruar një shërbim që vë në përdorim atë infrastrukturë. Zakonisht, ekziston vetëm një ose një numër shumë i kufizuar organizatash që ofrojnë një "shërbim publik" të veçantë. Si rezultat i këtyre karakteristikave, shumica e shërbimeve janë të rregulluara nga qeveritë, për të siguruar që ato të ofrojnë një shërbim me nivel kundrejt një çmimi të arsyeshëm, për të gjitha palët e interesuara.

iv) Shërbime pagesash të përballueshme dhe me fokus klientin, të bazuara në llogari

Dizenjimi i produkteve të pagesave kryesore për individët të cilët nuk disponojnë llogari bankare

52. Sistemi bankar, me mbështetjen e AAB-së dhe BSH-së, do të krijojë dhe do të ofrojë një produkt llogarie "bazë" për klientët që aktualisht nuk kanë llogari bankare. Në Shqipëri, kjo hapësirë është mbushur në një farë mase nga IFJB-të e licencuara si emetuese të parasë elektronike. Gjithashtu, bankat do të fillojnë të ofrojnë llogari bazike, për të bërë të mundur që përdoruesit e rinj të kenë akses në një grup më të gjerë shërbimesh financiare si kredi, kursime dhe investime.

53. Disenjimi i llogarive bankare "bazë" siguron që të jetë ekonomikisht e pranueshme , duke ruajtur tiparet thelbësore të një llogarie transaksioni. Më së paku, llogaritë bazë do të bëjnë të mundur që popullata e synuar të depozitojë vlerën në mënyrë të sigurt dhe të dërgojë e të marrë pagesa elektronike me pak ose pa kosto. Gjatë përcaktimit të strukturës së çmimeve dhe karakteristikave të tjera të llogarisë bazë, bankat do të marrin në konsiderat faktin se kategorie e popullatës e synuar prej tyre përbëhet nga individë të varfër, të cilë nuk mund të përballojnë një mbajtjen e një gjendje minimale në llogari. . Sidoqoftë, këto llogari bazë do të bëjnë të mundur që individët të transferojnë fonde dhe të paguajnë në mënyrë elektronike drejt/nga sa më shumë palë të jetë e mundur, por në veçanti drejt/nga ato palë me të cilat këta individë kryejnë transaksione të rregullta rutinë.

54. Për të përmirësuar më tej përfshirjen financiare dhe mbrojtjen e konsumatorit, në periudhën afatmesme BSH-ja do të hartojë dhe do të kërkojë miratimin e një Ligji mbi transpozimin e Direktivës 2014/92/EU “Për krahasueshmërinë e tarifave të lidhura me llogaritë e pagesave, me switching e llogarive të pagesave dhe aksesin në llogaritë e pagesave me karakteristika bazë”.

Mundësimi i produkteve të pagesave më të volitshëm në përgjithësi

55. Bankat, IFJB-të e licencuara si emetuese të parasë elektronike dhe BSH-ja do të synojnë të arrijnë ndërveprim midis të gjitha llogarive rrjedhëse bankare dhe llogarive të parave elektronike, si dhe ndërmjet vetë llogarive e parasë elektronike sa më shpejtë të jetë e mundur. Objektivi përfundimtar është që një individ ose biznes që ka një llogari transaksioni të çdo lloji të jetë në gjendje ta përdorë atë në mënyrë të përsosur me çdo pagesë tjetër në të gjithë Shqipërinë. Parakushtet për këtë objektiv përfshijnë arritjen e marrëveshjeve për ndërveprim në nivelin e infrastrukturës dhe kanaleve të pagesave, si dhe të

gjithë ofruesit e shërbimeve të pagesave duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në këto infrastruktura dhe kanale (pasi të kenë përmbushur kriteret e aksesueshmërisë përkatëse).

56. Industria bankare do të rihartojë strukturën ekzistuese të çmimeve për llogaritë rrjedhëse. Për aq sa është e mundur, shpenzimet paraprake për hapjen e një llogarie bankare dhe tarifat e detyrueshme të mirëmbajtjes mujore/vjetore do të shmangen. Kjo për shkak se këto lloje shpenzimesh dhe tarifash perceptohen nga konsumatorët si elemente kryesore negative të një llogarie, veçanërisht pasi ato nuk varen nga përdorimi i llogarisë ose nga fakti që klienti po përdor instrumentet dhe kanalet më pak të kushtueshme për bankën.

57. Struktura e re e çmimeve të llogarive rrjedhëse në sistemin bankar do të synojë të nxisë më shumë individë dhe biznese të vogla që të kenë llogari dhe të përdorin më tepër veçoritë e pagesave elektronike të këtyre llogarive (në vend të parasë fizike). Në hartimin e një strukture të re çmimi, elementet udhëzuese që do të merren në konsideratë janë: i) alternativat e pagesave plotësisht elektronike (nga fillimi në fund) do të jenë më pak të kushtueshme për ata që kanë llogari sesa për ata që operojnë me para në fizike, apo që përdorin para fizike gjatë një transaksioni; ii) për aq sa është e mundur, llogarimbajtësi do të tatohet në bazë të intensitetit me të cilin ai përdor llogarinë e tij, instrumentet e pagesave dhe kanalet që ai ka zgjedhur; iii) llogarimbajtësit do të kenë stimuj të qartë për të mbajtur fondet në llogaritë e tyre, me qëllim reduktimin e mjeteve monetare në qarkullim dhe rritjen e shumës totale të fondeve që mund të transferohen në mënyrë elektronike, në të gjithë sistemin bankar shqiptar. Përrjashtimi i llogarimbajtësve nga pagesa e mirëmbajtjes së llogarisë, nëse mbajnë një balancë mesatare minimale, do të konsiderohet si një nga stimujt më efektiv në këtë drejtim.

58. Për të siguruar krahasueshmërinë midis bankave, BSH-ja do të rishikojë rregullisht bazën e të dhënave të saj lidhur me çmimet e shërbimeve bankare, si dhe do ta shpërndajë më tej atë mes përdoruesve ekzistues dhe potencialë. Përmbajtja e kësaj baze të dhënash për çmimet do të rishikohet së paku çdo vit, për të siguruar që ajo të përfshijë të gjitha elementet përkatëse të të dhënave dhe elemente të tjera (p.sh. krahasueshmëria) që i vijnë në ndihmë klientëve bankarë për të bërë zgjedhje të informuara. Për më tepër, publikimi i kësaj baze të dhënash në faqen e internetit të BSH-së do të rritet ndjeshëm.

v) Zgjerimi i pikave të aksesit dhe rrjeteve për kryerjen e pagesave

Zhvillimi i modelit të agjentëve bankar

59. Agjentët bankar do të zhvillohen për të rritur afrimin dhe komoditetin e llogarive rrjedhëse bankare për popullsinë. Shfrytëzimi i llogarive të transaksioneve do të rritet, duke arritur një mbulim më të madh të sistemit bankar, veçanërisht për ata individë që jetojnë/punojnë larg nga rrethet kryesore financiare. Përveç përgatitjes së ndryshimeve të nevojshme rregullatore, BSH-ja do të lehtësojë krijimin e agjentëve bankarë, në koordinim me bankat dhe subjektet që janë të interesuara për krijimin e marrëdhënieve me agjentë dhe duke monitoruar zhvillimin e saj në të gjithë Shqipërinë.

60. BSH-ja do të nxisë Postën Shqiptare dhe SHKK-të që të veprojnë si agjentë bankarë. Duke pasur parasysh përvojën e tyre në shërbimin ndaj komuniteteve rurale dhe komunitete të tjera të izoluara, këto dy subjekte, ndër të tjerë, mund të jenë jashtëzakonisht të dobishme në zgjerimin e mundësive të llogarive rrjedhëse bankare jashtë qendrave kryesore urbane në Shqipëri. Megjithatë, bankat do të jenë në gjendje të zgjedhin lirshëm ata agjentë që ato besojnë se janë më të përshtatshëm për planin dhe nevojat e tyre të biznesit.

61. Përdorimi i pikave të aksesit do të rritet në mënyrë efektive, duke arritur ndërveprimin e kanaleve dhe instrumenteve të ndryshme, përfshirë ndalimin e marrëveshjeve të ekskluzivitetit në marrëdhëniet e agjentëve. Ndërsa një periudhë e shkurtër ekskluziviteti mund të justifikohet në raste të caktuara nga nevoja për të investuar në trajnim dhe pajisje, një justifikim i tillë nuk vlen për ekskluzivitete të pakufizuara. Për këtë arsye, si rregull i përgjithshëm, marrëveshjet e ekskluzivitetit do të ndalohen nga BSH-ja.

Nxitja e pranimin më të lartë të pagesave elektronike, nëpërmjet çmimeve dhe stimujve

62. Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të analizojë mundësinë e ofrimit të një sërë stimujsh që do të nxisin pranimin e pagesave elektronike nga tregtarët . Stimujt mund të përfshijnë: ofrimin e një subvencioni të përkohshëm për bizneset e vogla për marrjen me qira të terminaleve POS ose pajisjeve të tjera të pranimin të transaksioneve; sigurimin e një përfitimi të përkohshëm fiskal për blerjet në të cilat biznesi ka pranuar karta ose instrumente të tjera elektronike si mjet pagese; etj.

63. BSH-ja do t'u kërkojë bankave që janë “acquirer” të kartave të pagesave të jenë transparente në tarifatat që ato u ngarkojnë tregtarëve, duke përfshirë vënien e këtij informacioni në dispozicion të tyre në një formë të standardizuar. Ajo gjithashtu do të mbledhë sistematikisht të dhëna mbi këto tarifa. Kostoja e pranimin të kartave të pagesave

është një nga faktorët kryesorë përcaktues për bizneset që t'i pranojnë ato. Këto kosto përfshijnë: tarifat mujore të qirasë për pajisjet e pranimit; dhe normën e zbritjeve tregtare (NZT) për transaksion dhe pagesa të tjera mujore ose për transaksion. BSH-ja do të zbatojë kërkesat e transparencës në hapësirën e blerjes tregtare (kundrejt tregtarëve që pranojnë ose po marrin në shqyrtim pranimin e kartave të pagesave) të ngjashme me ato që tashmë janë aplikuar në lidhje me llogarimbajtësit. BSH-ja do të inkorporojë të dhënat mbi shërbimet e blerjes tregtare në bazën e të dhënave të çmimeve të shërbimeve bankare dhe do ta bëjë këtë informacion të disponueshëm në faqen e saj të internetit.

vi) Përpjekjet efektive të edukimit financiar

Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për SKPVV-në dhe përfitimet prej saj

64. BSH-ja, SHSHB-ja dhe KKSP-ja do të hartojnë mesazhe bindëse për të shpjeguar se çfarë përfitimesh do të sjellë zbatimi i SKPVV-së në Shqipëri. Komuniteti i biznesit dhe publiku i gjerë duhet të njihet me objektivat strategjike, nëpërmjet informimit të publikut dhe fushatave edukative.

Informimi dhe edukimi i përdoruesve aktualë dhe atyre potencialë mbi llogaritë dhe pagesat elektronike

65. BSH-ja, subjektet e tjera të sektorit publik dhe ofruesit e shërbimeve të pagesave do të intensifikojnë përpjekjet e tyre për të edukuar qytetarët shqiptarë mbi përdorimin e llogarive të transaksioneve dhe pagesave elektronike, përmes ofrimit në rritje të informacionit të shënjestruar. Përpjekjet për edukim financiar do të drejtohen karshi aspekteve kryesore që pengojnë individët dhe bizneset për të ndryshuar zakonet dhe sjelljen e tyre lidhur me pagesat. Prandaj, këto përpjekje do të adresojnë veçanërisht mënyrën se si llogaritë mund të ndihmojnë në mënyrë efektive në përmbushjen e nevojave të pagesës së individit dhe të ruajtjes së vlerave. Ato do të synojnë të luftojnë faktorë të veçantë të "frikës", siç janë: i) perceptimi i mungesës së provës reale të kryerjes së pagesës, nëse nuk përdoret para fizike; (ii) frika se modalitetet e reja mund të jenë të më cenueshme nga mashtrimi; (iii) frika nga përballja me sisteme të papërgjegjshme dhe të komplikuar, me prirje për gabime operacionale; dhe, (iv) perceptimi i humbjes së privatësisë.

66. Bankat dhe IFJB-të që ofrojnë shërbime të pagesave do të ofrojnë trajnim të mjaftueshëm praktik për konsumatorët. Në kenë mënyrë, konsumatorët do të kuptojnë se si funksionon në praktikë një produkt ose shërbim pagese, duke përfshirë këtu dhe problemet

që mund të hasen. Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet përdorueseve të rinj me ekspozim të kufizuar ndaj shërbimeve elektronike të pagesave. Trajnimi praktik do të ofrohet edhe për klientët ekzistues ose ata të rinj, si pjesë e përdorimit të produkteve të pagesave ose shërbimeve të reja apo plotësuese.

67. Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike³¹, nëpërmjet Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve të Integruara Publike (ADISA) dhe në bashkëpunim me agjencitë tjera përkatëse (p.sh. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, AKSHI), do të bëjë më shumë përpjekje për të rritur ndërgjegjësimin ndaj përfitimeve që lindin nga përdorimi i portalit e-Albania. Gjithashtu, kjo ministri do të përqendrohet në edukimin e publikut të gjerë për përdorimin në mënyrë sa më efektive (p.sh. duke përfshirë pagesat *online*, aty ku është e mundur).

68. BSH-ja do të masë, në mënyrë sa më objektive, efektivitetin e përpjekjeve dhe programeve të edukimit financiar që ka ndërmarrë. Kjo është shumë e rëndësishme pasi siguron marrjen e vendimeve të informuara, atëherë kur ndryshimet dhe/ose përshtatjet janë të nevojshme, kur bëhet fjalë për vetë materialet e trajnimit, formën në të cilën ato janë përcjellë dhe/ose shpërndarë, grupet e synuara etj. Disa nga aspektet që do të maten mund të përfshijnë informacionin se sa njerëz momentalisht kanë njohuri mbi pagesat moderne dhe produktet e tjera financiare, dhe se si e kanë ndryshuar ata qëndrimin e tyre si rezultat i informacionit që u ishte vënë në dispozicion.

vii) Ekonomitë e shkallës në SKP, duke shfrytëzuar rastet e përdorimit të pagesave me vëllim të madh

Kalimi i pagesave të qeverisë dhe arkëtimet në pagesat elektronike në vëllim sa më të madh që të jetë e mundur

69. Disbursimi i pagesave të qeverisë drejtpërdrejt në llogari do të shtrihet përtej pagave të punonjësve të sektorit publik, për të përfshirë pensionistët dhe përfituesit e programeve të mirëqenies sociale, nga qeveria qendrore dhe ajo lokale.

70. Llogaritë bankare "bazë" do të përdoren për disbursimin e pensioneve dhe programeve të mirëqenies sociale, në periudhën afatshkurtër. Llogaritë e parave

³¹ Aktualisht Zëvendëskryeministri

elektronike do të përdoren gjithashtu, në afat të mesëm, sapo të bëhen ndërvepruese me llogaritë bankare. Kalimi i shpërndarjes së këtyre programeve nëpërmjet llogarive është më kompleks se pagesat e tjera qeveritare (p.sh. pagat), për shkak të të ardhurave të ulëta të përfituesve, zotërimit të ulët të llogarive dhe niveleve më të ulëta të kulturës financiare dhe digjitale. Prandaj, minimalisht: i) llogaria e transaksionit do t'i ofrohet përftuesit me pak ose pa kosto; (ii) këto llogari do të jenë të arritshme/të përdorshme në një kombinim të kanaleve, si virtuale ashtu edhe fizike; iii) për më tepër, ato do të jenë produkte kryesore (domethënë shumë-funksionale dhe ndërvepruese me produkte të tjera bankare dhe me kanale/pika të ndryshme akses); iv) përftuesi do të jetë në gjendje të zgjedhë bankën që ai/ajo do.

71. Çdo pengesë e mbetur ligjore ose rregullore për arkëtimin e pagesave për qeverinë nga jobankat do të eliminohet. Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe BSH-ja pranojnë se arkëtimi mund të përfitojë nga modelet e reja të biznesit, kanalet elektronike dhe *online* që shmangin nevojën për t'u paraqitur në degën e bankës ose ambientet e agjencisë qeveritare.

72. Do të zgjerohet numri dhe shumëllojshmëria e shërbimeve publike dhe pagesave të tjera P2Q dhe B2Q që mund të paguhen *online* nëpërmjet e-Albania. Për më tepër, pranimi i pagesave *online* në e-Albania do të shkojë përtej kartave të pagesave, duke përfshirë këtu edhe transfertat elektronike të fondeve të kryera nëpërmjet llogarive bankare apo nga llogaritë e parasë elektronike. Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike do të bashkëpunojë me subjektet e tjera të sektorit publik, BSH-në dhe ofruesit e shërbimeve të pagesave për këtë qëllim.

[Shfrytëzimi i rolit të faturuesve të mëdhenj, si dhe pagesat e transportimit](#)

73. Duke pasur parasysh situatën aktuale të dominimit të parasë fizike për arkëtimet e faturave të shërbimeve dhe pagesat e transportit, do të ndërmerren veprime për të dekurajuar përdorimin e parave fizike dhe për të nxitur alternativat e pagesave elektronike. Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të shqyrtojë realizueshmërinë e zbritjes së TVSH-së për blerjet e bëra me mjete elektronike, përfshirë pagesën e faturave. Faturuesit e mëdhenj dhe operatorët e sistemit të transportit gjithashtu do të bashkëpunojnë në nxitjen e përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave, të cilat mund të zvogëlojnë shpenzimet e tyre të arkëtimit. Faturuesit do të shqyrtojnë zbritje dhe/ose stimuj të tjerë nëse faturat shlyhen përmes debitimit direkt. Ata gjithashtu do të kryejnë fushata edukimi për klientët e tyre, punonjësit dhe autoritetet lokale, për të

sqaruar se faturat e paguara elektronikisht janë ligjërish të vlefshme dhe për këtë arsye nuk kërkohet dëshmi në letër. Po kështu, në momentin që pagesat elektronike pranohen prej tyre, operatorët e sistemit të transportimit do të shqyrtojnë mundësinë e ofrimit të zbritjeve për përdoruesit që paguajnë rregullisht në mënyrë elektronike.

74. Mekanizmat e pagesave elektronike të planifikuara për përdorim në sistemet e transportit masiv do të kenë një trajektore të qartë sa i përket ndërveprimit të tyre dhe instrumenti bazë i pagesës do mund të përdoret në forma të tjera shërbimesh. Në mbarë botën, shumica e mekanizmave të pagesave të përdorura për sistemet e transportit janë me parapagesë. Ndërveprimi i këtyre mekanizmave në sistemet e transportit është i rëndësishëm për arsye të efikasitetit, por edhe për të ndihmë individët me të ardhura të ulëta, të cilët shpesh nuk mund të përballojnë mbajtjen e gjendjeve në dy ose më shumë pajisje me parapagim.

Lehtësimi i shërbimeve të llogarisë për remitancat

75. BSH-ja do të rrisë konkurrencën dhe do të nxisë inovacionin në tregun shqiptar të dërgesave të emigrantëve për të ndihmuar në realizimin e potencialit të tyre si mjet aksesit financiar dhe përfshirjeje. Konkurrenca do të rritet duke eliminuar kontratat ose marrëveshjet e ekskluzivitetit, pasi ato pengojnë shfrytëzimin e plotë të rrjetit të pikave të aksesit në të gjithë vendin. Lejimi i IFJB-ve ofruese të shërbimeve të pagesave që të bëhen pjesëmarrëse të drejtpërdrejta në AECH, do t'u mundësojë atyre të zhvillojnë produkte të reja me shpërndarjen e fondeve drejt llogarive. Bashkëpunimi midis bankave dhe operatorëve të transferimit të parave (OTP) do të promovohet gjithashtu për të mundësuar inovacionin e produktit. Këto veprime do të koordinohen me masat e tjera të parashikuara në Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Diasporën dhe Migracionin (2018-2024).

viii) Mbikëqyrja efektive e BSH-së për sa i përket tregut të pagesave me vlerë të vogël

76. BSH-ja do të rishikojë kuadrin e politikave të mbikëqyrjes dhe manualet e mbikëqyrjes për të përfshirë edhe shërbimet e pagesave në to (përveç sistemeve dhe instrumenteve të pagesave). Ndryshimet ligjore do të ndërmerren për të përfshirë shprehimisht shërbimet e pagesave në kuadrin e mbikëqyrjes së BSH-së. Ndërkohë, BSH-ja do të fillojë mbikëqyrjen e këtyre shërbimeve, duke përdorur një qasje "të butë", e cila konsiston kryesisht në mbledhjen e statistikave dhe ndjekjen e zhvillimeve të tregut. Pasi

ndryshimet ligjore të hyjnë në fuqi, shërbimet e pagesave do të mbikëqyren në një shkallë të plotë.

- 77. BSH-ja do të bëjë të mundur që ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe operatorët e sistemit të pagesave të rishikojnë rregullisht koston dhe strukturën e tyre të çmimeve dhe të shmangin çdo praktikë abuzive çmimesh.** BSH-ja do të jetë në kontakt të vazhdueshëm me tregun, me qëllim monitorimin e politikave të çmimeve dhe të praktikave të padrejta. BSH-ja nuk do të lejojë praktika të padrejta çmimesh për shërbimet e infrastrukturës (p.sh. përfshirë këtu tarifën e shkëmbimit në tregun e kartave të pagesave). Për të nxitur vendosjen e çmimeve në mënyrë sa më transparente, BSH-ja do të bindë ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe operatorët e sistemit të pagesave të ofrojnë çmime më të larta për një grup konsumatorësh duke subvencionuar çmime më të ulëta për një grup tjetër (*cross-subsiding*).
- 78. BSH-ja dhe Autoriteti i Konkurrencës do të marrin masa kundër çdo praktike anti-konkurrese në tregun e pagesave me vlerë të vogël.** Në veçanti, ata do të monitorojnë çdo veprim nga aktorët e tregut që kanë për qëllim mosofrimin, pengimin ose kufizimin e aksesit ndaj shërbimeve që përfshijnë konkurrentët (p.sh. veprimet që pengojnë konsumatorët nga fillimi i pagesave për klientët e bankave të tjera ose që i pengojnë ata të përdorin rrjetin ATM-ve ose POS-ese të bankave të tjera, duke ngarkuar tarifa ndaluese). Banka e Shqipërisë, në përputhje me mandatin dhe përgjegjësinë e saj ligjore, do të ndërmarrë drejtpërdrejt të gjitha veprimet për të mbrojtur konkurrencën në pagesat me vlerë të vogël. Kur është e nevojshme, çështjet e konkurrencës do të trajtohen në bashkëpunim me Autoritetin e Konkurrencës së Shqipërisë.
- 79. BSH-ja do të sigurojë që kontratat, që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet për ofruesit e shërbimeve dhe përdoruesit, të jenë të përcaktuara qartë dhe të zbatohen.** Këto përfshijnë aspekte si për shembull: mënyra se si autorizohen dhe ekzekutohen transaksionet; koha maksimale e ekzekutimit dhe vlerësimi i datës së pagesave; revokimi i urdhërpagesave; detyrimet në rast të përdorimit të paautorizuar të instrumenteve të pagesave; dhe rimbursimet për këto të fundit.
- 80. BSH-ja do të mbajë një regjistër të agjentëve të përdorur nga bankat dhe ofrues të tjerë të shërbimeve të pagesave, regjistër i cili do të jetë publik, në dispozicion të konsumatorëve.**

V. ZBATIMI I STRATEGJISË KOMBËTARE TË PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL: ROLET, PËRGJEGJËSITË DHE MONITORIMI I PROGRESIT

V.1 Rolet dhe përgjegjësitë

81. Zbatimi i suksesshëm i strategjisë do të kërkojë që aktorëve të ndryshëm t'u caktohen role dhe përgjegjësi specifike, sipas rregullave të përgjegjësisë publike.

Banka e Shqipërisë

82. BSH-ja është një aktor kritik në zbatimin e SKPVV-së. Ajo do të luajë një rol shumë proaktiv në promovimin e SKPVV-së, duke mbështetur bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet aktorëve, si dhe duke promovuar veprime të përbashkëta nga aktorët, sa herë që të jetë e nevojshme. Në cilësinë e saj si një bankë qendrore, BSH-ja do të:

- i. nxisë reformat e pagesave me vlerë të vogël dhe masat e zhvillimit, kryesisht duke nxitur veprime dhe vendime bashkëpunuese nga sektori privat, si dhe nga subjekte të rëndësishme të sektorit publik;
- ii. hartojë ligje dhe rregullore (ose ndryshime të tyre), si dhe dokumente strategjike;
- iii. mbikëqyrë tregun e pagesave me vlerë të vogël dhe më gjerësisht sistemin kombëtar të pagesave, për të siguruar funksionimin e mirë të tyre;
- iv. sigurojë struktura klerimi, shlyerjeje dhe infrastrukturore, nëpërmjet operimit të sistemeve AIPS dhe AECH, duke përfshirë sigurimin e përfundimit dhe pakthyeshmërisë në pagesën dhe shlyerjen e transaksioneve, duke rritur kështu besueshmërinë në sistemin e pagesave; dhe
- v. përdorë infrastrukturë, instrumente dhe shërbime moderne pagesash për aktivitetet e veta të pagesave dhe ato në emër të klientëve, institucioneve dhe individëve.

Shoqata Shqiptare e Bankave

83. SHSHB-ja do të jetë përgjegjëse për:

- i. koordinimin dhe përfaqësimin e interesave të anëtarëve të saj për çdo çështje që ka të bëjë me SKPVV-në, duke përfshirë, por pa u kufizuar, hartimin dhe prezantimin e produkteve të reja të pagesave në të gjithë industrinë bankare, edukimin financiar dhe problemet e çmimeve të produkteve/shërbimeve;

- ii. nxitjen dhe koordinimin e iniciativa për të krijuar infrastruktura pagesash me vlerë të ulët me pronësi private, dhe nxitur integrimin e tyre me infrastruktura të tjera (p.sh. AIPS);
- iii. hartimin dhe miratimin e standardeve në të gjithë industrinë bankare (dhe me ofrues të tjerë të shërbimeve të pagesave) për të siguruar njëtrajtshmërinë dhe efikasitetin e operacioneve; si dhe
- iv. nxitjen dhe lehtësimin e ndërveprimit të të gjitha llogarive bankare dhe ndërmjet llogarive bankare dhe llogarive të parasë elektronike.

Komiteti Kombëtar i Sistemit të Pagesave

84. Për sa i përket zbatimit të SKPVV-së, KKSP do të përfshihet kryesisht në monitorimin e progresit. Në këtë kontekst, Komiteti gjithashtu do të:

- i. raportoje publikisht mbi zbatimin e SKPVV-së dhe veprimet e ndërmarra nga anëtarët e tij; dhe,
- ii. marrë - kur është e nevojshme për të përshpejtuar progresin - një rol aktiv në vendimmarrje, lidhur me çështjet strategjike dhe politike të sistemit të pagesave;
- iii. lehtësojë komunikimet ndërmjet aktorëve të sektorit publik dhe atij privat.

Agjenci dhe institucione qeveritare të tjera

85. Agjencitë qeveritare që mbajnë përgjegjësi rregulluese në fusha që kanë lidhje të ngushta me SKPVV-në mund të kenë role dhe përgjegjësi të rëndësishme. Këto përfshijnë agjenci rregulluese për: telekomunikacionin; konkurrencën; mbrojtjen e konsumatorëve; punën dhe sigurinë shoqërore; etj.

86. Subjekte qeveritare të tjera që kanë role të rëndësishme në kontekstin e SKPVV-së janë Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike³², Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Brendshme.

Ofruesit e Shërbimeve të Pagesave (banka dhe IFJB-të që ofrojnë shërbime të pagesave)

87. Ofruesit individualë të shërbimeve të pagesave do të:

- i. angazhohen për transparencën në kryerjen e shërbimit të pagesave kundrejt klientëve të tyre (individë, biznese dhe subjekte qeveritare që mbajnë llogari me ta, si dhe tregtarë në biznesin blerës të tyre);

³² Aktualisht Zëvendëskryeministri

- ii. menaxhojnë fort rreziqet e lidhura me shërbimet e pagesave që i ofrojnë publikut, si dhe operacionet e pagesave të tyre më në përgjithësi; dhe,
- iii. adoptojnë udhëzimet strategjike për tregun e pagesave me vlerë të vogël aprovuar nga KKSP-ja.
- iv. marrin pjesë aktivisht në projektimin dhe testimin e sistemeve të reja të pagesave ndërbankare të cilat zbatohen në vend, gjithashtu edhe në lançimin e tyre.

Operatorët e Sistemit të Pagesave

88. Operatorët individualë të sistemit të pagesave do të:

- i. ndjekin praktikatat që nxisin ndërveprimin dhe bashkëpunimin, për krijimin e standardeve, infrastrukturave/shërbimeve dhe aksioneve të përbashkëta, kur është e nevojshme;
- ii. respektojnë standardet ndërkombëtare për administrimin e rrezikut dhe ndjekin praktikatat më të mira që rrisin nivelin e efikasitetit dhe efektshmërisë në shërbim të nevojave të tregut;
- iii. ruajnë dhe përmirësojnë një politikë për akses të hapur, të drejtë dhe të bazuar mbi rrezik; si dhe
- iv. adoptojnë udhëzimet strategjike për tregun e pagesave me vlerë të vogël, miratuar nga KKSP-ja.

Shoqatat e Industrisë dhe Organizatat e Shoqërisë Civile

89. Shoqatat e industrisë dhe organizatat e shoqërisë civile do të angazhohen mbi çështje specifike, sipas objektivave dhe përgjegjësive të tyre statutore, dhe me kërkesë të KKSP-së, për të mbështetur strategji të zbatimit dhe rregullave të pjesëmarrjes.

V.2 Monitorimi i progresit

90. Një kuadër i monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të SKPVV-së do të zhvillohet paraprakisht dhe do të bëhet pjesë integrale e planit të përgjithshëm. Ecuria në zbatimin e SKPVV-së do të vlerësohet periodikisht duke u krahasuar me vizionin dhe objektivat gjithëpërfshirës të matshëm të vendosur në fillim të SKPVV-së (shihni paragrafët 63 dhe 64). Gjithashtu, do të maten/llogariten dhe monitorohen një numër

“variablash të ndërmjetëm”, të cilët shoqërojnë ecurinë drejt vizionit dhe objektivave gjithëpërfshirës. Kjo do të ndihmojë për të identifikuar menjëherë kërkesat për korrigjim të ecurisë.

91. Në këtë kontekst, objektivat gjithëpërfshirës të matshëm të SKPVV-së janë:

- i. rritja e numrit aktual të pagesave që nuk kryhen me para fizike për frymë me 130%, në 10 pagesa të tilla, deri në fund të vitit 2022. Pika fillestare është 4.3 pagesa që nuk kryhen me para fizike për frymë, në fund të vitit 2016;
- ii. arritja e raportit të zotërimit të llogarive të personave në moshë madhore në 70%, deri në vitin 2022. Pika fillestare është 38%, rezultuar në fund të vitit 2014.

92. BSH-ja dhe KKSP-ja do të masin këta variabla gjithëpërfshirës një herë në vit, dhe do t’ia komunikojnë publikut progresin e arritur .

93. Nga ana tjetër, BSH-ja do të zgjedhë ato variabla të ndërmjetëm që do të llogariten, të paktën një herë në gjashtë muaj, në përpjekje për të identifikuar tendencat sa më shpejt të jetë e mundur. Edhe këto llogaritje do t’i raportohen çdo muaj KKSP-së.

94. Në këto raporte, BSH-ja do të identifikojë shifrat fillestare për çdo variabël të ndërmjetëm, drejtimin e pritur të tyre (d.m.th. nëse duhet të ketë një tendencë rritëse apo ulëse, për të qenë në përputhje me objektivat gjithëpërfshirës), shifrën aktuale të muajit dhe diferencën krahasuar me shifrën fillestare (ndryshime në vlerë absolute dhe normat e rritjes).

95. Disa kandidatë të mundshëm për këta variabla të ndërmjetëm tregohen në tabelën 5.

Tabelë 5. Variabla të ndërmjetëm të mundshëm për të vlerësuar përparimin e zbatimit të SKPVV-së³³

Variabla të ndërmjetëm	Shpjegim
Pikat e aksesit	Kjo do të përfshijë matës të tillë si терминаlet ATM dhe POS për 1000 banorë dhe numrin e degëve për 1000 banorë. Për të pasur një vlerësim më të saktë, mund të zhvillohet gjithashtu një matës për zona gjeografike specifike (rajoni, zona urbane kundrejt rurale etj.).
Të tjerë matës të aksesit	Ky grup matësish ndihmojnë për të vlerësuar penetrimin e instrumenteve të pagesave dhe kanaleve hyrëse alternative. Këto mund të përfshijnë matës si numri i kartave të kreditit dhe debitit për frymë; pjesa e llogarimbajtësve të regjistruar në shërbimin bankar përmes internetit dhe/ose celularit; pjesa e llogarimbajtësve që përdorin shërbimin bankar përmes internetit dhe/ose celularit të paktën një herë në muaj; etj.

³³ Kjo nuk është një listë e plotë e variablave të ndërmjetëm të mundshëm.

Variabla të ndërmjetëm	Shpjegim
Transaksionet për terminal ATM dhe POS	Ky është numri i transaksioneve për ATM, POS apo infrastrukturë pranimi, gjatë një periudhe kohe. Kjo shërben për të matur nivelin e ndërveprimit dhe përdorimit të infrastrukturës.
Transaksione në POS/ Transaksione në ATM	Ky numër reflekton evolucionin në përdorimin e kartave të pagesave si instrument pagese elektronik me tregtarët, kundrejt përdorimit të tyre si mekanizëm shpërndarës i parasë fizike (p.sh. në ATM).
Shpenzime totale duke përdorur karta pagesash/ kundrejt shpenzimeve konsumatore	Ky variabël ka si qëllim të reflektojë evolucionin e shpenzimeve konsumatore të bëra me karta pagesash (kreditit dhe debiti), si përqindje e totalit të shpenzimeve konsumatore.
Përqindje e instruksioneve të pagesave të marra nga OSHP-të, thjesht nëpërmjet mjeteve elektronike	Kjo është pjesa e instruksioneve të pagesave të marra nga ofruesit e shërbimit të pagesave, nëpërmjet mjeteve elektronike, kundrejt totalit të numrit të instruksioneve të pagesave (duke përfshirë kanalet elektronike, në formë letër dhe kontaktit të drejtpërdrejtë).
Përqindje e instruksioneve të pagesave të marrë dhe përpunuar thjesht nëpërmjet mjeteve elektronike nga OFSH-të	Si më sipër, megjithëse ky variabël gjithashtu përfshin nëse instruksionet e pagesave u përpunuan elektronikisht, pasi u morën në formë elektronike (d.m.th. për të identifikuar evolucionin në përpunimin e drejtpërdrejtë).
Përqindje e pagesave qeveritare të bëra direkt në llogaritë përfituese	Kjo është pjesa e pagesave qeveritare (në vëllim) që janë paguar direkt nga llogaria e qeverisë në BSH të llogaria e përfituesit (nëpërmjet AIPS apo AECH). Tregues të ndryshëm mund të llogariten mbi listën e pagave, shitësit dhe furnizuesit, përfituesit e programeve të asistencës sociale, transferimet qeverime-qeveri etj.
Evolucioni i koston për një transferim të brendshëm fondesh midis palësh me llogari në ofrues shërbime pagesash të ndryshëm	Kjo është kostoja <u>totale</u> (për iniciuesin dhe për përfituesin përfundimtar) e kryerjes së një transferte fondesh të brendshme midis palësh që mbajnë llogari në dy institucione të ndryshme. Për ta bërë atë të krahasueshme, duhet të jetë për një sasi përfaqësuese e shprehur si një përqindje e saj, dhe për institucione të ndryshme e mënyra të ndryshme.
Evolucioni i koston së transfertave të fondeve brenda vendit kundrejt remitancave me para në dorë	Ky variabël krahasohet me evolucionin e variablit të mëparshëm kundrejt evolucionit të koston së bërjes së të njëjtit transaksioni (d.m.th. transferim parash), por duke përdorur vetëm para në dorë. Ky variabël është veçanërisht i rëndësishëm për transferime nga një qytet në tjetrin.
Evolucioni i koston fikse mujore për të mbajtur një llogari transaksioni	Kjo është kostoja për konsumatorin për të mbajtur llogari specifike, produkte pagesash si: një llogari bankare për kartat e debitit; llogari për karta të parapaguara; llogari (<i>mobile</i>) për pagesa nëpërmjet telefonit celular; etj. Llogaritë duhen bërë sipas llojit të ofruesit të shërbimit të pagesave (bankë kundrejt IFJB), dhe sipas llojit të prodhimit (p.sh. prodhimet bazë dhe të rregullta në një kategori, dhe produkte premium në një kategori tjetër).
Evolucioni i koston për llogarimbajtësit për transaksion	Ky variabël ka qëllim të masë evolucionin e koston për llogarimbajtësit të shërbimeve të ndryshme që paguhen vetëm në bazë të përdorimit. Ai do të përfshijë tarifatat për tërheqje në ATM “off-us”, tarifa për transferime brenda banke dhe ndërbankare (të ndara sipas kanalit) etj. Për të përcjellë më lehtë rezultatet duhet të llogaritet një tregues përfaqësues (p.sh. mesatarja e ponderuar ose të ngjashme).
Evolucioni i normës së zbritjes tregtare	Ky variabël synon matjen e evolucionit të normës së zbritshme tregtare në aktivitetin e pranimit të kartave të pagesave. Për të përcjellë më lehtë rezultatet duhet të llogaritet një tregues përfaqësues (p.sh. mesatarja e ponderuar ose të ngjashme).
Vëllimi dhe vlera e mashtrimeve dhe gabimeve operacionale.	Ky është numri dhe vlera e mashtrimeve, përfaqësuar në përqindje për kategori specifike mashtrimesh dhe gabimesh operacionale, si: përpunimi i vonuar i transferimit të një fondi; debitimi i një llogarie të gabuar; mashtrime falsifikimi; mashtrime të lidhura me reputacionin etj.

Burimi: Adoptuar nga Banka Botërore (2012), "Zhvillimi i një strategjie gjithëpërfshirëse kombëtare të pagesave me vlerë të vogël".

V.3 Plani i zbatimit

Tabelë 6. Plani i zbatimit për SKPVV-në Shqipëri

Fusha strategjike	Aksione	Enti/Njësia kryesore e zbatimit	Koha (2018-2023)
Përforcimi i angazhimit të aktorëve	Zgjerimi i anëtarësimit të KKSP-së për të përfshirë si anëtare me të drejtë vote IFJB të licencuara për të ofruar shërbime pagesash.	BSH për koordinim	Marrëveshja në vitin 2017. Për t'u bërë funksionale në vitin 2018.
	Një rol më aktiv dhe i dukshëm i KKSP-së në kontekstin e SKPVV-së: <ul style="list-style-type: none"> - krijimi i një grupi pune të pagesave me vlerë të vogël brenda KKPS-së për të monitoruar dhe raportuar progresin e SKPVV-së; - përfshirja e vazhdueshme e KKSP-së gjatë reformës. 	Anëtarë të KKSP-së, me mbështetje nga BSH (si Sekretariati)	Krijimi në gjysmën e parë të vitit 2018; punë në vazhdim.
	Promovim sa më i madh i përfshirjes së sektorit privat në vendimet me interes të përbashkët dhe rëndësi publike, për sa i përket tregut kombëtar të pagesave me vlerë të vogël.	Anëtarë të BSH-së dhe KKSP-së	Fillimi në vitin 2018 dhe në vazhdim.
	Krijimi një grupi koordinimi për të siguruar që burimet për avancimin e përpjekjeve për përfshirjen financiare të jenë të koordinuar në mënyrë efektive: <ul style="list-style-type: none"> - në një fazë të parë (2019-2020), ky grup do të fokusohet në promovimin e aksesit dhe përdorimit të llogarive të transaksioneve; - në një fazë të dytë do të përfshihen kredia, kursimet dhe sigurimi. 	BSH, KKSP, Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, Kryeministria dhe Administrata Publike, ³⁴ Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Krijimi i grupit para fundit të vitit 2018. Zbatimi i fazës së parë gjatë viteve 2019-2020. Zbatimi i fazës së dytë nga viti 2020 e në vazhdim.
	Zhvillimi i kapaciteteve dhe ekspertizës së mjaftueshme mbi çështjet e pagesave me vlerë të vogël. Kjo përfshin nxitjen e burimeve për asistencë teknike nga ekspertë të jashtëm, agjenci të specializuara ose kolegë të vendeve të tjera.	BSH dhe SHSHB BSH	Fillimi në vitin 2018 dhe në vazhdim.
Konsolidimi i mjedisit rregullator lehtësues për pagesat me vlerë të vogël	Finalizimi i përafrimit të EU PSD-2	BSH	Para fundit të vitit 2018.
	Rishikimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor dhe rregullator të tregut shqiptar të pagesave me vlerë të vogël.	BSH, SHSHB dhe përfaqësues të IFJB-ve dhe operatorëve të sistemit të pagesave	Në vazhdim
	Rregullore gjithëpërfshirëse të agjentëve dhe nënagjentëve për ofrimin e shërbimit të pagesave dhe shërbimeve të lidhura me to.	BSH	2019
	Rregullim në mënyrë të qëndrueshme i përdorimit të nënkontraktimit të shërbimeve nga palë të treta në të gjithë sektorin e pagesave, me fokus të veçantë në përdorimin e ofruesve të shërbimit teknik.	BSH	2019
	Rishikimi i bazave ligjore rregullatore dhe mbikëqyrëse të BSH-së (d.m.th., në nivel statutor) për t'i shtrirë shprehimisht këto rregulla mbi <i>shërbimet e pagesave</i> .	BSH	2018-2019 (Mund të bëhet paralelisht me përafrimin e EU PSD2)

³⁴ Aktualisht zëvendëskryeministri.

Fusha strategjike	Aksione	Enti/Njësia kryesore e zbatimit	Koha (2018-2023)
	Krijimi i një zyre/agjencie me të drejtën dhe përgjegjësinë për të monitoruar dhe zbatuar mbrojtjen e përdoruesve të shërbimeve të pagesave dhe shërbimeve të tjera financiare.	Qeveria Shqiptare ³⁵	2019-2020
	Kërkesa sipas rregullores përkatëse për ofruesit e shërbimit të pagesave të zbatojnë një mekanizëm pretendimi dhe zgjidhjeje të mosmarrëveshjeve, për të adresuar kërkesat dhe ankesat e konsumatorëve.	BSH	2019
	Aprovimi i një rregulloreje që përforcon strukturën e pajtueshmërisë së NKT-së (Njih-Klientin-Tënd) sipas shtresave të popullsisë në Shqipëri.	MF/DPPP, BSH	2018
Përmirësime në infrastrukturën e pagesave dhe infrastruktura të tjera	Përgatitja e një studimi fizibiliteti për krijimin e platformave kombëtare për stimulimin e pagesave elektronike në Shqipëri (si pagesat me karta dhe transferimet elektronike të kredive) Një platformë kombëtare procesimi (<i>SWITCH</i>) të kartave/ “instant payment”, për gjithë emetuesit, do të bëhet operative dhe do të përdoret gjerësisht prej tyre.	BSH, operatorët privat, AAB BSH, operatorët privat, AAB	2019 2020-2022
	Zbatimi i skemave të debitimit direkt ndërbankar.	BSH	2019
	Vendimi për krijimin e një shtëpie klerimi për transfertat në euro, duke përfshirë operatorin dhe agjentin e shlyerjes.	BSH dhe SHSHB	2019
	Rregulloret dhe rregullat e tjera për gjithë infrastrukturën e sistemit të pagesave në vend do të garantojnë akses të drejtë dhe të hapur. Atje ku të jetë e nevojshme, do të ndiqen reforma ligjore.	BSH	2019
	Operacionalizimi i kategorisë së “pjesëmarrjes së tërthortë” në AECH.	BSH	2018
	Të analizohet mundësia për të kolateralizuar “ex ante”/paraprakisht pozicionet neto të debitit të shkaktuara nga pjesëmarrësit e AECH-ut. Të analizohet gjithashtu vendosja e limiteve për pozicionet neto të debitit të pjesëmarrësve të AECH-ut.	BSH	2018
	Vlerësim i detajuar i AIPS dhe AECH në bazën e CPMI-IOSCO të PITF: – përgatitja e një vetëvlerësim të detajuar; – kryerja e një vlerësim të jashtëm.	BSH Palë e jashtme me mbështetje dhe rishikim të BSH-së	Përfundimi në tremujorin e tretë të vitit 2018. Përfundim në fund të vitit 2018.
	Sistemet e pagesave të operuara nga sektori privat zbatojnë masa të rrepta për administrimin e rrezikut.	Operatorët e sistemit të pagesave, BSH	2019
	Të sigurohet përfundimi i rinovimit të kartave të identifikimit biometrike, filluar në vitin 2009.	Ministria e Brendshme, Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike, dhe Aleat	2020
	Akses i drejtë dhe i barabartë në shërbimet e verifikimit	Ministria e	2018 e në

³⁵ Zyra e Mbrojtjes së Konsumatorit ekzistuese është pjesë e Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Biznesit. Megjithatë, një “Ombudsman” (një zyrtar i caktuar për të hetuar ankesat e individëve kundër një kompanie ose organizate, veçanërisht një autoriteti publik) financiar është shpesh nën ombrellën e Ministrisë së Financës.

Fusha strategjike	Aksione	Enti/Njësia kryesore e zbatimit	Koha (2018-2023)
	<i>online</i> të identitetit eAleat për çdo njësi, me qëllim të justifikuar.	Brendshme	vazhdim
Sigurimi i instrumenteve të pagesave të përqendruara te klienti dhe të përballeshme	Dizenjimi dhe ofrimi i një produkti llogarie “bazë” për persona që nuk janë klientë bankarë. Sigurimi i përballeshmërisë së këtyre llogarive përmes një strukture të përshtatshme çmimi. Llogaritë bazë do të bëjnë të mundur që përdoruesit të paguajnë (dhe paguhen) elektronikisht drejt/nga sa më shumë palë të jetë e mundur.	Banka, me mbështetje nga SHSHB dhe BSH	2018-2019
	Transpozimi i DIREKTIVIT 2014/92 / BE "Për krahasueshmërinë e tarifave që lidhen me llogaritë e pagesave, ndryshimit të llogarive të pagesave dhe aksesit në llogaritë e pagesave me karakteristika themelore"	BSH	2020
	Arritja e ndërveprimit midis të gjitha llogarive rrjedhëse bankare dhe llogarive të parave elektronike, si dhe midis vetë llogarive të parave elektronike, sa më shpejt të jetë e mundur.	Banka, IFJB që emetojnë para elektronike, dhe BSH	2020
	Ridizenjimi i strukturës së çmimeve për llogaritë rrjedhëse, për të shtyrë më tepër individë dhe biznese të vogla të kenë llogari dhe të përdorin më gjerësisht tiparet e pagesave elektronike të këtyre llogarive (në vend të parasë fizikë). Për aq sa është e mundur, shpenzimet paraprake për hapjen e një llogarie dhe tarifat e detyrueshme të mirëmbajtjes mujore ose vjetore do të shmangen.	Bankat	2019-2020
	Përmirësimi i bazës së të dhënave të BSH-së për shërbimet bankare, për ta bërë më të përdorshme nga përdoruesit ekzistues dhe ata të ardhshëm.	BSH (Departamenti i Mbikëqyrjes)	2019
	Zgjerim i pikave të aksesit dhe rrjeteve të pagesave	Të zhvillohen agjentët bankarë. Përveç përgatitjes së ndryshimeve rregullatore, të nxitet Posta Shqiptare dhe SHKK-të të bëhen agjentë për bankat.	BSH
Realizimi i ndërveprimit të kanaleve dhe pikave të ndryshme. Kjo përfshin ndalimin e marrëveshjeve të ekskluzivitetit në marrëdhëniet e agjentëve.		BSH	2019
Të analizohet mundësia e sigurimit të një serie stimuljsh ekonomikë dhe/ose fiskalë për tregtarët që të pranojnë pagesa elektronike. Të zbatohet kjo masë, nëse është e mundur.		Ministria e Financave dhe Ekonomisë	2019 2019-2020
Bankave që janë pranues të kartave të pagesave t'u kërkohet me rregullore të jenë transparente mbi tarifin që u ngarkojnë tregtarëve.		BSH	2019
Të mblidhen sistematikisht të dhëna mbi tarifin e ngarkuara nga pranuesit e kartave të pagesave drejt tregtarëve dhe të përfshihen këto të dhëna në bazën e të dhënave të BSH-së mbi shërbimet bankare.		BSH (Departamenti i Pagesave në bashkëpunim me Departamentin e Mbikëqyrjes)	2019-2020
Përmirësimi i Efikasitetit të Përpjekjeve për Edukimin financiar		Të zhvillohen mesazhe bindëse që shpjegojnë çfarë përfitimesh do t'i sjellë Shqipërisë zbatimi i SKPVV-së.	BSH, SHSHB dhe KKSP
	Të intensifikohen përpjekjet për të edukuar qytetarët shqiptarë mbi përdorimin e llogarive të transaksioneve dhe të pagesave elektronike, nëpërmjet ofrimit të vazhdueshëm të informacionit dhe me një target të	BSH, subjekte të tjera të sektorit publik, dhe OSHP-të	2018 e në vazhdim

Fusha strategjike	Aksione	Enti/Njësia kryesore e zbatimit	Koha (2018-2023)
	caktuar.		
	Të ofrohet trajnim praktik e i mjaftueshëm për klientët.	Banka dhe IFJB që ofrojnë shërbimin e pagesave	2018 e në vazhdim
	Përpjekje të mëtejshme për të rritur ndërgjegjësimin mbi përfitimet e përdorimit të portalit e-Albania, dhe mënyrën e përdorimit të tij me efektivitet dhe gjerësisht (d.m.th. duke përfshirë pagesat <i>online</i>).	Ministria e Inovacionit dhe e Administratës Publike ³⁶	2018 e në vazhdim
	Të matet me objektivitet efektiviteti i përpjekjeve të edukimit financiare dhe programeve të ndërmarra nga BSH-ja.	BSH (një departament i ndryshëm nga ai që zbaton këto programe)	2019 e në vazhdim
Të rritet konkurrenca me kosto efektive, duke shfrytëzuar programet e pagesave me vëllim të madh	Disbursimi i pensioneve dhe i gjithë programit të mirëqenies sociale me përfitime në para, drejtpërdrejt në llogaritë e përfituesve. Llogaritë bankare “bazë” do të përdoren në periudhën afatshkurtër; do të ofrohen me pak ose pa kosto për përfituesin, dhe ky i fundit duhet të ketë mundësi të zgjedhë bankën që preferon. Llogaritë e parave elektronike do të përdoren gjithashtu së bashku me llogaritë bankare, pasi të jenë bërë ndërvepruese.	ISSH i Shqipërisë dhe subjekte të tjera që administrojnë programet e mirëqenies sociale në qeveritë lokale	2019
	Çdo barrierë ligjore apo rregullatore për mbledhjen e pagesave për qeverinë nga jobankat duhet të eliminohet.	Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe BSH	
	Shtimi i numrit dhe varietetit të shërbimeve publike dhe pagesa të tjera P2Q dhe B2Q që mund të paguhet <i>online</i> në e-Albania. Gjithashtu, të zgjerohen instrumentet e pagesave të pranuar në e-Albania për transfertat elektronike të fondeve, nëpërmjet bankës apo llogarive të parave elektronike.	Ministria e Inovacionit dhe e Administratës Publike	Në vazhdim
	Të shqyrtohet mundësia e aplikimit të uljes së TVSH-së për blerje të bëra me mjete elektronike, dukë përfshirë pagesat e faturave. Të zbatohet kjo masë, nëse është e mundur.	Ministria e Financave dhe Ekonomisë Ministria e Financave Ministria e Financave, banka dhe IFJB-të që ofrojnë shërbime të pagesave	2019 2019-2020
	Të shqyrtohet mundësia e ofrimit të zbritjeve tregtare dhe/ose stimuj të tjerë, nëse faturat paguhet me debitim direkt. Gjithashtu, pasi të jenë të aftë të pranojnë pagesa elektronike, operatorët e sistemit të transportit do të shqyrtojnë mundësinë e ofrimit të zbritjeve tregtare për përdoruesit që paguajnë rregullisht elektronikisht.	Faturues të mëdhenj (shërbime komunale, telekomunikimi, televizione kabllore etj.). Çdo operator i sistemit të transportit, publik dhe privat	2019 2019-2020

³⁶ Aktualisht zëvendëskryeministri.

Fusha strategjike	Aksione	Enti/Njësia kryesore e zbatimit	Koha (2018-2023)
	Faturuesit e mëdhenj të ndërmarrin fushata edukuese për të vënë në dukje vlefshmërinë e faturave të paguara duke përdorur instrumentet elektronike të pagesave.	Faturues të mëdhenj	2019 e në vazhdim
	Mekanizmat e pagesave elektronike për përdorim në sistemet e transportit të jenë ndërvepruese për gjithë sistemet, dhe instrumentet thelbësore të pagesave të mund të përdoren për një numër shërbimesh të tjera.	Çdo operator i sistemit të transportit, publik apo privat, OSHP-të, BSH	2019-2020
	Të rritet konkurrenca dhe të nxitet inovacioni në tregun e dërgesave të emigrantëve. Kjo përfshin ndalimin e kontratave të ekskluzivitetit për agjentët dhe nënagjentët e dërgesave të emigrantëve.	BSH	2019
Mbikëqyrje efektive të BSH-së mbi tregun e pagesave me vlerë të vogël	Të rishikohet kuadri i politikës mbikëqyrëse të BSH-së dhe manualët mbikëqyrëse, që të përfshijnë gjithashtu shërbimet e pagesave.	BSH	2019
	Të fillohet mbikëqyrja e shërbimeve të pagesave, duke përdorur një qasje “të butë”.		
	Të sigurohet që ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe operatorët e sistemit të pagesave të rishikojnë rregullisht strukturën e tyre të kostove dhe çmimeve.	BSH	2019
	Të sigurohet që ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe operatorët e sistemit të pagesave të evitojnë çdo praktikë çmimi të padrejtë apo jotransparente.	BSH	2019
	BSH-ja dhe Autoriteti i Konkurrencës do të luftojnë çdo praktike anti-konkurrencë në tregun e pagesave me vlerë të vogël.	BSH-ja drejtpërdrejt në rastet për të cilat ka përgjegjësi dhe mandat ligjor Në rastet e tjera, BSH në bashkëpunim me Autoritetin e Konkurrencës	2019
	Të sigurohet që kontratat që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet, si për ofruesit e shërbimit dhe përdoruesit, të jenë të përcaktuara qartë dhe zbatohen.	BSH	2019
Të mbahet një regjistër i agjentëve të përdorur nga bankat dhe ofruesit e shërbimeve të pagesave. Ky regjistër të jetë publik dhe i disponueshëm për konsumatorët.	BSH	2019	
VEPRIME TË TJERA: MONITORIMI I PROGRESIT TË IMPLEMENTIMIT			
Monitorimi i progresit	Të maten objektivat/variablat mbizotërues të SKPVV-së (d.m.th. pagesat jo me para fizike për frymë dhe përqindja e personave në moshë madhore që zotërojnë llogari). Të komunikohen në publik arritjet e realizuara mbi këto variabla.	BSH dhe KKSP	Një herë në vit
	Të zgjidhen dhe maten “Variablat e ndërmjetëm” që përcjellin ecurinë drejt vizionit të akorduar dhe objektivave gjithëpërfshirës. Çdo muaj të raportohen përfundimet të KKSP-ja.	BSH	Çdo gjashtë muaj

Shtojca 1. Fjalor i termave të përzgjedhur

Kriteri i aksesit (ose hyrjes)	Kriter për të qenë pjesëmarrës i drejtpërdrejt në një sistem pagesash, zakonisht i përcaktuar në rregullat e atij sistemi.
Pikë aksesi	Një pikë që është e nevojshme për të filluar një pagesë. Pikat e aksesit mund të përfshijnë: zyrat e degëve; ATM-të; терминалет POS; apo një aparat personal të përdoruesit (nëpërmjet internetit apo një rrjeti tjetër telekomunikimi).
Agjent bankar	Marrëveshje biznesi të ofruesve bankarë dhe jobankarë të shërbimeve që përdorin subjekte lokale (d.m.th. agjentë) si zyra të vogla për të ofruar shërbime bazë dhe transaksione të lidhura me llogarinë në emër të tyre. Në disa raste, kjo marrëveshje quhet edhe operacion bankar nëpërmjet një korrespondenti biznesi.
Agjent	Një subjekt që ofron shërbime pagesash në emër të një ofruesi shërbimesh pagesash. Lloji i shërbimit i ofruar nga agjenti mund të ndryshojë nga përpunimi i drejtpërdrejt i transaksioneve si, mes të tjerash, disbursimi i parave në dorë ose marrja e depozitave për llogaritë, shërbime ndihmëse të lidhura me transaksione të tilla si mbledhja e dokumenteve, hapja e një llogarie nëpërmjet celularit ose shërbimi i adresimit të pyetjeve të klientit.
<i>Automated Teller Machine</i> (ATM)	Një aparat elektromekanik që u lejon përdoruesve të autorizuar, tipikisht duke përdorur karta pagesash të lexueshme nga makina, të tërheqin para nga llogaritë e tyre dhe/ose të përdorin shërbime të tjera si nxjerrje bilanci, transferime fondesh ose depozitime. ATM-të mund të operohen <i>online</i> , me akses në kohë reale në një bazë të dhënash autorizimi, ose <i>offline</i> . Ato mund të gjenden në degët e OSHP-ve ose në vendndodhje të tjera.
Dega	Vendndodhja fizike e një OSHP-je që i lejon PSHP-ve të tërheqin para nga llogaritë e tyre dhe/ose të përdorin shërbime të tjera si nxjerrje bilanci, transferime fondesh ose depozitime. Këto veprime mund të kryhen nëpërmjet sportelistit apo në zonën e vetëshërbimit të një OSHP-je.
Para në dorë	Kartëmonedhat dhe monedhat e emetuara nga një bankë qendrore apo qeveri, të cilat kanë kurs ligjor në vendin që i ka emetuar.
Klerimi	Shkëmbimi i instruksioneve të pagesave ndërmjet bankës së paguesit dhe bankës së të paguarit (ose agjentit të tyre), rezultati i të cilës është llogaritja e detyrimeve të pagesave ndërmjet pjesëmarrësve të sistemit.
Shtëpi klerimiklerimi	Një vendndodhje qendrore ose një mekanizëm përpunimi qendror, nëpërmjet të cilit institucionet financiare bien dakord të shkëmbejnë instruksionet e pagesave apo detyrime të tjera financiare (p.sh. letra me vlerë). Institucionet pranojnë zëra që shkëmbehen në një kohë të përcaktuar, në bazë të rregullave dhe procedurave të shtëpisë së klerimit. Në disa raste, shtëpia e klerimit mund të marrë përsipër përgjegjësi të rëndësishme për sistemin e klerimit për menaxhimin e rrezikut të kundërpeshës, financiar, apo të administrimit.
Karta e kreditit	Një tip karte pagesash, që tregon që zotëruesit i është dhënë një linjë kredie. Kjo lejon zotëruesin të bëjë blerje dhe/ose të tërheqë të para me një kufi të parapërcaktuar; kredia e dhënë mund të shlyhet plotësisht në fund të një periudhe të përcaktuar ose të shlyhet pjesërisht, me bilancin e marrë si një kredi e zgjatur. Kamata paguhet në shumën e çdo kredie të zgjatur dhe zotëruesi mund të paguajë një tarifë vjetore. Një tip special karte krediti është “charge card” ³⁷ . Një kartë pagimi është një tip karte pagesash që tregon që zotëruesit i është dhënë një linjë kreditore. Kjo e lejon të bëjë blerje, por nuk i ofron një kredi të zgjatur, sasia a plotë e borxhit të krijuar duhet të shlyhet në fund të një periudhe specifike. Zotëruesi zakonisht duhet të paguajë një tarifë vjetore. Shembuj të tyre janë kartat e udhëtimit dhe zbatimjes.

³⁷ E ngjashme me kartat e kreditit, përveç faktit se shlyerja e kredisë bëhet e plotë dhe brenda afatit të përcaktuar në kontratë. Për qëllime statistikore klasifikohen si karta krediti.

Kartë debiti	Kartë pagese ku fondet janë debituar në mënyrë të plotë për çdo transaksion. Lejon zotëruesin të kryejë blerje dhe/ose tërheqë para. Disa emetues kartash debiti ofrojnë një kredit kufi, duke lejuar paguesin të përdorë kartën edhe pa pasur gjendje të mjaftueshme në llogarinë bazë.
Transferte debitimi direkt	Një urdhër pagesë ose një sekuençë urdhërpaguesash të bëra me qëllim për të mbledhur fonde nga paguesi dhe për t'i vënë të dispozicion të të paguarit. Instruksionet e pagesave tipikisht lëvizin nga ofruesi i shërbimit të pagesave (OSHP) të të paguarit/iniciuesit drejt OSHP-së së paguesit, ndoshta nëpërmjet disa OSHP-sh të tjera si ndërmjetëse dhe/ose më tepër se një sistem transferte debitimi direkt. Nëse si paguesi dhe i paguari janë klientë të të njëjtës OSHP-je, transfertat e debitimit direkt mund të përpunohet pa pjesëmarrjen e OSHP-ve dhe/ose sistemeve të tjera të transfertave të debitimit direkt. Trasfertat e debitimit direkt janë tipikisht të kategorizuara si instrumente pagesash transferte fondesh elektronike, megjithatë autorizimi (ose mandati) që përbën bazën kontraktore për (serinë e) transfertën/at e debitimit direkt është ende shpesh herë i bazuar në letër.
Transferte kreditimi direkt	Një urdhërpagesë ose një sekuençë urdhërpaguesash të bëra me qëllim për të vënë fonde në dispozicion të përfituesit. Si instruksionet e pagesave dhe fondet të përshkruara këtu, tipikisht, lëvizin nga OSHP-ja e paguesit/iniciatorit drejt OSHP-së së përfituesit, ndoshta nëpërmjet disa OSHP-ve të tjera si ndërmjetëse dhe/ose më shumë se një sistemi transferte kreditimi direkt. Nëse si paguesi dhe i paguari janë klientë të të njëjtës OSHP-je, transfertat e kreditimit direkt mund të përpunohet pa pjesëmarrjen e OSHP-ve dhe/ose sistemeve të tjera të transfertave të debitimit direkt. Megjithëse transfertat e kreditimit direkt, në thelb, kategorizohen si instrumente pagesash transferte elektronike fondesh, ato mund të jenë një "instrumente pagese hibrid", nëse fillohen me formularë letre. Si pjesë e procesit të klerimit, këta formularë letre zëvendësohen me shkëmbime të imazheve të tyre ose, më zakonisht, me zëvendësues digjitalë.
Pagesë plotësisht elektronike	Një instruksion pagese që fillohet elektronikisht (p.sh. iniciuar në një sistem pagesash apo sistem bankar qendror, nëpërmjet internetit apo një rrjeti tjetër telekomunikimi) dhe përpunohet elektronikisht në të gjithë hapat në vazhdim derisa llogaria e përfituesit të kreditohet përfundimisht (dhe llogaria e paguesit të jetë debituar). Aparati i përdorur për të filluar pagesën mund të jetë një kompjuter, një celular, një aparat POS, apo ndonjë tip tjetër. Instrumenti i pagesave i përdorur është shpesh një produkt i kartës së pagesave, transfertat elektronike kredit/debit, produkt i parasë elektronike ose i pagesave të tjera inovative.
<i>Instant Payments</i>	Pagesat në të cilat transmetimi i mesazhit të pagesës dhe disponueshmëria e fondeve përfundimtare tek përfituesi ndodhin në kohë reale ose kohë afërsisht reale sa më afër bazës 24 orëshe dhe asaj shtatëditore (24x7). Gjithashtu i njohur si "fast payment".
Ndërveprimi	Një situatë ku instrumente të pagesave që i përkasin një skeme të caktuar mund të përdoren në platforma të zhvilluara nga skema të tjera, duke përfshirë vende të tjera. Ndërveprimi kërkon përputhshmëri teknike ndërmjet sistemeve, por mund të hyjë në fuqi vetëm kur janë lidhur marrëveshje tregtare ndërmjet skemave në fjalë.
Rreziku i likuiditetit	Rreziku që një bankë nuk do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e saj për shlyerje (nevojë e përkohshme për fonde).
<i>Banking</i> nëpërmjet telefonit celular	Aksesi në një llogari të mbajtur nga një bankë, IMF, apo një tjetër OSHP nëpërmjet një telefoni celular, për të marrë informacione mbi llogarinë dhe/ose filluar transaksione.
Para elektronike me	Produkt i parasë elektronike ku regjistrimi i fondeve është në telefon celular apo

celular (m-money)	në një sistem kompjuteri qendror, dhe ato mund të përdoren nëpërmjet instruksioneve pagesash specifike të emetuara nga telefoni celular i zotëruesit. E njohur gjithashtu dhe si <i>M-Money</i> .
Sistemi Kombëtar i Pagesave (SKP)	Përfshin gjithë aktivitetet, proceset, mekanizmat, infrastrukturën, institucionet dhe përdoruesit e pagesave, në një vend apo rajon më të gjerë (p.sh. një zonë ekonomike e përbashkët).
Para online	Produkt i parasë elektronike ku regjistrimi i fondeve kryhet në një sistem kompjuteri qendror, dhe ato mund të përdoren nëpërmjet aksesit në këtë sistem nëpërmjet internetit, duke përdorur një shumëllojshmëri aparatesh (p.sh. kompjuter, laptop, tabletë, celular).
Mbikëqyrje ³⁸	Mbikëqyrja e sistemeve të pagesave dhe shlyerjeve është një funksion i bankës qendrore, ku objektivi i sigurisë dhe efikasitetit arrihet falë monitorimit të sistemeve ekzistuese dhe atyre të planifikuara, duke i vlerësuar ato kundrejt objektivave dhe, aty ku e nevojshme, duke nxitur ndryshime. Mbikëqyrja e sistemeve të pagesave ka si qëllim një sistem pagesash të caktuar, në vend të pjesëmarrësve individualë. Në vitet e fundit, shumë banka qendrore kanë zgjeruar aktivitetet mbikëqyrëse mbi instrumentet dhe shërbimet e pagesave.
Zyrë paguese	Vendndodhja fizike e të paguarit (p.sh. në rastin e kompanive të shërbimeve) apo paguesit (p.sh. në rastin e agjencive qeveritare) që i mundësojnë OSHP-ve të transferojnë dhe të marrin fonde. Këto aktivitete mund të kryhen nëpërmjet sportelistit apo në zonën e vetëshërbimit të zyrës paguese.
Switch-i in kartave të pagesave	Një mekanizëm që lidh institucione të ndryshme dhe lejon shkëmbimin e transaksioneve të kartave të pagesave të institucioneve pjesëmarrëse kartëmbajtëse në institucione tregtare pjesëmarrëse të tjera, ATM dhe aparate të tjera pranimit kartash. Një <i>switch</i> i kartave të pagesave përdoret tipikisht për të drejtuar mesazhet lidhur me autorizimin dhe verifikimin ndërmjet institucioneve pjesëmarrëse, i cili gjithashtu mund të prodhojë e shpërndajë dosje klerimi dhe shlyerjeje. Në disa mjedise, institucionet individuale mundet të kenë <i>switch</i> kartash pagese që ndërlidhin терминалет ATM dhe POS të tyre me sistemet e tyre të përpunimit të brendshëm të kartave, dhe këto <i>switch</i> kartash pagese janë të ndërlidhur me një <i>switch</i> kartash pagese ndërinstucional qendror. Kjo shprehje shpesh përdoret në mënyrë të ndërsjellë me rrjetin e kartave të pagesave, megjithëse ka dallime të rëndësishme: një <i>switch</i> në përgjithësi i referohet infrastrukturës teknike, ndërsa rrjeti i kartave të pagesave përfshin masat operacionale, produktet e pagesave, rregullat, procedurat, markën e pranimit etj.
Instrukcion pagese	Një urdhër ose mesazh që instruktoren transfertën e fondeve të urdhërit te i paguari.
Ofrues i shërbimit të pagesave	Një subjekt që ofron shërbime pagesash, duke përfshirë dërgesat e emigrantëve. Ofruesit e shërbimit të pagesave përfshijnë bankat dhe institucione të tjera që mbajnë depozita, si edhe subjekte të specializuara si operatorë të transfertës së parave dhe emetuesit e parave elektronike.
Sistemi i pagesave	Përbëhet nga një seri instrumentesh, procedurash bankare dhe, tipikisht, nga një sistem transferte fondesh ndërbankare që sigurojnë qarkullimin e parasë.
Terminal pikë shitjeje (POS)	Ky term i referohet përdorimit të kartave të pagesave në një vend të shitjes me vlerë të vogël (pika e shitjes). Informacioni i pagesës sigurohet ose nga fatura letër ose nga terminale elektronike, që në disa raste janë të projektuara ta transmetojnë informacionin. Në këtë rast, veprimi mund të quhet “transfertë elektronike e fondeve në pikën e shitjes” (EFTPOS). Në këtë rast, terminali lexon informacionin e shiritit magnetik dhe/ose çipit me QI të kartës së pagesave dhe,

³⁸ Paragrafi i parë i këtij përcaktimi është origjinal nga KSPSH (2005) “Mbikëqyrja e bankës qendrore mbi sistemet e pagesave dhe shlyerjeve”. Pjesa e dytë është shtuar nga dokumente të ndryshme të GBB-së.

	në disa raste, pranon PIN-in e kartëmbajtësit; përgatit një kërkesë autorizimi bazuar mbi transaksionin; transmeton kërkesën e autorizimit tek institucioni pritës; merr përgjigjen e autorizimit; tregon në ekran statusin e plotësimit të transaksionit; dhe printon regjistrimin e transaksionit.
Kartë e parapaguar	Produkt i parasë elektronike për përdorim të përgjithshëm, ku regjistrimi i fondeve kryhet mbi kartën e pagesës (mbi shirit magnetik apo në çipin me qark integral) ose në një sistem kompjuteri qendror, dhe që mund të përdoret nëpërmjet instruksioneve të pagesave specifike të emetuara nga zotëruesi i kartës së pagesave.
Pagesë në distancë	Vendndodhja fizike e paguesit dhe të paguarit nuk përputhen. Pagesa me vlerë të vogël mund të fillohet gjatë transaksionit (ekonomik) ndërmjet paguesit dhe të paguarit (p.sh. urdhër me postë/telefon ose tregti elektronike) ose mund të jetë e shkëputur nga transaksioni (ekonomik) bazë (p.sh. pagesa e faturave). Shembuj pagesash në distancë janë pagesat e filluara me postë normale, internet/linja specifike dhe me rrjete telefoni/celulari.
Rrezik i shlyerjes	Rreziku që një shlyerje në një sistem transferte nuk do të ndodhë si pritët. Ky rrezik mund të përfshijë si rrezikun e kredisë dhe atë të likuiditetit.
<i>Swiching</i>	Një sistem elektronik i përdorur për të transferuar instruksione pagesash, filluar nga klientët, ndërmjet bankave pjesëmarrëse në tregun e pagesave me vlerë të vogël.
Rrezik sistematik	Rreziku që pamundësia e një pjesëmarrësi për të përmbushur detyrimet e tij kontraktore mund t'u mohojë pjesëmarrësve të tjerë fondet që u detyrohen, duke rezultuar në një reaksion zinxhir, ku një numër i madh ose të gjithë pjesëmarrësit në një sistem shlyerjeje nuk do të jenë në gjendje të përmbushin detyrimet e tyre përkatëse.
Rrjet telefon/celulari	Rrjet komunikimi me zë apo tekst që u mundëson përdoruesve të shërbimeve të pagesave të përdorin shërbime si nxjerrje bilanci ose transfertë fondesh, nëpërmjet telefonave fiks apo aparateve celularë.
Llogari e transaksionit	Përkufizohet gjerësisht si një llogari e mbajtur me një bankë ose një ofrues tjetër të autorizuar dhe/ose të rregulluar të shërbimit (duke përfshirë jobankat), e cila mund të përdoret për të shlyer dhe përftuar pagesa. Llogaritë e transaksionit mund të diferencohen më tej në llogaritë e transaksioneve të depozitave dhe në ato të parasë elektronike.

Shtojca 2. Udhëzimet e Bankës Botërore për Zhvillimin e një Strategjie Gjithëpërfshirëse për Reformimin e Pagesave me Vlerë të Vogël

Grupi i Zhvillimit të Sistemeve të Pagesave i Bankës Botërore (GZHSP) ka zhvilluar një strategji për reformimin e sistemeve të pagesave me vlerë të vogël, që ka një numër rekomandimesh për modernizimin e SKPVV-së.

Kuadri është hartuar duke u mbështetur në studime të kaluara të zhvilluara nga vetë Banka Botërore, Komiteti për Sistemet e Pagesave dhe të Shlyerjeve, dhe autoritete të tjera ndërkombëtare dhe kombëtare të përfshira në çështjet e sistemit të pagesave, si dhe në përvojën globale të mbledhur nga GZHSP-ja në mbi 100 vende.

Kuadri bazohet në grupin e mëposhtëm të objektivave të politikave publike:

- garantimi i sigurisë dhe efikasitetit të përgjithshëm të sistemit kombëtar të pagesave;
- promovimi i përballueshmërisë dhe lehtësia e hyrjes në shërbimet e pagesave;
- nxitja e zhvillimit të një infrastrukture efikase për të mbështetur zhvillimin e instrumenteve dhe mekanizmave të pagesave për të përmbushur nevojat për pagesa me vlerë të vogël; dhe
- nxitja e përdorimit optimal shoqëror të instrumenteve të pagesave.

Për të arritur këta objektiva të politikave publike, Banka Botërore ka formuluar udhëzimet e mëposhtme.

Udhëzimi I: Tregu i pagesave me vlerë të vogël duhet të jetë transparent, të sigurojë mbrojtje të përshtatshme të interesave të paguesve dhe të të paguarve, dhe të jetë me kosto efektive.

Udhëzimi II: Pagesat me vlerë të vogël kërkojnë burime financiare, komunikime dhe lloje të tjera infrastrukture të besueshme. Këto infrastruktura duhet të ndërtohen për të rritur efikasitetin e pagesave me vlerë të vogël. Ato përfshijnë: një sistem ndërbankar të transferimit të fondeve elektronike; një platformë ndërbankare kartash pagese; platforma për raportimin e kredive; platforma për shpërndarjen e të dhënave; sisteme ndërbankare të

shlyerjes bruto me vlerë të madhe; disponueshmëri të një infrastrukture komunikimi të fortë; dhe një infrastrukturë kombëtare identifikimi.

Udhëzimi III: Pagesat me vlerë të vogël duhet të mbështeten nga një kuadër ligjor dhe rregullator i shëndoshë, i parashikueshëm, jodiskriminues dhe proporcional.

Udhëzimi IV: Kushtet e tregut konkurrues duhet të nxiten në industrinë e pagesave me vlerë të vogël, me një ekuilibër të përshtatshëm midis bashkëpunimit dhe konkurrencës, për të promovuar, ndër të tjera, nivelin e duhur të ndërveprimit në infrastrukturën e pagesave me vlerë të vogël.

Udhëzimi V: Pagesat me vlerë të vogël duhet të mbështeten nga praktika të përshtatshme qeverisjeje dhe menaxhimi të rrezikut.

Udhëzimi VI: Autoritetet publike duhet të ushtrojnë mbikëqyrje efektive mbi tregun e pagesave me vlerë të vogël dhe të marrin në konsideratë ndërhyrje proaktive aty ku është e përshtatshme.

Shtojca 3: KIPT - Banka Botërore "Aspektet e pagesës të përfshirjes financiare"

Përfshirja financiare, e parë nga këndvështrimi i pagesave, duhet të synojë të arrijë një numër objektivash. Në një situatë ideale, të gjithë individët dhe bizneset duhet të jenë në gjendje të kenë dhe të përdorin të paktën një llogari transaksioni të operuar nga një ofrues i shërbimit të pagesave të rregulluar:

- për të kryer pjesën më të madhe, nëse jo të gjitha, të pagesave të nevojshme;
- për të ruajtur në mënyrë të sigurt të vlerës; dhe
- për t'i shërbyer atij si një urë lidhëse në shërbime të tjera financiare.

Në këtë kontekst, u identifikuan Parimet Udhëzuese në vijim. Secili prej tyre përfshin një sërë veprimesh të mundshme (të cilat nuk paraqiten në këtë shtojcë).

Parimi udhëzues 1: Angazhimi i sektorit publik dhe privat. Angazhimi i institucioneve të sektorit publik dhe atij privat për të zgjeruar përfshirjen financiare është i qartë, i fortë dhe i qëndrueshëm në kohë.

Parimi udhëzues 2: Kuadri ligjor dhe rregullator. Kuadri ligjor dhe rregullator mbështet përfshirjen financiare, duke: adresuar në mënyrë efektive të gjitha rreziqet përkatëse; mbrojtur konsumatorët; dhe nxitur në të njëjtën kohë inovacionin dhe konkurrencën.

Parimi udhëzues 3: Infrastrukturat financiare dhe TIK. Infrastrukturat financiare dhe TIK të forta, të sigurta, efikase dhe të arritshme janë të dobishme për ofrimin e shërbimeve të llogarive të transaksioneve, si dhe mbështesin ofrimin e shërbimeve financiare më të gjera.

Parimi udhëzues 4: Llogaria e transaksionit dhe hartimi i produktit të pagesave. Llogaria e transaksionit dhe oferta e produkteve të pagesave përbushin në mënyrë efektive një gamë të gjerë të nevojave të transaksioneve të popullatës së synuar, me pak ose pa kosto.

Parimi udhëzues 5: Pikat aksesit lehtësisht të disponueshme. Dobia e llogarive të transaksioneve shtohet me një rrjet të gjerë pikash aksesit, të cilat arrijnë një mbulim të gjerë gjeografik dhe ofrojnë një shumëllojshmëri kanalesh ndërvepruese aksesit.

Parimi udhëzues 6: Ndërgjegjësimi dhe edukimi financiar. Individët fitojnë njohuri, përmes ndërgjegjësimit dhe përpjekjeve për edukim financiar, mbi: përfitimet e zotërimit të llogarive të transaksioneve; si t'i përdorin këto llogari në mënyrë efektive për qëllimet e pagesës dhe të ruajtjes së vlerave; dhe si të afrohen në shërbime të tjera financiare.

Parimi udhëzues 7: Flukset e mëdha, të përsëritura të pagesave. Flukset e mëdha, të përsëritura të pagesave, duke përfshirë dërgesat e emigrantëve, përdoren për të avancuar objektivat e përfshirjes financiare, domethënë duke rritur numrin e llogarive të transaksioneve dhe duke nxitur përdorimin e shpeshtë të këtyre llogarive.

Shtojca 4: KSPSH - Banka Botërore "Parimet e Përgjithshme për Shërbimet Ndërkombëtare të Dërgesave të Emigrantëve" dhe role të ngjashme

PARIMET E PËRGJITHSHME PËR SHËRBIMET NDËRKOMBËTARE TË DËRGESAVE TË EMIGRANTËVE

Parimet e përgjithshme synojnë të përmbushin objektivat e politikës publike për arritjen e shërbimeve të sigurta dhe efikase të dërgesave ndërkombëtare të emigrantëve. Për këtë qëllim, tregjet për shërbimet duhet të jenë konkurruese, transparente, të aksesueshme dhe të shëndosha.

Transparenca dhe mbrojtja e konsumatorit

Parim i përgjithshëm 1. Tregu i dërgesave të emigrantëve duhet të jetë transparent dhe të ofrojë mbrojtje të përshtatshme të konsumatorit.

Infrastruktura e sistemit të pagesave

Parim i përgjithshëm 2. Duhet inkurajuar përmirësimet në infrastrukturën e sistemit të pagesave që mund të rrisin efikasitetin e shërbimeve të dërgesave të emigrantëve.

Ambienti ligjor dhe rregullator

Parim i përgjithshëm 3. Shërbimet e dërgesave të emigrantëve duhet të mbështeten nga një kuadër ligjor dhe rregullator në juridiksionet përkatëse, i shëndetshëm, i parashikueshëm, jodiskriminues dhe proporcional.

Struktura e tregut dhe konkurrenca

Parim i përgjithshëm 4. Kushtet e konkurrencës së tregut, duke përfshirë aksesin e duhur në infrastrukturën e pagesave të brendshme, duhet të nxiten të përfshihen në industrinë e remitancave.

Qeverisja dhe administrimi i rrezikut

Parim i përgjithshëm 5. Shërbimet e dërgesave të emigrantëve duhet të mbështeten nga praktika të përshtatshme qeverisjeje dhe administrimi të rrezikut.

ROLET E OFRUESVE TË SHËRBIMIT TË DËRGESAVE TË EMIGRANTËVE DHE AUTORITETEVE PUBLIKE

A. Roli i ofruesve të shërbimit të dërgesave të emigrantëve. Ofruesit e shërbimeve të dërgesave të emigrantëve duhet të marrin pjesë aktive në zbatimin e parimeve të përgjithshme.

B. Roli i autoriteteve publike. Autoritetet publike duhet të vlerësojnë se çfarë veprimesh duhen ndërmarrë për të arritur objektivat e politikave publike, nëpërmjet zbatimit të parimeve të përgjithshme.